



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Durrës

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Financiar)

BASHKIA DURRËS

Tiranë, tetor 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3 – 11
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	
II.	HYRJA	11 – 14
1.	Objektivat dhe qëllimi	
2.	Identifikimi i çështjes.....	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	
5.	Kriteret e vlerësimit.....	
5.	Standardet e auditimit.....	
7.	Metodat e auditimit.....	
8.	Dokumentimi i auditimit.....	
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	14 – 162
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	14 – 16
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	16 - 162
2.1	<i>Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditimin e brendshëm.</i>	16 – 43
2.2	<i>Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</i>	43 - 77
2.3	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare.</i>	77 – 120
2.8	<i>Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi fundit.</i>	120 - 162
IV	GJETJE DHE REKOMANDIME	162 – 173

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve realizojë auditimin financiar me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Durrës, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, miratimi dhe zbatimin i buxhetit, etj. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2024 deri në datën 31.12.2024. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi kryesore nga Bashkia Durrës si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, etj.

Bashkia Durrës, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , i ndryshuar dhe Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” , i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Durrës për periudhën e aktivitetit financiar të periudhës 2023 - 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Buxheti i Bashkisë Durrës si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar të akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “*Auditi i jashtëm*” pikat 1 dhe 2. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Durrës si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave.

Për *auditimin financiar*, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2024 deri më datën 31.12.2024.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit për periudhën objekt auditimi 01.01.2024 – 31.12.2024, janë si vijon:

- *Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar e publik;*

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit;
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për pasqyrat financiare të vitit 2024.
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 73,128 mijë lekë për shpenzime.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Verifikimi i transaksioneve;
- Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
- Intervistat;
- Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar **19** gjetje dhe ka dhënë **19** rekomandime të llojit organizative.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Në menaxhimin financiar dhe kontrolli, si dhe funksionimi i AB:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk është hartuar plani vjetor i punës.

- Nuk ka raportime periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit.

- Bashkia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime. Aktivitetet e rëndësishme (me vlera të konsiderueshme) dhe aktivitetet afatgjata nuk ruhen nga përdorimi i paautorizuar me anë të një procedure të shkruar. Bashkia nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Bashkia nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm.

- Në fushën e zbatimit të buxhetit:

Realizimi i buxhetit për vitin 2023, është në vlerën 7,688,491 mijë lekë, nga vlera 10,072,929 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 76%. Niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varijon në masën 77% (për zërin investime) deri 96% (ndihma ekonomike), gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Durrës dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

Në mos realizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 230-231 “*Shpenzime për investime*” në masën 77% (të bashkisë), e cila ka ardhur nga mos realizimi dhe finalizimi me kontratë i 19 projekteve të planifikuara në vlerën 197,733,600 lekë, për të cilat nuk janë kryer procedurat e prokurimit, duke mos i realizuar ato gjatë vitit 2023 pavarësisht faktit se ato janë programuar, gjë që ka sjellë planifikim të investimeve përtej mundësive. Ndërsa për 66 projekte të planifikuara, për të cilat janë çelur edhe fondet janë financuar pjesërisht ose nuk janë financuar për arsye të mos mbylljes së punimeve brenda vitit buxhetor nga zhvillimi i procedurave në periudhat e fundvitit dhe lidhja e kontratave me vonesë.

Ndikim në mos realizim, vjen dhe nga mos realizimi i projekteve të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 të cilat janë realizuar në masën 61%, ku nga vlera e parashikuar prej 4,505,939 mijë lekë është realizuar vlera 2,692,199 mijë lekë, për shkak të mos përfundimit të punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratat e zbatimit dhe mos paraqitjes së faturave për likuidim.

Për vitin 2023 me të ardhurat e veta bashkia ka planifikuar të mbulojë 56% të shpenzimeve. Kështu të ardhurat nga taksat e tarifave vendore (në total) janë planifikuar për vlerën 2,118,990 mijë lekë në fakt ato janë realizuar për vlerën 1,851,570 mijë lekë ose 87%, me një diferencë në masën – 267,420 mijë lekë.

- Për vitin 2024 realizimi i buxhetit është në vlerën 6,870,439 mijë lekë nga 8,624,462 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 79.6%. Mos realizimi i buxhetit për vitin 2024, ashtu si dhe për vitin 2023 kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 230-231 “*Shpenzime për investime*” në masën 60% (të bashkisë), e cila ka ardhur nga mos realizimi dhe finalizimi i 13 projekteve të planifikuara në vlerën 95,752,000 lekë, pasi nuk janë kryer procedurat e prokurimit, duke mos i realizuar pavarësisht se ato janë programuar, dhe për 28 projekte të planifikuara, për të cilat janë çelur edhe fondet janë financuar pjesërisht ose nuk janë financuar për arsye të mos mbylljes së punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë dhe lidhja e kontratave me vonesë.

Gjithashtu dhe mos realizimi i projekteve të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 të planifikuara, të cilat janë financuar nga fondet e rindërtimit në masën 64%, ku nga vlera e parashikuar prej 2,524,223 mijë lekë është realizuar vlera 1,607,293 mijë lekë, për shkak të mos përfundimit të punimeve sipas afateve të përcaktuara dhe mos paraqitjes së faturave për likuidim.

b. Gjatë zbatimit të Buxhetit, është konstatuar se për vitin 2023, nuk është bërë planifikimi i plote i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura të rezultuara në fund të vitit 2022 në vlerën 110,374,3892 lekë. Ndërsa për vitin 2024, ato janë në vlerën 39,606,019 lekë, të cilat nuk janë paraqitur për arkëtim në vitin vijues për faktin se janë detyrime të ish- komunave të cilat nuk kanë dokumentacion të rregullt ligjorë për të mundësuar planifikimin në buxhet pasardhës për likuidim. Pra në fund të vitit 2024, totali i detyrimeve të prapambetura paraqitet në vlerën 39,606,019 lekë, ku mos likuidimi nuk vjen për shkak të mungesës së fondeve, por se dokumentacioni shoqëruar nuk plotëson kushtet ligjore për likuidim.

c. Financimi i buxhetit vjetor 2023, është bërë në masën më të madhe prej 75.3% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar, transfertat specifike transferata e kushtëzuar dhe Fondi i Rindërtimit) dhe 24.6% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifave vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat, që siguron njësi vendore nga burimet të tjera. Ndërsa **për vitin 2024**, financimi i buxhetit vjetor është bërë në masën më të madhe prej 74% nga Buxheti i Shtetit

(transferta e pakushtëzuar, transfertat specifike transferta e kushtëzuar dhe Fondi i Rindërtimit) dhe 26% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat, që siguron njësi vendore nga burimet të tjera.

- Në hartimin e pasqyrave financiare:

Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezultoi se:

- Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 635,037,652 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,291,299,993 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2023 ka pasur rritje me vlerë 656,262,341 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët. Detyrimet janë kontabilizuar duke i grupuar sipas llojit të detyrimit. Vlera e kontabilizuar në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është kontabilizuar pa u kryer një analizë me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për debitorët dhe vlerat përkatëse të tyre referuar dokumentacionit përkatës.

- Llogaria 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (debitor)*”, në fund të vitit 2023 paraqitet në pasqyrat e konsoliduara në vlerën 129,815,530 lekë.

Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës gjendja e llogarive të klasës 4 është në vlerën 498,378,655 lekë.

Sipas analizës së nxjerrë nga grupi i auditimit për llogaritë e klasës 4 (401-408,421,431,435,436,467), referuar pasqyrave individuale të Bashkisë Durrës dhe të Njësive Shpenzuese të dorëzuara në thesar totali i kësaj llogarie është në vlerën 471,150,473 lekë.

Referuar analizës së mësipërme llogaria 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (debitor)*” duhej të paraqitet në pasqyrat e konsoliduar për vlerën 471,150,473 lekë. Kjo llogari është mbivlerësuar për vlerën 27,228,182 lekë.

Sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë Durrës gjendja e llogarisë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerë 90,639,938 lekë.

Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese, nga grupi i auditimit u konstatua se vlera e llogarisë është 126,782,226 lekë. Referuar analizës së mësipërme për llogarinë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (debitor)*”, e cila është llogari kuadruese për llogarinë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” kjo llogari duhet të paraqitet në vlerën 471,150,473 lekë, llogaria është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 380,510,535 lekë.

- Llogaria 202 “*Studime dhe Kërkime*” përbehet nga 41 projekte me kosto historike 250,813,498 lekë dhe vlerë neto 135,706,885 lekë. Regjistri elektronik i vendosur në dispozicion grupit të auditimit për aktivet e llogarisë 202 përmban vitin e kontabilizimit, përshkrimin e aktivitetit dhe koston historike. Drejtoria e Financës Bashkia Durrës nuk disponon një regjister për aktivet e llogarisë 202

- Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” është paraqitur me kosto historike 183,102,409 lekë, ku gjatë vitit 2023 nuk ka pasur shtesa.

- Gjendja e llogarisë 211 “*Pyje, Plantacione*” sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë Durrës është paraqitur me kosto historike 22,684,643 lekë. Gjatë vitit 2023 llogaria 211 nuk ka pasur shtesa. Aktivitetet e kontabilizuara në llogarinë 211 “*Pyje, Plantacione*” janë kontabilizuar në këtë llogari në kundërshtim me nomenklaturën e llogarive kontabël sepse këto aktive janë vepra arti dhe duhet të kontabilizohen në llogarinë 212 “*Ndërtesa dhe Konstrukione*”.

- Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune*”. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë Durrës gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerë neto kontabël 129,581,074 lekë. Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit u konstatua se vlera kontabël neto e cila duhet të paraqitet llogaria 214 në pasqyrën e konsoliduar është 144,848,230 lekë.

Referuar analizës së mësipërme vlera neto e llogarisë 214 është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiarë për vlerën 15,267,156 lekë.

Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 39,565,379 lekë. Kjo shtesë në llogarinë 214 është përfituar nga blerje me pagesë në shumën 8,498,612 lekë, blerje pa pagesë në vlerën 31,066,767 lekë.

- Llogaria 217 “*Kafshë pune dhe Prodhimi*” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në datë 31.12.2022 në vlerën 266,131,632 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari është shtuar për vlerën 33,765,000 lekë. Në datën 31.12.2023 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 299,896,317 lekë. Referuar përmbledhësës së vendosur në dispozicion në këtë llogari janë kontabilizuar pemë të llojeve të ndryshme. Vlera e kontabilizuar në këtë llogari nuk i plotësojnë kushtet e kontabilizimit të aktiveve.

- Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Durrës. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë Durrës gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerë neto kontabël 200,938,270 lekë.

Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit u konstatua se vlera kontabël neto e cila duhet të paraqitet llogaria 218 në pasqyrën e konsoliduar është 241,386,955 lekë. Kjo llogari është e paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 40,448,685 lekë.

- Llogaria 216 “*Rezervë shtetërore*” është pasqyruar në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar për vlerën 36,987,524 lekë. Referuar pasqyrave individuale të pozicionit financiar të 11 njërive kjo llogari është paraqitur me vlerë 0 lekë.

- Llogaria 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 309,915,144 lekë. Regjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ. Llogaria 486 është mbivlerësuar për vlerën 309,915,144 lekë.

- Llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31.12.2023 për vlerën 54,343,294 lekë. Referuar pasqyrave individuale të njërive shpenzuese në Bashkinë Durrës rezultoi se llogaria 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*” është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 34,791,168 lekë. Kjo llogari duhet të paraqitet në vlerën 19,552,126 lekë

- Referuar pasqyrës individuale të pozicionit financiar për Bashkinë Durrës kjo llogari është regjistruar për vlerën 332,587,885 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2024, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466.

Llogaria 466 “*Kreditore për mjete nën ruajtje*” është mbivlerësuar për 86,728,364 lekë.

• Në fushën e zbatimit të rekomandimeve nga auditimi fundit.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën 765/22 Prot, datë 02.05.2024, rezultoi se:

- Nga subjekti është respektuar afati **20 ditë** dhe **6 mujë** për kthimin e përgjigjes për marrjen e masave në zbatimin e rekomandimeve, përcjellë me shkresën nr. 946/16 Prot, datë 22.05.2024, në zbatim të shkronjës “j” të nenit 15 dhe pikës 2 të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH*”.

- Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, kemi si vijon:

a- Nga **39** masa organizative të rekomanduara, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa, janë në proces 14 masa, janë pjesërisht të zbatuara 2 masa dhe nuk janë zbatuar 16

masa organizative. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohen 15 masa organizative pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

b- Nga 7 masa shpërblim dëmi në vlerën 2,794,896 lekë, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa në vlerën 1,122,000 lekë, ndërsa 2 masa në vlerën 1,671,000 lekë janë zbatuar pjesërisht.

c- Nga 3 masa për eliminim e efekteve negative, pranuar 100% nga subjekti, të cilat nuk janë zbatuar. Masat e pa zbatuara nuk do të rikërkohen pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

d- Nga 9 masa për uljen e borxhit tatimor, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 4 masa, në proces janë 4 masa, dhe realizuar pjesërisht 1 masë. Masa e zbatuar pjesërisht nuk do të rikërkohen pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

• Në menaxhimin financiar dhe kontrolli, si dhe funksionimi i AB:

Kryetari i Bashkisë Durrës, Koordinator i Riskut dhe Koordinator i MFK-së të marrin masa për:

- Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues të performancës, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

- Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin e konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.

- Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike. -Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

• Në fushën e zbatimit të buxhetit:

Bashkia Durrës, nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe me miratim në Këshillin Bashkiak, të marrë masa si vijon:

- Të kryejë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara dhe me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë financimin i detyrimeve të prapambetura.

- Të sigurojë realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara, sipas prioriteteve strategjike, duke shmangur vonesat në procedurat e prokurimit, në lidhjen e kontratave dhe eliminuar limitimin e likuidimeve për angazhime të marra.

- Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, duke hartuar një grafik me radhën e pagesave, dhe për detyrime me dokumentacion jo të saktë ligjorë në bashkëpunim me Degën e Thesarit të marrin masa për risistemin e tyre të aktivitet.

- Të raportojnë me saktësitë dhe në kohë reale të gjitha faturat për situacionimet e mbyllura sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

• Në hartimin e pasqyrave financiare viti 2024:

Drejtorja e Financës Bashkia Durrës të marrë masat e nevojshme si më poshtë vijon:

- Të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”;

- Regjistrimin e saktë të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” dhe 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm;

- Të hartojë regjistrin e aktiveve afatgjata jo materiale sipas udhëzimeve përkatëse dhe të kryejë

kontabilizimin e saktë të llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” për të dhënë informacion kontabël të saktë;

- Për regjistrimin e saktë të llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm. Materialet të kontabilizohen në klasën 3 të aktivitetit “*Inventarët*”;

- Për regjistrimin e saktë të llogarisë 211 “*Pyje, Plantancione*” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm. Aktivitetet e kontabilizuara në llogarinë 211 “*Pyje, Plantancione*” të transferohen në llogarinë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*”;

- Për regjistrimin e saktë të llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune*” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm;

- Për regjistrimin e saktë të llogarisë 217 “*Kafshë pune dhe prodhimi*”, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm;

- Për regjistrimin e saktë të llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm;

- Për regjistrimin e saktë të llogarisë 216 “*Rezervë shtetërore*” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm;

- Të mos kryejë kontabilizimin e llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”, në pasqyrën e pozicionit financiar;

- Për regjistrimin e saktë të llogarisë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm;

- Për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “*Kreditore për mjete nën ruajtje*”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

• Në fushën e zbatimit të rekomandimeve nga auditimi fundit.

Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi.

I.1. KONKLuzioni DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Në kemi audituar, pasqyrat financiare vjetore të konsoliduar të Bashkisë Durrës për vitin 2023 dhe pasqyrat financiare të aparatit të Bashkisë Durrës për vitin 2024 (pasi të konsoliduar nuk janë mbyllur akoma), ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Durrës janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një

opinionin të modifikuar me rezervë¹.

Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA^{-të}). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga njësia shpenzuese Bashkia Durrës, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, për periudhën ushtrimore 2024 është 73,128 mijë lekë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705), dhe konkretisht:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

-Llogaria 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (debitor)*”, është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 27,228,182 lekë.

-Llogaria 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”, është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 380,510,535 lekë.

-Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*”, është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 2,507,568 lekë.

-Llogaria 211 “*Pyje ,Plantacione*”, është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 22,684,643 lekë.

-Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune*”, është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 15,267,156 lekë.

-Llogaria 216 “*Rezervë shtetërore*”, është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 36,987,524 lekë.

-Llogaria 217 “*Kafshë pune dhe Prodhimi*”, është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 299,896,317 lekë.

-Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*”, është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 40,448,685lekë.

-Llogaria kontabël 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 309,915,144 lekë

-Llogaria kontabël 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 34,791,168 lekë.

II. HYRJJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, i ndryshuar, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1347/1 prot., datë 13.11.2024 (i ndryshuar), miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Durrës nga data 14.11.2024 deri në datën 18.07.2025, u krye auditimi për periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2024 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

¹ Një “Opinion i modifikuar me rezervë”, jepet në rastet kur: - audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;

1. Z. A.K, *përgjegjës grupi*;
2. Z. K. GJ, *auditues*;
3. Z. K. H, *auditues*;
4. Z. E. S, *auditues*;

1. Objektivat, Fushëveprimi dhe Metodologjia

- **Objektivat dhe Qëllimi i auditimit.** Objektivi i *auditimit financiar* është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, i cili do realizohet pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

- **Identifikimi i çështjes.** Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Ky Raport Përfundimtar Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Durrës, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditivit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditiv, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Durrës.

- **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.** Strukturat drejtuese të Bashkisë Durrës, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, etj.

- **Përgjegjësitë e audituesve.** Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një

opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (*audituesit e KLSH-së*), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet me opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Durrës, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

- Kriteret e vlerësimit. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që kanë ndryshuar këtë ligj; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” ndryshuar me Ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015; VKM nr. 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; Udhëzimi MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të njërive të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financiare nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të njërive të vetëqeverisjes vendore”, dhe pikat 116-117 “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet

shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre”, i ndryshuar; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

- **Standardet e auditimit.** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të auditimit financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi standardet e kontrollit të brendshëm për sektorin publik”, si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”, etj. Standardet kombëtare të kontabilitetit; Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i auditimit financiar të KLSH-së; Manuali i auditimit të brendshëm, etj. Standardet ndërkombëtare të auditimit mbi raportimin e audituesit të pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

- **Metodat e auditimit.** Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- *Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe*
- *Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.*

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin: Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- **Konrolli aritmetik.** Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Konrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- **Konrolli me anë të pjesëve justifikuese.** Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga konrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatohet se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

- **Inspektimi fizik dhe konrolli i gjendjeve ekzistuese,** konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive,

librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- Kontrolli i vlerësimeve. Përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- Konfirmimi nga të tretët. Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- *Intervista*
- *Raporte dhe Informacione*
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK.*

- Dokumentimi i auditimit. Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit financiar, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet të cilat u dorëzuan në datë 18.5.2025 në protokollin e Bashkisë Durrës, sipas afatit të përcaktuar në programin e auditimit, nr. 1347/1 prot, datë 13.11.2024 me ndryshime.

Me shkresën nr. 1347/11 prot, datë 30.7.2025, është përcjellë Projekt raport auditimi në subjekt. Ky i fundit në përfundim të afateve ligjorë, përcolli në adresë të KLSH-së, kundërshtitë mbi Projekt Raport Auditimin me shkresën nr. 1216/15 prot, datë 22.8.2025, administruar në KLSH me shkresën nr. 1347/12, datë 26.8.2025.

Pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, nga grupi i auditimit të KLSH-së, u morën në konsideratë ato që kishin mbështetje ligjore dhe në fund u hartua ky Raport Përfundimtar Auditimi dhe Opinioni i Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm.

Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me Bashkinë Kurbin, në lindje me Bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me Bashkinë Kavajë. Bashkia Durrës përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Të gjitha njësitë e bashkisë bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë gjenden

tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra. Durrësi është qyteti me aktivitetin më të madh ekonomik pas Tiranës.

Sipas censurit të vitit 2023, kemi në situatë:

Numri i popullsisë më 18 Shtator 2023 <i>Population number on September 18th 2023</i>	226 863
Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë (%) <i>Gender population distribution:</i>	
Meshkuj/Male	50,2
Femra/Female	49,8
Popullsia me status martesor i/e martuar (%) <i>Population with marital status married</i>	54,8
Popullsia 15 vjeç e lart që kanë përfunduar ose janë duke e ndjekur shkollën (%) <i>Population aged 15 and over have either completed any level of education or are currently attending school</i>	96,7
Ndërtesa për qëllime banimi (Numër) <i>Buildings for residential purposes (Number)</i>	59 723
Banesa të zakonshme të banuara (Numër) <i>Conventional inhabited dwellings (Number)</i>	66 176
Njësi Ekonomike Familjare (Numër) <i>Households (Number)</i>	68 645

www.instat.gov.al



DURRËS	Numri i popullsisë më 18 Shtator 2023 <i>Population number on September 18th 2023</i>	Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë (%) <i>Gender population distribution (%)</i>		Ndërtesa për qëllime banimi (Numër)/ <i>Buildings for residential purposes (Number)</i>	Banesa të zakonshme të banuara (Numër)/ <i>Conventional inhabited dwellings (Number)</i>	Njësi Ekonomike Familjare (Numër)/ <i>Households (Number)</i>
		Meshkuj <i>Male</i>	Femra <i>Female</i>			
Durrës	153 614	49,6	50,4	37 880	46 783	48 413
Krujë	51 191	51,6	48,4	14 029	13 297	13 882
Shijak	22 058	50,6	49,4	7 814	6 096	6 350

Misioni i Bashkisë Durrës është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
 - respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
 - zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
 - ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
 - realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
 - nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
 - realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.
- Bashkia Durrës, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” , i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Durrës për periudhën e aktivitetit 2023- 2024, krahas

detyrimin kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Pika 2.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për periudhën 2023 - 2024.

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Durrës, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit” përfshin: integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 1 – Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike;

Parimi 2 – Titullari/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje;

Parimi 3 – Titullari/ Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë;

Parimi 4 – Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave;

Parimi 5 – Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Durrës në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Nga analizimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësonin e vetëvlerësimit evidentojmë se, institucioni vepron mbi bazën e Rregullores së Brendshme, e miratuar me Vendimin nr. 69, datë 05.08.2022, e ndryshuar me Vendim nr. 73 datë 03.10.2023, “Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës”, e ndryshuar me vendimin nr. 87, datë 10.10.2024. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.

Bashkia Durrës nuk ka pasur Kod të Etikës në Vitin 2023, por në nenin 14 të Rregullores së Brendshme të kësaj Bashkie është përfshirë edhe “Etika për punonjësit e Bashkisë Durrës dhe kodi i veshjes”, si edhe në shkresën nr. 7160 prot., datë 16.06.2021 “Mbi disa rregulla të etikës në Institucionin e Bashkisë Durrës. Kurse në Vitin 2024, Kodi i Etikës është miratuar me vendimin nr. 27, datë 15.02.2024, bazuar edhe në Urdhrin nr. 20, datë 26.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Kodit të Etikës”.

Një problematikë tjetër e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatorë, apo kodin e etikës.

Me shkresën nr. 10708 prot., datë 01.10.2021 është miratuar një “Rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Durrës”.

Gjatë vitit 2023 janë marrë këto masa administrative:

1 masë “*largim nga shërbimi civil*”, për mos përmbushje të detyrave funksionale;

1 masë “*për mbajtje të 1/3 së pagës*”, për një periudhë 3-mujore, për mos përmbushje të detyrave funksionale;

Gjatë vitit 2024 janë marrë këto masa administrative:

2 masa “*largim nga shërbimi civil*”, për mos përmbushje të detyrave funksionale, “*Mosparaqitje në vendin e punës pa lajmëruar eprorin direkt*”, për punonjësit M. V, Specialist në Njësinë e Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Durrës dhe për punonjësin E. B, me detyrë Specialist pranë Sektorit të Menaxhimit të Gjeoinformacionit pranë Bashkisë Durrës;

1 masë për “*Largim nga Policia Bashkiake*” për punonjësin S. M, me detyrë polic bashkiak, për shkak të mosparaqitjes në mënyrë të përsëritur në vendin e punës, pa njoftuar eprorin direkt.

Lidhur me marrjen e masave për zbatimin e procedurave antikorruption, mund të përmendim se Bashkia Durrës zbaton kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin për sinjalizuesit, por ende nuk ka procedurë të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla. Për rastet e raportimit lidhur me ankesat për korruption, funksionon Autoriteti Përgjegjës, ngritur pranë Bashkisë Durrës në zbatim të Ligjit 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar.

Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj (ose dy herë në vit). Po ashtu ka vlerësime vjetore edhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Parimi 2 - Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi, apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësive publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Për periudhën e auditimit 01.01.2023 - 31.12.2024, situata paraqitet pjesërisht efektive, ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga njësitë e varësisë dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva, gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar, mbi rregullat e raportimit në institucion.

Evidentohet se ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA, si dhe në MFE. **Mungon Plani i Veprimit për KB dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij Plani;**

Mungon plani i menaxhimit të risqeve të nivelit të lartë e të mesëm për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Nëpërmjet shkresës nr. 2765/1 prot., datë 27.02.2024 është dërguar pranë Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit *“Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”*, **për Vitin 2023**, kurse me shkresën me nr. 2684/2 prot., datë 28.02.2025 është dërguar pranë Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit *“Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”*, **për Vitin 2024.**

Titullari merr opinione për performancën nga institucione të pavarura si: KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

Përsa i përket raportit të cilësisë së kontrollit të brendshëm, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga Bashkia Durrës, ndodhet vetëm shkresa me nr. 4354 prot., datë 17.05.2022, në të cilën janë ndarë drejtoritë dhe njësitë administrative, për tre nënkryetarët e Bashkisë të cilët ndjekin mbarëvajtjen e problemet e punës dhe raportojnë pranë Kabinetit të Kryetarit.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njesisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave funksionale të çdo niveli autoriteti dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë e kompleksitetin e veprimtarisë së njesisë publike, kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njesisë.

Për Vitin 2023

Dokumenti i parë i Programit Buxhetor Afatmesëm, 2023-2025, është miratuar me VKB nr. 81 datë 26.07.2022, konfirmuar nga Prefektura me shkresën *“Verifikimi i ligjshmërisë së aktit”*, nr. 631/2 dt.10.08.2022. Ky dokument është dërguar elektronikisht në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), së bashku me Instrumentin e Planifikimit Financiar më datë 14/6/2023. **Nuk ka shkresë të Ministrisë së Financave për shprehjen e mendimit lidhur me dokumentin e parë të PBA-së 2023-2025.**

Buxheti i vitit 2023 dhe programi buxhetor afatmesëm 2023-2025 janë miratuar me VKB-në, me nr. 150, datë 22.12.2022 *“Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023”*. Ky vendim është bërë publik në portalin vendime.al dhe është dërguar elektronikisht në MFE më datë 02.02.2023. Për vitin 2023 janë 3 raporte monitorimi përkatësisht: për 4-mujorin e parë, për 4-mujorin e dytë (progresivi) dhe për 4 mujorin e tretë (vjetori). Këto raporte janë dërguar elektronikisht në MFE. Raporti për 4-mujorin e I-të të Vitit 2023 është dërguar më datë 31/5/2023, për 4-mujorin e II-të (progresivi) është dërguar më 02/10/2025 dhe për 4-mujorin e III-të (vjetori) është dërguar më 04/04/2023.

Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023 është miratuar edhe në Këshill Bashkiak me VKB nr. 37, datë 21.05.2024 “Për miratimin e raportit mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023”. Raporti është bërë publik në portalin “vendime.al”.

- **Për Vitin 2024**

Dokumenti i parë i Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 është miratuar me VKB nr. 131 datë 27.07.2023, konfirmuar nga Prefektura me shkresën “Verifikimi i ligjshmërisë së aktit”, me nr. 525/8 prot., datë 31.07.2023. Ky dokument është dërguar elektronikisht në MFE, së bashku me Instrumentin e Planifikimit Financiar në datë 14.6.2023. Mendimet e MFE mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, janë shprehur në shkresën e saj, me nr. 11099 prot., datë 19.06.2023. Buxheti i vitit 2024 dhe programi buxhetor afatmesëm 2024-2026 janë miratuar me VKB-në me nr.195, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2024”. Ky vendim është bërë publik në portalin “Vendime.al”. Ky dokument është dërguar elektronikisht në MFE më datë 29.01.2024. Për vitin 2024 janë 3 (tre) raporte monitorimi, përkatësisht: për 4-mujorin e parë, për 4-mujorin e dytë (progresivi) dhe për 4-mujorin e tretë (vjetori).

Në Ministrinë e Financave janë dërguar elektronikisht: Raporti për 4-mujorin e I-rë të Vitit 2024, në datë 31/5/2024, për 4-mujorin e II-të (progresivi), në datë 11/10/2025 dhe për 4-mujorin e III-të (vjetori) dërguar elektronikisht më datë 27.03.2025.

Raporti është dërguar edhe për miratim në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Durrës dhe pritet mbledhja e Këshillit për ta miratuar.

Sipas intervistave të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se janë organizuar takime me drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve, janë organizuar takime me palët e treta, si me grupet e interesit nëpërmjet dëgjësave me publikun. Gjatë **vitit 2023** janë organizuar 18 Dëgjesa Publike, morën pjesë rreth 418 qytetarë, përfaqësues të komunitetit, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendor, përfaqësues të biznesit, shoqëri civile etj., të cilët përfshijnë të gjithë territorin e Bashkisë. Numri i rekomandimeve të dala nga këto dëgjesa Publike është 140.

Gjatë **Vitit 2024** janë zhvilluar 18 dëgjesa publike, të shtrira në të gjitha njësitë administrative, me rreth 399 pjesëmarrës. Numri i rekomandimeve të dala nga këto dëgjesa publike është 73.

Institucioni vepron mbi bazën e Rregullores së Brendshme, e miratuar me Vendimin nr. 69, datë 05.08.2022, e ndryshuar sipas Vendimit nr. 73, datë 03.10.2023 “Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës”, i ndryshuar me vendimin nr. 87, datë 10.10.2024, ku ishte bërë përshkrimi i vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, të cilat janë publikuar edhe në faqen zyrtare të Bashkisë.

Bashkia Durrës për vitin 2023, ka pasur në strukturë **389** punonjës, ndër të cilat **23** vende të lira ku kanë konkurruar **35** konkurrente. Përgjatë Vitit 2023 janë rekrutuar **13** punonjës të rinj. Në Rregulloren e Brendshme janë për çdo Drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo drejtori, sektor dhe specialist.

Bashkia Durrës, për Vitin 2024, ka pasur në strukturë 319 punonjës, ku janë plotësuar nga rekrutimi 13 pozicione pune, ndërsa ka pasur 30 konkurrentë.

Në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni dhe nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe as objektivat për secilin punonjës.

Bashkia Durrës ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet, e cila nuk përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

Problematikë paraqet mungesa e planit strategjik, me objektiva dhe tregues performance të përcaktuar, duke kufizuar në këtë mënyrë matjen e progresit dhe realizimin e qëllimit final të Bashkisë Durrës. Gjithashtu, në Bashkinë Durrës, **vërehet një mungesë e planeve të veprimit për arritjen e objektivave strategjikë.**

Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku Bashkia Durrës përdor fare pak procedurat për delegimin e detyrave, kryesisht atë të delegimit në mungesë.

Struktura e Bashkisë Durrës për vitin 2023

Struktura e miratuar	389	Nëpunës Civilë	212
		Nëpunës me kontratë	140
Numri i të punësuarve me kontratë provizore	-	-	3
Vende vakante (nëpunës civil + kontratë)	-	-	23+12
Punonjës të rekrutuar	-	-	13

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Struktura e Bashkisë Durrës për vitin 2024

Struktura e miratuar	319	Nëpunës Civilë	219
		Nëpunës me kontratë	82
Numri i të punësuarve me kontratë provizore	-	-	3
Vende vakante (nëpunës civil + kontratë)	-	-	16+11
Punonjës të rekrutuar	-	-	13

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësive.

Çdo nëpunës i Bashkisë Durrës ka përshkrimin e punës në përputhje me strukturën aktuale ndërkohë që vlerësimet e performancës realizohen në mbështetje të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Bashkia Durrës, kryen procesin e vlerësimit të performancës në punë të punonjësve në përputhje me formatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës për nëpunësit civilë. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila **ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.**

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, Bashkia Durrës nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Nga Bashkia Durrës është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Bashkia Durrës, konkretisht Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar një plan për trajnime të brendshme sipas kërkesave të drejtorive përkatëse, pra, nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Për vitin 2023, janë kryer nga ASPA 25 trajnime, ku kanë marrë pjesë 37 nëpunës të institucionit. Ndërsa për **vitin 2024** janë kryer nga ASPA 69 trajnime, ku kanë marrë pjesë 44 punonjës.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar, për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësisë dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

Nga analiza e këtij parimi, rezultoi se Bashkia Durrës, kryesisht, ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, në dokumentin e rregullore së brendshme.

Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar një plan strategjik dhe plane operationale pune, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Konstatohet se edhe **për vitin 2023**, Bashkia Durrës ka vijuar punën sipas shkresës me nr. 3293 prot., datë 13.04.2022, ku nga materiali i vënë në dispozicion grupit të auditimit nga Drejtoria Ekonomike pranë Bashkisë Durrës, rezultoi se Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 175 datë 13.04.2022 *“Për riformatimin e grupit për Menaxhimin Strategjik në Bashkinë Durrës”*. Në këtë urdhër është ngritur GMS me 16 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë (NA) dhe me shkresën nr.3293/1 prot., datë 13.04.2022, Titullari e Njesisë bën me dije të gjitha drejtoritë për ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP). Rezultoi se GMS është riformatuar edhe për Vitin 2024, bazuar në urdhrin me nr.52, datë 27.02.2024 të kryetarit të Bashkisë Durrës.

GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. Bashkia Durrës zhvillon takimet e GMS, por në pak raste diskutohen zhvillimet lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe kryesisht këto takime nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale.

Me shkresën nr. 2765/1 prot., datë 27.02.2024 i është dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE *“Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Durrës dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”* për vitin 2023. Kurse **me shkresën me Nr. 2684/2 prot., datë 28.02.2025** është dërguar pranë Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit *“Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”*, **për Vitin 2024**.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi, se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm, në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë. Referuar kësaj deklarate, Bashkia Durrës, ka parashikuar të marrë këto masa për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit:

1. Rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit, në lidhje me rolin dhe përgjegjësinë për ngritjen dhe zbatimin me sukses të sistemeve të MFK dhe rolin e AB;
2. Zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut;
3. Monitorimin e vazhdueshëm të planeve strategjike dhe operationale të njësisë, etj.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”.

Në zbatim të Ligjit nr. 10296/2010 *“Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* i ndryshuar, neni 21 *“Menaxhimi i riskut”* përfshin: identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin, mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme, se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 6 – *Specifikimi i objektivave të përshtatshëm.*

Parimi 7 – *Identifikimi dhe analiza e risqeve.*

Parimi 8 – *Mundësia e riskut të mashtrimeve.*

Parimi 9 – *Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme.*

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm, për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse, në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Nga analiza e të dhënave, duke marrë në konsideratë se Bashkia Durrës duhet të specifikojë dokumentet e planifikimit, njësia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Bashkia Durrës në dokumentet e PBA-së ka paraqitur disa tregues performance, por ato nuk janë për çdo program buxhetor. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se për periudhën 2023-2024, Bashkia Durrës nuk ka plan-veprime vjetore operacionale, të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial, ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nga analiza e këtij parimi rezultoi se përgjithësisht institucioni nuk ka përcaktuar mekanizma të mirë organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut. Evidentohen problematika në hartimin e regjistrit të konsoliduar të risqeve për Vitet 2023-2024, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Durrës dhe në monitorimin e raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë, me qëllim menaxhimit efektiv të tyre.

Nëpërmjet Urdhrit me nr. 175, datë 13.04.2022 është ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe është hartuar regjistri i riskut nga disa prej strukturave të Bashkisë Durrës. Nëpërmjet shkresës nr. 15184, datë 03.10.2019 “Për caktimin e koordinatorit të deleguar të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në Bashkinë Durrës”, Nëpunësi Autorizues funksionet e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatorit të Riskut janë deleguar tek dy punonjës, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve .

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë), në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit, duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Në këto kushte, evidentohet se Bashkia Durrës **nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve**, për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi, apo raste të raportimit mashtrues për periudhën e auditimit 2023-2024, ndonëse nga Kryetari i Bashkisë Durrës ka urdhra dhe shkresa që detyron drejtoritë respektive, që të bëjnë evidentimin dhe të raportojnë problematikën e riskut dhe masat e mara për menaxhimin dhe uljen e pasojave të riskut.

Nëpërmjet Vendimit nr.127 datë 28.10.2021 të Këshillit Bashkiak Durrës është miratuar Plani i Integritetit në Bashkinë Durrës, ku në thelb të këtij Plani është të parandalojë, zvogëlojë dhe të eliminojë mundësitë e zhvillimit të korrupsionit dhe parregullsive të tjera në Institucion.

Parimi 9- *Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.*

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme e të jashtme, të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Nga vlerësimi i këtij parimi rezultoi se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Durrës në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi, apo riorganizimi i këtij institucioni, por këto ndryshime strukturore, apo menaxheriale, duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës, apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në zbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, neni 22 “*Veprimtaritë e Kontrollit*” përfshijnë: procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 10 – *Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.*

Parimi 11 – *Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.*

Parimi 12 – *Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave.*

Parimi 10 – *Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.*

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë), duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

Në vijim të analizës së kryer, mund të themi se ende ka problematika për t'u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave, apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësi.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori Ekonomik (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i Kontabilitetit/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).

Bashkia Durrës i ka të qarta procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, regjistër prokurimesh si dhe regjistër aktivesh të përditësuar në SIFQ. Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili përditësohet sa herë ka ndryshime fondesh.

Bashkia Durrës ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit, për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. **Aktivet e rëndësishme (me vlera të konsiderueshme) dhe aktivet afatgjata nuk ruhen nga përdorimi i paautorizuar me anë të një procedure të shkruar.**

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat, i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit. Për Vitin 2024 ka 2 Urdhra nga Kryetari i Bashkisë Durrës, respektivisht me nr. 319, datë 09.09.2024 dhe nr. 311, datë 06.09.2024, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve, ku plotësohet gjatë vitit regjistri i aktiveve dhe dorëzohet pranë Drejtorisë Ekonomike, Bashkia Durrës.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë .

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollat e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Përsa i përket ndarjes së detyrave, për funksionimin e sistemit të teknologjisë së informacionit, ato janë kryesisht të evidentuara në rregulloret e brendshme dhe përshkrimet e punës.

Sektori i informatikës, teknologjisë së shërbimit ndjek procesin e informatizimit dhe kompjuterizimit në Bashki, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK dhe ofron asistencë teknike ndaj punonjësve të Bashkisë për mirë përdorimin dhe shfrytëzimin sa më të efektshëm të teknologjisë në dispozicion.

Mungon sistemi i IT-së dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).

Parimi 12–Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave .

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

Bashkia Durrës **nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit, për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj, në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme, në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.** Bashkia Durrës nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në zbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 23 “Informimi dhe komunikimi” përfshin: Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 13 – Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor.

Parimi 14 – Komunikimi i brendshëm.

Parimi 15 – *Komunikimi i jashtëm.*

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të analizës së kryer, rezultoi se Bashkia Durrës i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. Ajo ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit, por ky **sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.**

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike, me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Durrës për mbajtjen e kontabilitetit operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike. Monitorimi i të ardhurave kryhet me program të veçantë, të cilin e menaxhon Sektori i Tatim-Taksave.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, Bashkia Durrës sqaron se parimet bazë dhe procedurat e komunikimit janë përcaktuar në dokumentin e rregullores së brendshme të institucionit. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e Bashkisë Durrës. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta, lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia Durrës është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor, apo në rrugë elektronike nëpërmjet aksesit në adresat zyrtare të “e-mailit”.

Bashkia Durrës nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.

Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Për **vitin 2023** janë kryer **18** dëgjesa publike dhe numri i rekomandimeve për këto dëgjesa ka qenë **140** rekomandime, kurse për **vitin 2024** janë kryer **18** dëgjesa publike, me 399 pjesëmarrës, me një shtirje në të gjitha njësitë administrative, në varësi të Bashkisë Durrës.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në zbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 24 “Monitorimi” përcakton se monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohen, kryesisht, përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 16 – Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta;

Parimi 17 – Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Nga analiza e kryer, vlerësohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Raportohet mbi baza periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe GMS, për veprimtarinë financiar referuar parashikimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Bashkia Durrës monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave për vitin 2023, me shkresën me nr. 2765/1 prot. datë 27.02.2024, kurse për Vitin 2024 me shkresën, me nr. 2864/2 prot., datë 28.02.2025.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm. Njësia e Auditit të Brendshëm ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara.

Bashkia Durrës nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi, ndonëse rekomandimet e lëna ndiqen nëpërmjet një planveprimi të hartuar nga struktura përkatëse.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë .

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit, ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. Në bazë të analizës dhe vlerësimit të kryer, referuar edhe komponentëve sa më sipër, titullari e institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet planveprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe ka organizuar e realizuar programe angazhimi të veçantë, për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë, në përgjithësi mirë, duke qenë pjesërisht efektive në të gjithë strukturat e njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët, si:

- Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Bashkia Durrës nuk ka hartuar planin vjetor të punës për vitet 2023-2024 dhe nuk janë evidentuar raporte për kryerjen e analizave periodike, apo vjetore të punës mbi analizat e arritura. Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, Bashkia Durrës nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Një problematikë tjetër e evidentuar është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore, apo kodin e etikës. Bashkia Durrës zbaton kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin për sinjalizuesit, *por ende nuk ka procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla.*

Bashkia Durrës ka mungesa të raportimeve të rregullta periodike nga njësitë e varësisë dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance e risqet përkatëse mbi këto objektiva, gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar, mbi rregullat e raportimit në institucion.

Mungon plani i menaxhimit të risqeve të nivelit të lartë e të mesëm për veprime korigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni dhe nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës.

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit, e për rrjedhojë, as rregullore për të, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, neni 13 *“Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.*

Bashkia Durrës zhvillon takimet e GMS, por në pak raste diskutohen zhvillimet lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe kryesisht këto takime nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale.

Mangësitë e evidentuara mbi zbatimin e këtyre parimeve janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20; -Ligjin nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, neni 13; -Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”*, pika 2.2.1 *“Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK”* a,b,c,d, pika 2.2.4, pika 2.3.1; -VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, Kreu II. *“Dosja e Personelit”*; -*“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III *“Komponentët e MFK”* pika 3.1, Kapitulli IV *“Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”*, Kapitulli V, Aneksat.

- **Komponenti “Menaxhimi i Riskut”**

Bashkia Durrës nuk ka plan-veprime vjetore operacionale, të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate dhe persona konkrete përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Evidentohen problematika në hartimin e regjistrit të konsoliduar të risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Durrës, si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë, me qëllim menaxhimin efektiv të tyre.

Në këto kushte, evidentohet se Bashkia Durrës nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve, për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi, apo raste të raportimit mashtrues.

Mangësitë e evidentuara mbi zbatimin e këtyre parimeve janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2; -Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e*

koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR”; -“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

- Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”.

Bashkia Durrës nuk ka hartuar hartat, apo manualet e proceseve të punës, kjo sjellë si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësi.

Aktivitetet e rëndësishme (me vlera të konsiderueshme) dhe aktivitetet afatgjata nuk ruhen nga përdorimi i paautorizuar me anë të një procedure të shkruar.

Bashkia Durrës nuk përdor sisteme të teknologjisë së informacionit përveç atyre fikse përdorimi i të cilëve është mundur nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si dhe nuk ka procedura të brendshme specifike për këtë fushë. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (“back-up”).

Bashkia Durrës nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

Bashkia Durrës nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmë auditimi ka vetëm Drejtoria Ekonomike.

Mangësitë e evidentuara mbi zbatimin e këtyre parimeve janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1; -Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinuarit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinuarit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”; -“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

- Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Bashkia Durrës ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda edhe jashtë institucionit, por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Bashkia Durrës nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.

Mangësitë e evidentuara mbi zbatimin e këtyre parimeve janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, “Informacioni dhe Komunikimi” pika 2; -“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

- Komponenti: “Monitorimi”

Bashkia Durrës nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

Mangësitë e evidentuara mbi zbatimin e këtyre parimeve janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1; -“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i

miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK-së”, pika 3.5, Kapitulli V, Aneksët.

Përsa i përket sistemit të MFK: Në Bashkinë Durrës funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur mangësi, duke sjellë si fenomen, që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar, për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: E. L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, DH. GJ. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, N. Z. me detyrë Specialiste e strukturës Financë-Buxhet (e deleguar si koordinatorë e MFK dhe Risku në Bashkinë Durrës, deri në 30.11.2023, periudhë kur është larguar nga puna), I. F. Specialiste e strukturës Financë-Buxhet (e deleguar si koordinatorë MFK dhe Riskun në Bashkinë Durrës).

Nga subjekti audituar Bashkia Durrës në fazën Projekt raport, nuk janë paraqitur kundërshti në lidhje me këtë pikë të programit.

Nënpika 2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Nënpika 2.1.3 Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.

Në zbatim të Ligjit Nr. 114/2015, datë 20.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se: “Të gjitha njësitë publike, të përfshira në Nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në germa “a”-“c”, të kësaj pike” është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Auditit të Brendshëm (DAB) në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Durrës, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditit të Brendshëm.

Viti 2023

Gjatë periudhës proces auditimi (Viti 2023), DAB Bashkia Durrës është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të: Vendimit të Këshillit Bashkiak me Nr. 69, datë 05.08.2022, nga 01.01.2023 - 03.10.2023 dhe nga data 03.10.2023 e në vijim (31.12.2023), me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 73, datë 03.10.2023.

Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Durrës, nga data 01.01.2023 - 15.06.2023 ka funksionuar me 3 punonjës (1+2), numër ky i miratuar me Vendim nr. 69 prot., datë 05.08.2022 “Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës”.

Nga data 15.06.2023 deri në 14.11.2023, kjo strukturë ka funksionuar me dy auditues, për shkak të daljes në pension të drejtorit të Njesisë së AB.

Me vendimi Nr. 73, prot. 9173, datë 03.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, “Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës, theksojmë se numri i audituesve ka ndryshuar në 5 punonjës, (1+4), ku një auditues ka qenë me leje lindje.

Për periudhën nga data 01.01.2023 – 03.10.2023, sipas VKB-së me Nr. 69, datë 05.08.2022

Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka pasur në strukturën e saj, 1 (një) Drejtor të Auditit të Brendshëm dhe dy specialiste audit, konkretisht: Drejtor i Auditit të Brendshëm, M. P. dhe 2 (dy) specialistë audit, nga këto 1 specialist në Sektorin e Kontrollit të Plotë, znj. R. A. dhe 1 (një) specialist në

Sektorin e Kontrollit Tematik, zj. O. D, e cila duhet të ishte e pajisur me certifikatën, si Audituese e Brendshme brenda dy vitesh nga data e emërimit, në kundërshtim me Nenin 11, pika c e Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, i ndryshuar “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”.

Struktura e njësisë AB (periudha 01.01.2023 - 03.10.2023) për Vitin 2023

Nr.	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme	Aktualisht në punë apo larguar, data
Për Vitin 2023								
1	M. P.	Drejtor	04.04.2003	Ekonomi-Financë	21-vite	2006	-	Në pension dt.15.06.2023
2	R. A.	Spec./Auditi	01.08.2018	Ekonomi-Financë	6-vite	2021	1	Në punë
3	O. D.	Spec./Auditi	01.09.2022	Administrim biznes	2-vite	2023	-	Në punë

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Për periudhën nga datë 03.10.2023 e në vijim, sipas VKB-së me Nr. 73, datë 03.10.2023.

Drejtorja e Auditit të Brendshëm ka në strukturën e saj, 1 (një) Drejtor të Auditit të Brendshëm dhe 4 (katër) specialiste audit, konkretisht: Drejtor i Auditit të Brendshëm, O. D, në kundërshtim me Nenin 11, pika b e Ligjit Nr. 114, datë 22.10.2015, i ndryshuar “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të ketë përvojë pune 5-vite në profesion, nga të cilat jo më pak se 3-vite në fushën e auditimit dhe të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik” dhe 4 (katër) specialistë audit, nga këto 2 (dy) specialistë në Sektorin e Kontrollit të Plotë, R. A dhe I. V dhe 2 (dy) specialistë në Sektorin e Kontrollit Tematik: N. B dhe M. V.

N. B, I. V dhe M. V (larguar në 24.01.2024), të cilët duhet të certifikohen si Auditues të Brendshëm, brenda 3 (tri) vitesh nga data e emërimit, sipas përcaktimeve të Nenit 11, pika ç, e Ligjit Nr. 114, datë 22.10.2015, i ndryshuar “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, ç) nëpunësi civil ose punonjësi që punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, gjatë 3 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e drejtuesit të njësisë së Auditimit të Brendshëm, ose të një audituesi të brendshëm të certifikuar dhe me eksperiencë. Brenda kësaj periudhe, ky punonjës i nënshtrohet detyrimit të procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”. Në rast se brenda këtij afati nëpunësi civil ose punonjësi nuk certifikohet si: “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, i ndërpriten marrëdhëniet e punës, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji.

Konkluzion: Gjatë vitit 2023 është konstatuar se veprimtaria e Auditit të Brendshëm, pranë Bashkisë Durrës ka funksionuar në kundërshtim me pikën 3, të VKM-së Nr. 83, datë 03.02.2016, “Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik” dhe Rregulloren e Brendshme “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Durrës”, Drejtorja e Burimeve Njerëzore, pikat 1,2,3 dhe 4.”

Struktura e njësisë AB (periudha 03.10.2023 - 31.12.2023) për Vitin 2023

Nr.	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme	Aktualisht në punë apo larguar, data
Për Vitin 2023								
1	O. D.	Drejtor	01.11.2023	Administrim biznes	2-vite	2023	-	Në punë
2	R. A.	Spec./Auditi	01.08.2018	Ekonomi-Financë	6-vite	2021	09-13.10.2023	Në punë
3	N. B.	Spec./Auditi	14.11.2023	Informatikë-Ekonomike	-	-	-	Në punë
4	I. V.	Spec./Auditi	14.11.2023	Ekonomi-Financë	-	-	-	Në punë
5	M. V.	Spec./Auditi	14.11.2023	Administrim biznes	-	-	-	Larguar dt.24.01.2024

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Bashkia Durrës në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së saj dhe përmbushjes së objektivave të vendosura ka miratuar Rregulloren e Brendshme. Në Kreun V, të kësaj rregulloreje, janë përcaktuar misioni i njësisë së auditimit të brendshëm, mënyra e organizimit, kuadri ligjor, përgjegjësitë e drejtuesit të NJAB dhe audituesve të brendshëm, detyrat funksionale të tyre, bashkëpunimi me menaxhimin dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm etj.

Në Raportin mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm në Bashkinë Durrës për vitin 2023, me nr. 2164 prot., datë 14.02.2024 “*Mbi veprimtarinë audituese të drejtorisë së auditimit të brendshëm*”, në Kapitullin VII “*Kapacitetet Audituese*” evidentohet problematika lidhur me burimet njerëzore. “... Theksojmë se numri i audituesve (2+1) nuk i mbulon me auditime të gjithë subjektet e Bashkisë, siç edhe ka vepruar Bashkia Durrës në pjesën më të madhe të vitit 2023. Pra, deri në 15.06.2023 ka funksionuar me 3-punonjës (1 Drejtor dhe 2 Specialistë), kurse pas daljes në pension të drejtorit të njësisë ka funksionuar me 2 punonjës!

- Viti 2024

Gjatë periudhës proces auditimi, 01.01.2024-31.12.2024, struktura e DAB Bashkia Durrës është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 73, datë 03.10.2023 “Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës. Struktura e DAB ka funksionuar me 5 punonjës (1+4). Nga informacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, nga NJAB Bashkia Durrës, rezultoi se: Gjatë vitit 2024, Njësia e Auditimit ka pësuar ndryshime në përbërjen e saj, si pasojë e largimeve dhe mungesave të përkohshme të stafit. Më datë 04.01.2024, Spec. e Auditit, I. V ka qenë me leje lindje, për periudhën (04.01.2024 – 30.12.2024). Me Vendimin nr. 15, nr. 1221/1 prot., datë 24.01.2024, është larguar nga detyra specialisti z. M. V.

Rezultoi se prej datës 24.01.2024, deri më 31.12.2024, Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka ushtruar veprimtarinë e saj, duke funksionuar me vetëm 3-punonjës.

Drejtoria e Auditit të Brendshëm, rezultoi se ka në strukturën e saj, 1 (një) Drejtor të Auditit të Brendshëm dhe 4 (katër) specialiste audit, konkretisht: Drejtor i Auditit të Brendshëm, O. D, në kundërshtim me Nenin 11, pika b e Ligjit Nr. 114, datë 22.10.2015, i ndryshuar “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të ketë përvojë pune 5-vite në profesion, nga të cilat jo më pak se 3-vite në fushën e auditimit (emërimi 01.09.2022 si Spec.Auditi) dhe të jetë i certifikuar si: “Auditues i brendshëm në sektorin publik” dhe 4 (katër) specialistë audit, nga këto 2 (dy) specialistë në Sektorin e Kontrollit të Plotë, R. A dhe I. V dhe 2 (dy) specialistë në Sektorin e Kontrollit Tematik N. B dhe M. V.

N. B dhe I. V duhet të certifikohen si Auditues të Brendshëm brenda 3 (tre) vitesh nga data e emërimit, sipas përcaktimeve të Nenit 11, pika ç, e Ligjit Nr. 114, datë 22.10.2015, i ndryshuar “*Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik*”, ç) nëpunësi civil ose punonjësi që punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, gjatë 3-viteve të para punon nën mbikëqyrjen e drejtuesit të njësisë së Auditimit të Brendshëm, ose të një audituesi të brendshëm të certifikuar dhe me eksperiencë. Brenda kësaj periudhe, ky punonjës i nënshtrohet detyrimit të procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”. Në rast se brenda këtij afati nëpunësi civil ose punonjësi nuk certifikohet si: “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, i ndërpriten marrëdhëniet e punës, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji.

Struktura e njësive AB (periudha 01.01.2024 - 31.12.2024) për Vitin 2024

Nr.	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme	Aktualisht në punë apo larguar, data
Për Vitin 2024								
1	O. D.	Drejtor	01.11.2023	Administrim biznes	3-vite	2023	02-06.12.2024	Në punë
2	R. A.	Spec./Auditi	01.08.2018	Ekonomi-Financë	7-vite	2021	04-08.11.2024	Në punë
3	N. B.	Spec./Auditi	14.11.2023	Informatike Ekonomike	1-vit	-	-	Në punë
4	I. V.	Spec./Auditi	14.11.2023	Ekonomi-Financë	1-vit	-	-	Në punë (Leje lindje 04.01.2024- 30.12.2024)
5	M. V.	Spec./Auditi	14.11.2023	Administrim biznes	-	-	-	Larguar dt.24.01.2024

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Në Raportin mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm në Bashkinë Durrës për Vitin 2024, me nr. 2164 prot., datë 14.02.2024 dhe me nr. 2277 prot., datë 13.02.2025, “Mbi veprimtarinë audituese të drejtorisë së auditimit të brendshëm”, në Kapitullin VII “Kapacitetet Audituese” evidentohet problematika lidhur me burimet njerëzore. “... Theksojmë se numri i audituesve (2+1) nuk i mbulon me auditime të gjithë subjektet e Bashkisë, si ka vepruar Bashkia Durrës edhe në pjesën më të madhe të Vitit 2024. Pra, nga 24.01.2024, deri në 31.12.2024, struktura ka funksionuar me 3-punonjës (1 Drejtor dhe 2 Specialistë)!

Konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi, për Vitet 2023-2024, njësia ka funksionuar në zbatimin e detyrave funksionale, me staf të reduktuar, në kundërshtim me Manualin e Auditit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.1.1, *Standardi 2230 - Shpërndarja e burimeve në angazhim*

“Audituesit e brendshëm duhet të përcaktojnë burime të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të arritur objektivat e angazhimit, duke u bazuar në vlerësimin e natyrës dhe kompleksitetit të secilit angazhim, kufizimeve kohore dhe burimet në dispozicion”.

Referuar sa më sipër, duke qenë se Bashkia Durrës është një nga njësitë vendore më të mëdha dhe më të rëndësishme, me një shtrirje të gjerë, me një kompleksitet veprimtarie dhe Drejtori (subjektesh) në varësi, vlerësojmë se është i rëndësishëm fuqizimi i rolit të NJAB.

Stafi auditues u intervistua lidhur me njohuritë mbi rolin, përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë e tyre për shërbimin që ofrojnë, ku u evidentua se eksperiencia profesionale e tyre në fushën e auditimit është (0-7) vite.

• Trajnimet e NJAB dhe certifikimet.

Referuar Ligjit nr. 114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” rëndësi i është kushtuar trajnimeve të audituesve të NJAB, sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Audituesit e brendshëm duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e Drejtuesit të auditimit të brendshëm, ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo auditues duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikën e reja të auditimit.

Për vitin 2023 dhe 2024, trajnimet e audituesve të NJAB, për Bashkinë Durrës, pasqyrohen sipas Aneksit 2.1.2.1 bashkëlidhur PRA:

Konkluzion: Për periudhën objekt auditimi, 01.01.2023 - 31.12.2023, audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat, por edhe sipas programit të planifikuar në Planin Strategjik të Auditimit, të miratuar me shkresën nr. 8430/2, datë 17.10.2022. Kurse për periudhën e audituar 01.01.2024 -

31.12.2024, referuar edhe informacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se nga NJAB Bashkia Durrës, trajnimet janë realizuar sipas programit të planifikuar në Planin Strategjik, me Nr. 8786/1 prot., datë 19.10.2023, i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Durrës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1216/15 prot., datë 22.08.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1347/12 prot., datë 26.08.2025, nga Drejtori i Auditit të Brendshëm, pranë Bashkisë Durrës, O. D. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Procesi i trajnimit të audituesve të brendshëm është organizuar dhe zhvilluar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave, sipas kalendarit të miratuar. Temat e zgjedhura për trajnim nuk përcaktohen domosdoshmërisht nga kërkesa e një institucioni në veçanti, por nga përmbledhja e të gjitha kërkesave që dërgohen në DHAB, nga njësitë e auditimit, sipas nevojave. Si rrjedhojë përzgjedhja e temave nuk varet nga Njësia e Auditit të Brendshëm.

Gjithashtu edhe përzgjedhja e temave të trajnimit të zhvilluar për audituesit e brendshëm në detyrë, nga Projekti Zviceran SEÇO (Financave vendore 2018-2023) nuk varet nga Njësitë e Auditit të Brendshëm, po bëhet në bashkëpunim me DHAB.

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH në raportin përfundimtar të mëparshëm nr. 765/22 prot. datë 02.05.2024, lidhur me nevojën për trajnimin e audituesve, NJAB ka shtuar dhe ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme programet e trajnimit profesional. Këto trajnime janë realizuar në përputhje me kërkesat e nenit 15, pika d dhe nenit 16 pika dh të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" i ndryshuar, me qëllim përditësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe aftësive profesionale.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga informacioni i vendosur në dispozicion grupit të auditimit, **pretendimi juaj merret në konsideratë.** Audituesit e Bashkisë Durrës gjatë vitit 2024 janë trajnuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe nga projekti Zviceran Seço.

- Komiteti i Auditit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësiave të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Durrës.

Ministri i Financave, në cilësinë e organit që bashkërendon, harmonizon dhe monitoron veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, me shkresën nr. 13893 prot., datë 22.07.2019 "*Mbi krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm*", ka ofruar asistencë në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Durrës nëpërmjet propozimit të disa hapave konkretë.

Referuar ligjit nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", neni 12, pika b, përcakton se: *Titullari i Njësisë Publike është përgjegjës për vendimmarrjen e krijimit të Komitetit të Auditimit publik*", neni 13 "*Komitetit të Auditimit të Brendshëm*".

Konkluzion: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 të ligjit 114/2015 "*Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*".

Nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*".

- **Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik.**

Karta e Auditimit është një akt administrativ, që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Durrës, e cila për vitin 2023 është miratuar nga titullari me shkresën nr. 2843/1 prot., datë 15.02.2017 dhe rezultoi se nuk është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016”.

Për Vitin 2024, karta e auditit të brendshëm pranë Bashkisë Durrës është miratuar nga titullari me shkresën me nr. 11138 prot., datë 25.09.2024, vendim nr. 360, datë 25.09.2024, për të cilën është raportuar në Ministrinë e Financave me shkresën me Nr. 11138/2 prot., datë 30.09.2024. Rezultoi se nuk është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016”.

Konkluzion: Karta e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2023 nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm”.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Durrës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1216/15 prot., datë 22.08.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1347/12 prot., datë 26.08.2025, nga Drejtori i Auditit të Brendshëm, pranë Bashkisë Durrës, O. D. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Në zbatim të rekomandimit të lënë në raportin e mëparshëm përfundimtar të KLSH-së, me nr. 765/22 prot., datë 02.05.2024, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Durrës, nr. 360 prot. 11138, datë 25.09.2024 është përditësuar dhe miratuar Karta e Auditimit të Brendshëm në Njësinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Durrës, e cila është hartuar në përputhje të plotë me formatin standard 1, të Kapitullit nr.2, e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016", dhe përmban të gjithë kapitujt e sugjeruar. Gjithashtu në “Kartën e Auditimit të Brendshëm” është përfshirë çdo kërkesë dhe rekomandim i Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe dokumentacionin bashkëngjitur në observacion, rezultoi se karta e auditimit nuk ka reflektuar ndryshimet e urdhrit nr. 4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesa dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm”, pika 1 dhe pika 2.

Sa me sipër observacioni nuk merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.

- **Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve**

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publike dhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3-vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE-së, Nr. 100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:

“Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën **10 Tetor të çdo viti**. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data **20 Tetor e çdo viti**, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.....”.

- **Për Vitin 2023**

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar edhe miratuar plani strategjik 2023-2025. Plani strategjik për vitet 2023-2025 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2023 janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 8430/2 prot., datë 17.10.2022, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Në Planin Strategjik për vitet 2023-2025, planifikimi i subjekteve të cilat janë parashikuar të auditohen nuk është në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Konkluzion: Në Planin Strategjik për Vitet 2023-2025, nuk janë planifikuar të auditohen subjektet sipas identifikimit të riskut që përcaktohen në Manualin e Auditimit të Brendshëm i cili citon se: “Plani strategjik i veprimtarisë së NJAB bazohet në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve. Në vitin e parë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të lartë, në vitin e dytë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të ulët se në vitin e parë dhe në vitin e tretë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të ulët se në vitin e dytë, por duhet respektuar frekuenca jo më shumë se 5-vjet”.

- **Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për Vitin 2023**

Për vitin 2023, janë planifikuar për t’u kryer **9** auditime dhe janë realizuar **7**, pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Planifikuar	Nr. Auditime	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr. Auditime	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	I plotë/Kombin		
1	Drejtoria e Taksave (regj.,dok.i kontrollit)	1	Njësitë Administrative	1	1					1	
2	Drejtoria e Shërbimit, Sek.i Prokurimeve	1	Drejtoria e MZSH Durrës	1	1					1	
3	Njësitë Administrative të fshatrave	1	Drejtoria e Shërbimeve (Sek. i Prokurimeve)	1					1	1	
4	Shërbimi i M.Z.SH	1	QEA (Qendra Ekonomike e Arsimit)	1	1					1	
5	Qendra Ekonomike e Arsimit	1	Zbatim Rekomandime KLSH+ Audit i Brendshëm	1					1	1	
6	Ndërmarrja Komunale Plazh	1	Ndërmarrja Komunale Plazh	1					1	1	
7	Ndërmarrja Komunale e Shërbimeve	1	Ndërmarrja Rruga	1					1	1	
8	Ndërmarrja e Rugëve	1									
9	Zbatim detyrash	1									
		9	Totali	7	3	0	0	0	4	7	S'ka

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2023 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit, të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 2164 prot., datë 14.02.2024.

Në misionet e kryera të auditimit, rezultoi se janë dhënë **58** rekomandime gjithsej, nga të cilat **52** janë pranuar nga subjektet objekt auditimi, **6** pa pranuar.

Nga rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi **29** prej tyre.
Në mënyrë të përmblodhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar	Ne proces	Gjithsejtë numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	2023	58	52	29	29	0			
TOTALI		58	52	29	29	0			

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konkluzion: Për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Durrës, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si: Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria Ekonomike, etj, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm *“Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”*.

- Për Vitin 2024

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar edhe miratuar plani strategjik 2024-2026. Planin strategjik për vitet 2024-2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2024, (si dhe i ndryshuari gjatë Vitit 2024) janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, me shkresën me nr. 8786/1 prot., datë 19.10.2023 “Dërgojmë planin strategjik dhe vjetor të NJAB Bashkia Durrës për periudhën 2024-2026” dhe “Dërgojmë ndryshimin e planit vjetor” me shkresat me nr. 11094/1 prot., datë 26.09.2024 dhe 12619/3 prot., datë 08.11.2024, në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*.

Në Planin Strategjik për vitet 2024 - 2026, planifikimi i subjekteve të cilat janë parashikuar të auditohen janë: Drejtoria e Taksave, Qendra Ekonomike e Arsimit, Ndërmarrja Komunale Plazh, Ndërmarrja e Komunale e Shërbimeve, Ndërmarrja e Rugëve, Qendra Kulturore Durrës, Klubi i Futbollit “Teuta”, Zbatim Detyrash. Planifikimi i subjekteve të cilat janë parashikuar të auditohen nuk është në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Në Planin Strategjik për vitet 2024 - 2026, i ndryshuar, planifikimi i subjekteve të cilat janë parashikuar të auditohen janë: Agjencia e Parqeve Urbane, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Ndërmarrja Komunale Plazh, Ndërmarrja Komunale e Shërbimeve, Ndërmarrja e Rugëve, Ndërmarrja e Komunale e Shërbimeve, Klubi i Futbollit “Teuta”, Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Zbatim Detyrash.

Konkluzion: Në Planin Strategjik për Vitet 2024 - 2026, vetëm me ndryshimet e planifikuara sipas shkresave me Nr. 11094 prot., datë 25.09.2024 dhe Nr. 12619/2 prot., datë 04.11.2024 për përfshirjen në proces auditimi të subjekteve me risk, sipas identifikimit të riskut që përcaktohen në Manualin e Auditimit të Brendshëm, i cili citon se: *“Plani strategjik i veprimtarisë së NjAB bazohet në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve. Në vitin e parë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuar me risk më të lartë. Në vitin e dytë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuar me risk më të ulët se në vitin e parë dhe në vitin e tretë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuar me risk më të ulët se në vitin e dytë, por duhet respektuar frekuenca jo më shumë se 5 vjet”*.

Për vitin 2024, janë planifikuar për t'u kryer 9 auditime dhe janë realizuar 9, pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Planifikuar	Nr. Auditime	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr. Auditime	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputhshmëri	Performancë	Financë	IT	I plotë/Kombin		
1	Agjencia e Parqeve Urbane	1	Agjencia e Parqeve Urbane	1	1					1	
2	Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike	1	Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike	1	1					1	
3	Ndërmarrja Komunale Plazh	1	Ndërmarrja Komunale Plazh	1	1					1	
4	Ndërmarrja Komunale e Shërbimeve	1	Ndërmarrja Komunale e Shërbimeve	1					1	1	
5	Ndërmarrja e rrugëve	1	Ndërmarrja e rrugëve	1	1					1	
6	Ndërmarrja Komunale e Shërbimeve	1	Ndërmarrja Komunale e Shërbimeve	1	1					1	
7	Klubi i Futbollit "Teuta"	1	Klubi i Futbollit "Teuta"	1					1	1	
8	Qendra Ekonomike e Arsimit	1	Qendra Ekonomike e Arsimit	1	1				1	1	
9	Zbatim detyrash	1	Zbatim detyrash	1						1	
		9	Totali	9	6	0	0	0	3	9	S'ka

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2024 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 2277 prot., datë 13.02.2025.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2024, rezultoi se janë dhënë 73 rekomandime gjithsej, nga të cilat 73 janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi 27 prej tyre. Në mënyrë të përmblodhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr.	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej numër	Pranuar	Zbatuar	Në proces	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	2024	73	73	46	27	0			
TOTALI		73	73	46	27	0			

Burimi: NJAB Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konkluzion: Për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Durrës, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si: Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria Ekonomike, etj, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm *“Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”*.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Durrës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1216/15 prot., datë 22.08.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1347/12 prot., datë 26.08.2025, nga Drejtori i Auditit të Brendshëm, pranë Bashkisë Durrës, O. D. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Drejtoria e Auditit të Brendshëm për Vitin 2023 ka mbuluar me auditim këto subjekte, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë si: Drejtoria e Shërbimeve (Sektori i Prokurimeve);

Ndërmarrja Rrugë, Ndërmarrja Komunale Plazh, QEA Durrës.

-Auditimi për "Zbatim rekomandimesh KLSH dhe NJAB" bazuar në udhëzimin e

Ministrit të Financave nr. 42, prot. 2025, datë 27.10.2020, si një angazhim i detyrues, pavarësisht riskut.

-Subjektet e tjera si: Njësiti Administrative, DMZSH për të cilat si detyrim ligjor duhej respektuar frekuenca e jo më shumë se 5-viteve.

-Gjithashtu, theksojmë faktin se Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Durrës deri në datën 15.06.2023 ka funksionuar me 3 punonjës (1+2), ndërsa nga data 15.06.2023, deri në fund të vitit 2023, të gjitha auditimet janë kryer vetëm nga dy auditues për shkak të daljes në pension të drejtorit të Njesisë. Me shkresën, me nr. prot. 5202/3, datë 07.06.2023 është konfirmuar nga Titullari i Bashkisë shtyrja e afatit kohor të angazhimit të auditimit, për zbatimin e rekomandimeve deri më 15.07.2023, për arsyen e daljes në pension të drejtorit të NJAB-së, më datën 15.06.2023 dhe me shkresën, me nr. prot. 9478/1 datë 23.11.2023 është konfirmuar nga Titullari i Bashkisë shtyrja e afatit kohor të angazhimit të auditimit në

Ndërmarrjen Rrugë deri më 19.12.2023, për arsyen e madhësisë, kompleksitetit të njesisë dhe numrit të kufizuar të audituesve. Për këtë arsye është shtyrë edhe auditimi për vitin pasardhës i subjektit të planifikuar "Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore", subjekt

me risk të lartë. Shpërndarja e burimeve në këto angazhime auditimi është bërë referuar Manualit të Auditit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.1.1 "Stafi i njesisë së Auditit të Brendshëm", standarti 2230 "Shpërndarja e burimeve në angazhim", ku përcaktohet qartë se, që një angazhim të jetë efektiv duhet të merren në konsideratë: madhësia dhe kompleksiteti i njesisë si dhe eksperiencia dhe numri i audituesve.

Për vitin 2024 Njësia e Auditimit të Brendshëm ka kryer me urdhër të Titullarit të Bashkisë Durrës 60% të auditimeve, përkatësisht:

- Auditim përputhshmërie i kërkuar me Urdhrin e Kryetares së Bashkisë, me nr. 139, nr. 5430 prot. datë 26.04.2024 me objekt "Zbatimi i Kontratave të Prokurimit Publik të Ndërmarrjes Rrugë, për vitin 2024". (me risk të lartë).

- Auditim përputhshmërie i kërkuar me Urdhrin e Kryetares, me nr.140, nr. 5432 prot. datë 26.04.2024 me objekt: "Zbatimi i Kontratave të Prokurimit Publik në Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës, për vitin 2024". (me risk të lartë).

- Auditim përputhshmërie i kërkuar me Urdhrin e Kryetares, me nr. 138, nr. 5433 prot. datë 26.04.2024, me objekt: "Zbatimi i Kontratave të Prokurimit Publik në Agjencinë e Parqeve Urbane, për vitin 2024". (me risk të lartë)

- Auditim përputhshmërie i kërkuar me Urdhrin e Kryetares së Bashkisë, me nr. 141, nr.5434 prot, datë 26.04.2024 me objekt: "Zbatimi i Kontratave të Prokurimit në Ndërmarrjen Komunale Plazh, për vitin 2024". (me risk të lartë).

- Auditim përputhshmërie i kërkuar me Urdhrin e Kryetares, me nr.142, nr. 5435 prot. datë 26.04.2024 me objekt: "Zbatimi i Kontratave të Prokurimit Publik në Qendrën Ekonomike të Arsimit, për vitin 2024". (me risk të lartë)

- Auditim përputhshmërie i kërkuar me Urdhrin e Kryetares, me nr. 419 prot. datë 29.10.2024 me objekt: "Procedurat e ndjekura për subjektet përfituese në Zonën e Re për Zhvillim, Spitallë, Durrës" në Zyrën e Posaçme të Rindërtimit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike. (me risk të lartë)

Ndërsa ,pjesa tjetër e auditimeve janë: "Zbatim Rekomandime KLSH dhe NJAB" të cilat bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.42 prot.20255 datë 27.10.2020, janë angazhim i detyruar, pavarësisht riskut dhe "Klubi i Futbollit Teuta" i cili bazuar në Kapitullin 3, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, pika 3.1.3 "Faza 3, Strategjia e auditimit (frekuenca e kryerjes se auditimeve)", pavarësisht riskut është planifikuar për të mos kaluar frekuencën 5 vjet

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në hartimin e planit vjetor të auditimit, paraprakisht drejtuesi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm duhet të dokumentojë vlerësimin e riskut. Referuar manualit të auditimit të brendshëm pika 3.1.2 "*Identifikimi dhe vlerësimi i riskut*" vlerësimi i riskut kryhet çdo vit.

Nga sa më sipër Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Durrës nuk ka vendosur në dispozicion të grupit të auditimit metodën e vlerësimit të riskut dhe nivelin sipas çdo Drejtorie apo Ndërmarrje.

Nga sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB

Grupi i auditimit, duke pasur në fokus rëndësinë e subjekteve të audituara, për periudhën 2023-2024, zgjodhi të auditojë dosjet të cilat janë vlerësuar nga DAB me nivel të lartë risku siç janë:

Viti 2023

- dosja e auditimit të kryer në: *Ndërmarrja Rruga*;
- dosja e auditimit të kryer në: *Ndërmarrja komunale Plazh*;
- dosja e auditimit të kryer në: *Drejtoria e Shërbimeve (Sek. i Prokurimeve)*;

Viti 2024

- dosja e auditimit të kryer në: *Qendra Ekonomike e Arsimit*;
- dosja e auditimit të kryer në: *Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale, (auditim i kombinuar)*;
- dosja e auditimit të kryer në: *Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike*;

Konkluzion:

- Në raportet e auditimit, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm, mbi të gjitha sistemet e audituara. Nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat, apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;
- NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format, pa u thelluar analitikisht, për të gjitha subjektet e audituara;
- Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;
- Dosjet e auditimit nuk përmbajnë “Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit”, sipas kërkesave të MAB, të miratuara me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016, të MF “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, pika 2.
- Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2023, ka qenë në përputhje me Urdhrin nr. 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me ligjin Nr. 9154, datë 6.11.2003 dhe nenin 19 pika 1 e Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Durrës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1216/15 prot., datë 22.08.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1347/12 prot., datë 26.08.2025, nga Drejtori i Auditit të Brendshëm, pranë Bashkisë Durrës, O. D. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1.Pretendimi i subjektit:

Referuar dosjeve të audituara nga KLSH për vitin 2024 të cilat i përkasin subjekteve QEA; NSHK Durrës; Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Njësia e Auditimit të Brendshëm, në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH në raportin përfundimtar të auditimit nr.765/22prot. datë 02.05.2024, ka dhënë "opinione" për çdo sistem dhe në përmbledhjen ekzekutive ka dhënë "opinione" e përgjithshme mbi funksionimin e çdo sistemi" në raportet përfundimtare.

Dosjet e angazhimit nuk arkivohen në arkivin e njësisë qendrore, pasi sektori i arkivit në bashki vlerëson se, duke qenë se dokumentet arkivohen një e nga një, pasi kalon përmes protokollit, nuk paraqitet nevoja të riarkivohen.

2.Pretendimi i subjektit:

- Referuar dosjeve të audituara nga KLSH për vitin 2023 të cilat i përkasin subjekteve Ndërmarrja Ruga; NK Plazh dhe Drejtoria e Shërbimeve (Sektori i Prokurimeve).

Në raportet përfundimtare të NJAB është bërë një përshkrim i shkurtër i veprimtarisë së subjektit konkretisht për Ndërmarrjen Ruga në pikën "*Auditim i kontrollit të brendshëm*" dhe për NK Plazh në pikën "*Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve*", ndërsa për vitin 2024 të cilat i përkasin subjekteve: QEA; NSHK Durrës; Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Njësia e Auditimit të Brendshëm në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH, në raportin përfundimtar nr.765/22prot. date 02.05.2024, ka integruar në pikën "*Përmbledhje ekzekutive*" një përshkrim të shkurtër të subjektit.

1.Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar observacionit të mësipërm për arkivimin e dosjes së auditimit. Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në përfundim të programit të auditimit, dosja e auditimit duhet të inventarizohet dhe të arkivohet sipas Ligjit për Arkivat, "*Normat tekniko profesionale për shërbimet arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 2*".

Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë

Për sa i përket opinionit për auditimet e kryera gjatë 2024, opinion nuk është në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar nga Ministria e Financave.

Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë

2.Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar observacionit të mësipërm për raportet përfundimtare të përgatitura nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm janë në përputhje me Manualin e Auditit të Brendshëm.

Sa më sipër observacioni merret në konsideratë.

- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Për të analizuar mjedisin e kontrollit, në manual jepet formati standard 1 "*Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm*" në fund të kapitullit III, i cili duhet të plotësohet një herë në vit dhe të bëhet si pjesë e procesit të planifikimit fillestar. Pyetësori i vlerësimit të Mjedisit të Kontrollit ka për qëllim, që të ndihmojë njësinë e auditimit të brendshëm, të kuptojë se sa mirë menaxhohet njësia dhe se cilat janë fushat/sistemet më me risk.

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm është bërë vlerësimi i kontrollit të brendshëm, si një nga detyrat themelore të auditimit të brendshëm. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm është bërë nga drejtuesi dhe dy audituesit e NJAB, duke qenë se nuk ka një komitet auditimi për të pasur një vlerësim më të saktë dhe profesional.

Konkluzion: NjAB, për periudhën në proces auditimi, 2023-2024 në Bashkinë Durrës, referuar pyetësorit të vlerësimit për mjedisin e kontrollit të brendshëm, rezultoi se nuk ka kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit, i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

- Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm .

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë, vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Durrës ka miratuar me shkresën nr. 3996/1, datë 15.02.2019 të Kryetarit të Bashkisë “Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë së drejtorisë së auditimit të brendshëm” dhe kryen vlerësimet e brendshme të cilësisë. Nga shqyrtimi i këtij programi, (i cili është në fuqi edhe për periudhën në proces auditimi) dhe anekseve përkatëse rezultoi se nuk janë të përcaktuar indikatorët e performancës, evidentohet se anekset mbi monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së njësive, nuk janë hartuar në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Konkluzion: Për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, “Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë së drejtorisë së auditimit të brendshëm”, nuk ka të përcaktuara mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës. Programit sa më sipër i mungon komponenti “Reagimet e subjektit të audituar”, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm Kapitulli VII, pika 7.1.1.

Viti 2024

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Durrës ka miratuar me shkresën nr. 11138/1, datë 30.09.2024 të Kryetarit të Bashkisë “Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë së drejtorisë së auditimit të brendshëm”, i ndryshuar, i dërguar me shkresën me nr. 1304 prot., datë 24.01.2025 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm dhe kryen vlerësimet e brendshme të cilësisë. Nga shqyrtimi i këtij programi dhe anekseve përkatëse rezultoi se janë të përcaktuar indikatorët e performancës dhe evidentohet se anekset mbi monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së njësive, janë hartuar në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm.

- Dosja e përhershme

Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar, me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësive që auditohet.

Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike, ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.

Grupi i auditimit zgjodhi të auditojë 3 dosje të përhershme, **për Vitin 2023**, të cilat janë:

- dosja e përhershme e “Sektori i Prokurimeve”;
- dosja e përhershme e “Ndërmarrja Komunale Plazh”;
- dosja e përhershme e “Njësitë Administrative”.

Kurse për Vitin 2024, grupi i auditimit zgjodhi të auditojë 3 dosje të përhershme, të cilat janë:

- dosje e përhershme e “Ndërmarrja Rruga”;
- dosje e përhershme e “Qendra Ekonomike e Arsimit Durrës”;
- dosje e përhershme e “Zbatim rekomandimesh”;

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Durrës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1216/15 prot., datë 22.08.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1347/12 prot., datë 26.08.2025, nga Drejtori i Auditit të Brendshëm, pranë Bashkisë Durrës, O. D. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

-Për sa i përket përditësimit të Programit për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese si dhe të komponentit “Reagimet e subjektit të audituar” referuar rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i

Shtetit në Raportin e mëparshëm të Auditimit nr. 765/22 prot, datë 02.05.2024, Titullari i Bashkisë Durrës, me shkresën nr. 11138/1 prot., datë 30.09.2024, ka miratuar Programin e përditësuar për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm. Në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli VII, pika 7.1, përmban në mënyrë të plotë dhe të qartë, të gjithë komponentët e kërkuar si më poshtë vijon:

- Mjetet dhe mekanizmat për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, duke mbuluar të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm;
- Komponentin "Regimet e subjektit të audituar", në përputhje të plotë me kërkesat metodologjike të parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Në përfundim, nënvizojmë se ky rekomandim është plotësisht i zbatuar, dhe dokumentacioni përkatës është përditësuar dhe miratuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe bazuar në aktet bashkëlidhur, Bashkia Durrës gjatë vitit 2024 ka hartuar të Programit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me manualin e auditimit të brendshëm.

Sa më sipër observacioni merret në konsideratë.

Për veprimeve dhe mosveprimeve gjatë, periudhës së auditimit, 01.01.2023 – 01.01.2024, ngarkohen me përgjegjësi: M. P, ish-Drejtor i Njesisë së Auditit të Brendshëm, Bashkia Durrës; DH. GJ, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Durrës; O. D, Drejtor në Njësinë e Auditit të Brendshëm, Bashkia Durrës.

Pika 2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023 - 2024:

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e *PBA 2023-2025* dhe *PBA 2024 - 2026*, rezultoi se ka dalë Urdhri i Titullarit nr. 3293 prot, datë 13.04.2023 mbi bazën e të cilit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i përbërë prej **16** punonjësish, dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP).

Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e ndotjeve, garantimin e cilësisë në tregjet publike dhe rritjen e sigurisë në rrugë, përmirësimin e kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe ofrimin e shërbimeve sociale, mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e transportit publik dhe turizmit. Është bërë analiza e pagave dhe është llogaritur pesha specifike e këtyre llojeve të shpenzimeve në totalin e shpenzimeve.

Fushat me prioritet në shpenzimet për investime janë:

- a. *Përmirësimi i infrastrukturës rrugore;*
- b. *Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi ;*
- c. *Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;*
- d. *Përmirësimi i infrastrukturës arsimore*
- e. *Rehabilitimi i hapësirave publike;*

Programet afatmesme **për vitin 2023** janë hartuar bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e PBA-së vendore periudha 2023-2025” dhe **për vitin 2024** bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 06, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e PBA-së vendore periudha 2024-2026”.

Në hartimin e këtyre programeve është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi

i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetit me pjesëmarrje”, sipas datave të paraqitura në **tabelën B.1 dhe B.2**, bashkëlidhur PRA.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësive administrative/ drejtoritë e shkollave/ sektorët e bashkisë/ ujësjellësi, etj., gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritet.

- PBA-të periudha 2023-2025 dhe buxheti i vitit 2023, si dhe PBA-të periudha 2024-2026 dhe buxheti i vitit 2024.

- **Për vitin 2023**, me Vendim të KB nr. 81, datë 26.07.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 631/2 prot, datë 10.08.2022 është miratuar dokumenti i pare i Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, në të cilën janë miratuar dhe tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA (20 programeve buxhetore), të njësive shpenzuese dhe klasifikimit ekonomik, sipas tabelës **B.3**, si më poshtë:

Tabela B.3. Shpenzimet sipas programeve buxhetore.

Nr.	Nr. Prog	Emërtimi Programit	Viti 2023	
			000/lekë	%
1	P.1 (01110)	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	512,203	13.4
2	P.2 (03140)	Shërbimet e Policisë Vendore	71,965	1.9
3	P.3 (03280)	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	63,951	1.7
4	P.4 (04130)	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	3,500	0.1
5	P.5 (04220)	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	-	-
6	P.6 (04240)	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	51,112	1.3
7	P.7 (04260)	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	3,341	0.1
8	P.8 (04520)	Rrjeti rrugor	467,784	12.2
9	P.9 (04570)	Transporti Publik	-	-
10	P.10 (05100)	Menaxhimi Mbetjeve	956,627	25.0
11	P.11 (06140)	Planifikimi Urban Vendor	14,587	0.4
12	P.12 (06260)	Shërbimet Publike Vendore	280,973	7.4
13	P.13 (06370)	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	-	-
14	P.14 (07220)	Shërbimet e Kujdesit Parësor	-	-
15	P.15 (08130)	Sport dhe Argëtim	92,283	2.4
16	P.16 (08220)	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	77,405	2.0
17	P.17 (09120)	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	813,175	21.3
18	P.18 (09230)	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	198,290	5.2
19	P.19 (10430)	Përkujdesja Sociale	124,860	3.3
20	P.20 (10661)	Strehimi Social	50,562	1.3
		Fondi rezerve dhe kontigjences	40,000	1.0
		TOTAL	3,822,618	100

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Ndërsa ndarja e shpenzimeve sipas natyrës, paraqitet në tabelën **B.4**, si më poshtë:

Tabela B.4. Ndarja e shpenzimeve buxhetore.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga 600	1,272,960	32.27	1,282,426	32.51	1,291,984	32.46
2	Sig. 601	210,861	5.34	212,449	5.38	214,052	5.38
3	Shpenzime operative 602	1,169,256	29.64	1,164,048	29.51	1,164,088	29.25
4	Shpenzime604	20,000	0.51	50,000	1.27	55,000	1.38

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
5	Shpenzime606	210,510	5.34	79,010	2.00	79,010	1.99
6	Fondi rezervë/ kontigjencës 609	40,000	1.01	60,000	1.52	75,000	1.88
7	Investime 230-231	1,021,619	25.90	1,097,272	27.81	1,100,614	27.66
	Total	3,945,206	100	3,945,205	100	3,979,748	100

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se për vitin 2023, shpenzime për paga (600) janë planifikuar 32% e totalit të shpenzimeve, e ndjekur nga shpenzimet operative (602) në masën 29.6% dhe shpenzimet për investime në masën 25%.

- **Për vitin 2024**, me Vendim të KB nr. 131, datë 27.07.2023, konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Durrës me shkresën nr. 6720/4 *prot*, datë 31.07.2023 është miratuar dokumenti i pare i Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, në të cilën janë miratuar dhe tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA (20 programeve buxhetore), të njësive shpenzuese dhe klasifikimit ekonomik, paraqitet në tabelën B.5, si më poshtë:

Tabela B.5. Shpenzimet sipas programeve buxhetore.

Nr.	Nr. Prog	Emërtimi Programit	Viti 2024	
			000/lekë	%
1	P.1 (01110)	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	422,988	10.21
2	P.2 (03140)	Shërbimet e Policisë Vendore	80,100	1.93
3	P.3 (03280)	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	89,613	2.16
4	P.4 (04130)	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	14,400	0.35
5	P.5 (04220)	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	40,000	0.97
6	P.6 (04240)	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	58,631	1.42
7	P.7 (04260)	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	3,653	0.09
8	P.8 (04520)	Rrjeti rrugor	318,028	7.68
9	P.9 (04570)	Transporti Publik	0	0.00
10	P.10 (05100)	Menaxhimi Mbetjeve	960,263	23.19
11	P.11 (06140)	Planifikimi Urban Vendor	67,577	1.63
12	P.12 (06260)	Shërbimet Publike Vendore	448,053	10.82
13	P.13 (06370)	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	0	0.00
14	P.14 (07220)	Shërbimet e Kujdesit Parësor	25,000	0.60
15	P.15 (08130)	Sport dhe Argëtim	129,396	3.12
16	P.16 (08220)	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	75,225	1.82
17	P.17 (09120)	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	957,165	23.11
18	P.18 (09230)	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	146,543	3.54
19	P.19 (10430)	Përkujdesja Sociale	161,028	3.89
20	P.20 (10661)	Strehimi Social	93,677	2.26
		Fondi rezervë dhe kontigjencës	50,000	1.21
		TOTAL	4,141,340	100

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Ndërsa ndarja e shpenzimeve sipas natyrës, paraqitet në Tabelën B.6, si më poshtë:

Tabela B.6. Ndarja e shpenzimeve buxhetore.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga 600	1,454,475	32.22	1,454,475	32.04	1,454,475	31.56
2	Sig. 601	239,031	5.30	239,031	5.27	239,031	5.19

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
3	Shpenzime operative 602	1,247,736	27.64	1,234,877	27.20	1,235,315	26.80
4	Shpenzime604	20,000	0.44	20,000	0.44	20,000	0.43
5	Shpenzime606	93,500	2.07	93,500	2.06	95,500	2.07
6	Fondi rezervë/ kontigjencës 609	50,000	1.11	50,000	1.10	72,000	1.56
7	Investime 230-231	1,409,361	31.22	1,447,340	31.89	1,492,822	32.39
	Total	4,514,103	100	4,539,223	100	4,609,143	100

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se për vitin 2024, shpenzime për paga (600) janë planifikuar 32.2% e totalit të shpenzimeve, e ndjekur nga shpenzimet për investime në masën 31.2 % dhe shpenzimet operative (602) në masën 27.6%.

Treguesit e mësipërm për periudhën 2023-2024, tregojnë se nga bashkia fondet janë përqendruar më shumë në paga e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të të punësuarave pa bërë asnjë analizë sektoriale mundësi/nevojë, sesa në investime për përmisimin e nevojave të komunitetit në infrastrukturës rrugore, arsimore, etj..

- Tendenca e të ardhurave sipas PBA 2023-2025, paraqitet në tabelën **B.6**, si më poshtë:

Tabela B.6. Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2023-2025.

A	Të ardhurat	2023	2024	2025
1	Nga taksat	1,255,050	1,255,050	1,255,050
2	Jo tatimore	863,940	863,940	863,940
I	Totali	2,118,990	2,118,990	2,118,990
1	Transferta e pakushtëzuar	1,053,486	1,053,486	1,088,029
2	Transfertë specifike	672,729	672,729	672,729
II	Shuma e transfertave	1,726,215	1,726,215	1,760,758
III	Transferta të pritshme (FZHR e tjera)	0	0	0
IV	Te trashëguara nga viti i mëparshëm	100,000	100,000	100,000
	Totali i burimeve të veta (I +II+III+IV)	3,945,205	3,945,205	3,979,748

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nr.	Emërtimi	PBA fillestare viti 2023- 2025 (faza, I tavanet përgatitore 01.06.2023)	Sipas PBA 2023- 2025 (faza III Tavanet përfundimtare) 31.12.2023	Ndryshimi ne %
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga të ardhura, grant i pakush. e spec.)	1,410,264	1,483,820	5.2%
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtëz e specifik)	1,321,934	1,439,766	8.9%
3	Investime Bashkia (nga të ardhura dhe grant i pakushtëzuar)	1,090,420	1,021,619	-6.3%
Total i planit fillestar		3,822,618	3,945,205	3.2

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

- Tendenca e të ardhurave sipas PBA 2024-2026 paraqitet në Tabelën **B.7**, si më poshtë:

Tabela B.7. Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2024-2026.

A	Të ardhurat	2024	2025	2026
1	Nga taksat	1,448,050	1,456,050	1,506,450
2	Jo tatimore	896,400	913,520	933,040
I	Totali	2,344,450	2,369,570	2,439,490
1	Transferta e pakushtëzuar	1,211,509	1,211,509	1,211,509
2	Transfertë specifike	758,144	758,144	758,144

A	Të ardhurat	2024	2025	2026
II	Shuma e transfertave	1,969,653	1,969,653	1,969,653
III	Transferta të pritshme (FZHR e tjera)	-	-	-
IV	Te trashëguara nga viti i mëparshëm	200,000	200,000	200,000
	Totali i burimeve të veta (I +II+III+IV)	4,514,103	4,539,223	4,609,143

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nr.	Emërtimi	PBA fillestare viti 2024- 2026 (faza, I tavanet përgatitore 01.06.2023)	Sipas PBA 2024- 2026 (faza III Tavanet përfundimtare) 31.12.2023	Ndryshim i në %
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga të ardhura, grant i pakush. e spec.)	1,618,655	1,693,506	4.62
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtëz e specifik)	1,408,815	1,411,236	0.17
3	Investime Bashkia (nga të ardhura dhe grant i pakushtëzuar)	1,113,870	1,409,361	26.52
	Total i planit fillestar	4,141,341	4,514,103	9

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

a. Për periudhën raportuese 2023 - 2024, Titullari Bashkisë Durrës në përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore, ka përcaktuar strukturën buxhetore për programin buxhetor afatmesëm të këtij institucioni, e cila paraqitet në (20) programe buxhetore.

Gjatë hartimit të PBA janë përcaktuar “Përshkrimi i çdo programi”; “Politika e programit”; “Qëllimi Politikës së programit”; “Objektivat e politikës së programit”.

b. Buxheti i vitit 2023 është miratuar me Vendim të KB nr. 149, datë 22.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 954/3 prot, datë 29.12.2022, i paraqitur në **tabelën B.8**, si vijon:

Tabela B.8: Planifikimet sipas PBA-ve dhe ndryshimet në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	2,118,990	
2	Të ardhura të trashëguara nga viti 2022	100,000	
3	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	1,053,486	
4	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	672,730	
5	Paga (600)		1,272,960
6	Sigurime shoqërore (601)		210,861
7	Shpenzime operative (602)		1,169,256
7	Transferta (604 – 606)		20,000
8	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		1,021,619
9	Fondi Rezervë dhe kontigjences (609)		40,000
	Totali i buxhetit	3,945,206	3,945,206

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar të dhënave të tabelës B.8, konstatohet se me të ardhurat e veta bashkia ka planifikuar të mbulojë 53.6% të shpenzimeve, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga buxheti i shtetit.

c. Buxheti i vitit 2024 është miratuar me Vendim të KB nr.195, datë 22.12.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr.99/1 prot, datë 05.01.2024 , i paraqitur në **Tabelën B.9**, si vijon:

Tabela B.9: Planifikimet sipas PBA-ve dhe ndryshimet.
në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2024	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	2,344,450	
2	Të ardhura të trashëguara nga viti 2023	200,000	
3	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	1,211,509	
4	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	758,144	
5	Paga (600)		1,454,475
6	Sigurime shoqërore (601)		239,031
7	Shpenzime operative (602)		1,247,736
7	Transferta (604 – 606)		113,500
8	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushtëz+tr.Specifike		1,409,361
9	Fondi Rezervë dhe kontigjencës (609)		50,000
Totali i buxhetit		4,514,103	4,514,103

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Sipas të dhënave të tabelës, konstatohet se me të ardhurat e veta bashkia ka planifikuar të mbulojë 51.9% të shpenzimeve, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga buxheti i shtetit.

Për të dyja vitet objekti auditimi, detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë me vendimet përkatëse.

Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me Degën e Thesarit Durrës, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet. Po kështu rezultoi se janë bërë argumentimet e transferimeve të ndryshme të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

- Sipas planit buxhetor 2023, PBA 2023-2025 paraqitet në tabelën **B.10**, si më poshtë:

Tabela B.10. Krahassimi i planeve (buxhetor 2023/PBA)

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar 2023	Sipas PBA 2023-2025	#
1	Paga (600)	1,272,960	1,272,960	-
2	Sigurime shoqërore (601)	210,861	210,861	-
3	Shpenzime operative (602)	1,169,256	1,169,256	-
4	Transferta (604 – 606)	230,050	230,050	-
5	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike	1,021,619	1,021,619	-
6	Fondi Rezervë dhe kontigjences (609)	40,000	40,000	-
	Gjithsej	3,945,206	3,945,206	

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

- Sipas planit buxhetor 2024, PBA 2024-2026, paraqitet në Tabelën **B.11**, si më poshtë:

Tabela B.11. Krahassimi i planeve (buxhetor 2024/PBA)

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar 2024	Sipas PBA 2024-2026	#
1	Paga (600)	1,454,475	1,454,475	-
2	Sigurime shoqërore (601)	239,031	239,031	-

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar 2024	Sipas PBA 2024-2026	#
3	Shpenzime operative (602)	1,247,736	1,247,736	-
4	Transferta (604 – 606)	113,500	113,500	-
5	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushtëz+tr.Specifike	1,409,361	1,409,361	-
6	Fondi Rezervë dhe kontigjencës (609)	50,000	50,000	-
	Gjithsej	4,514,103	4,514,103	

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se për të dy periudhat objekt auditimi (2023 – 2024), nuk ka ndryshime midis PBA dhe planit buxhetor.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura:

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Për vitin 2023, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit (buxhet shtesë) gjithsej është në vlerën **1,526,845 lekë**, e analizuar, si më poshtë:

1. Transfertë e kushtëzuar për investime, në vlerën 20,324 mijë lekë;
2. Transfertë e kushtëzuar për Ndihmën ekonomike dhe PAK, në vlerën 1,175,523 mijë lekë;
3. Transfertë e kushtëzuar për Gjendje Civile QKB në vlerën 26,046 mijë lekë;
4. Transfertë e kushtëzuar për emergjencat civile , në vlerën 38,975 mijë lekë;
5. Transfertë e kushtëzuar për shërbimet ne zgjedhjet vendore, në vlerën 13,583 mijë lekë ;
6. Transfertë e kushtëzuar për subvencionin e qerasë për familjet e dëmtuara nga tërmeti, në vlerën 166,500 mijë lekë;
7. Transfertë e kushtëzuar për subvencionimin e qerasë për familjet në nevojë 15,151 mijë lekë;
8. Transferte e kushtëzuar për subvencionimin e interesave për familjet qe kane kontrata me Entin e Banesave 3,028 mijë lekë;
8. Transfertë e kushtëzuar për shpërblimin e zjarrfikësve, në vlerën 2,890 mijë lekë;
9. Transferta e kushtëzuar për Qendrën Ekonomike të Arsimit për bursat e nxënësve ne arsimin baze dhe te mesëm, në vlerën 60,889 mijë lekë;
10. Transfertë e kushtëzuar për Qendrën e shërbimeve mbrojtëse për fëmijë dhe familjen(Fondi social), në vlerën 3,537 mijë lekë;
11. Transfertë e kushtëzuar për Qendrën Kulturore A. Moisiu për pjesëmarrjen në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës, në vlerën 400 mijë lekë.

Gjithashtu me Vendim të KB nr. 86, datë 30.03.2023 është miratuar dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara nga viti paraardhës, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 220/3 prot, datë 31.03.2023, konkretisht këto fonde të trashëguar paraqiten në tabelën **B.12** e mëposhtme:

Tabela B.12. Të dhëna mbi fondet e trashëguara nga viti 2022.

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura te papërdorura ne 2022	409,320	
2	Transferta e Pakushtëzuar e papërdorur në 2022	84,486	
3	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale e papërdorur në 2022	71,071	
4	Paga (600)		79,299
5	Sigurime shoqërore (601)		9,474
6	Shpenzime operative (602)		21,091
7	Transferta (604 – 606)		20,000
8	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		435,013
9	Fondi Rezervë dhe kontigjences (609)		-
Totali i buxhetit		564,877	564,877

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela e ndryshimeve të buxheteve gjatë vitit 2023

000/Lekë

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr. datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli			
					Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma
			Nr.163 dt.03.11.2023	0	231	23,552	231	30,948
					602	7,396		
					Total 1	30,948		30,948
	Nr.149 dt. 22.12.202	3,945,206	Nr.139 dt.28.09.2023	41,975	600	34,984		
	2				601	6,991		
					Total 2	41,975		-
			Nr. .186 dt.22.12.2023	127,690	602	127,690		
					Total 3	127,690		-
			Totali #	169,665	Total 1+2+3	200,613		30,948

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga sa më sipër konstatohet se kanë ndodhur 4 ndryshime buxhetore, të cilat janë miratuar me VKB përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve.

Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Durrës. Këto ndryshime janë rialokime shpenzimesh, ndërmjet programeve, si dhe për efekt të fondeve ta alokuara nga buxheti i shtetit për efekt të rritjes së pagave dhe mbështetje financiare për zbutjen e impaktit të krizës.

000/lekë

Njësia	Bashkia Durrës + Ndërmarrjet e vartësisë Viti 2023 (përfshirë fondet e rindërtimit dhe transfertat e kushtëzuara)								
Art.	Emërtimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	PBA Plan Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023 (VKB , datë)	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan i periudhës progresiv Viti 2023	Fakti i 12-mujorit	Diferencia	% e reali
600	Paga	1,127,005	1,272,960	1,272,960	1,387,243	1,388,994	1,291,855	97,139	93
601	Sigurime Shoqërore	185,931	210,860	210,860	227,325	228,351	212,084	16,267	93
600+601	Paga +Sigurime	1,312,936	1,483,820	1,483,820	1,614,568	1,617,345	1,503,939	113,406	93
602	Mallra dhe Shërbime	1,319,781	1,169,256	1,169,256	1,325,433	1,328,719	1,162,324	166,395	87

Njësia	Bashkia Durrës + Ndërmarrjet e vartësisë Viti 2023 _ (përfshirë fondet e rindërtimit dhe transfertat e kushtëzuara)								
Art.	Emërtimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Plan Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023 (VKB , datë)	(4) Buxheti Vjetor Plan Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i periudhës progresiv Viti 2023	(6) Fakti i 12-mujorit	(7)=(6)-(5) Diferenca	% e reali
603	Subvencione	0	0	0	0	-	-	0	
604	Transferta Korente të Brendshme	134,517	20,000	20,000	40,000	100,827	84,384	16,443	84
605	Transferta Korente të Huaja		0	0	0	-	-	0	
606	Transf. për Buxh. Fam. & Individ	2,575,899	210,510	210,510	210,510	1,525,731	1,469,106	56,625	96
602-606	Shpenzime operative	4,030,197	1,399,766	1,399,766	1,575,943	2,955,277	2,715,814	239,463	92
	Shpenzime Korrente	5,343,133	2,883,586	2,883,586	3,190,511	4,572,622	4,219,753	352,869	92
230	Kapitale të Patrupëzuara	41,845	47,000	47,000	72,095	32,598	24,756	7,842	76
231	Kapitale të Trupëzuara	3,585,233	974,619	974,619	1,377,141	5,467,708	3,443,982	2,023,726	63
Totali	Shpenzime Kapitale	3,627,078	1,021,619	1,021,619	1,449,236	5,500,306	3,468,738	2,031,568	63
	Fondi rezerve dhe kontigjences		40,000	40,000	40,000				
Totali (korrente + kapitale)		8,970,211	3,945,205	3,945,205	4,679,747	10,072,928	7,688,491	2,384,437	76

..Për buxhetin e vitit 2024, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit (buxhet shtesë), gjithsej në vlerën **1,471,165 mijë lekë**, e analizuar, si më poshtë:

1. Transfertë e kushtëzuar për investime, në vlerën 64,514 mijë lekë;
2. Transfertë e kushtëzuar për Ndihmën ekonomike dhe PAK, në vlerën 1,268,024 mijë lekë;
3. Transfertë e kushtëzuar për Gjendje Civile në vlerën 27,768 mijë lekë;
4. Transfertë e kushtëzuar për emergjencat civile (fondi i kushtëzuar i mbrojtjes civile), në vlerën 21,955 mijë lekë
5. Transfertë e kushtëzuar për subvencionimin e qerasë për familjet në nevojë 34,624 mijë lekë;
6. Transferte e kushtëzuar për subvencionimin e interesave për familjet qe kane kontrata me Entin e Banesave 2,671 mijë lekë;
7. Transferta e kushtëzuar për bursat e nxënësve ne arsimin baze dhe te mesëm, në vlerën 48,072 mijë lekë;
8. Transfertë e kushtëzuar për Qendrën e shërbimeve mbrojtëse për fëmijë dhe familjen(Fondi social), në vlerën 3,537 mijë lekë;

Me Vendim të KB nr. 38, datë 21.05.2024 është miratuar edhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara nga viti paraardhës, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr.5972/3 prot, datë 29.05.2024, konkretisht këto fonde të trashëguar paraqiten në Tabelën **B.13** si më poshtë:

Tabela B.13. Të dhëna mbi fondet e trashëguara nga viti 2023.

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2024	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura te papërdorura ne 2023	424,115	
2	Transferta e Pakushtëzuar e papërdorur në 2023	192,617	
3	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale e papërdorur në 2023	48,450	
4	Paga (600)		38,381

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2024	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
5	Sigurime shoqërore (601)		5,180
6	Shpenzime operative (602)		99,255
7	Transferta (604 – 606)		26,450
8	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushtëz+tr.Specifike		455,916
9	Fondi Rezervë dhe kontigjencës (609)		40,000
Totali i buxhetit		665,182	665,182

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela e ndryshimeve të buxheteve gjatë vitit 2024

000/Lekë

Periodha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr. datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli			
					Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma
			Nr.89		600	24,616		
			dt.24.09.2024	29,927	601	5,311		
					Total 1	29,927	-	-
			Nr.92		600	23,709		
			dt.28.10.2024	29,262	601	5,553		
					Total 2	29,262		-
					602	2,000	609	16,552
			Nr. dt.28.10.2024	970	230	2,627		
					231	26,299	231	14,374
					Total 3	30,926		30,926
			Nr. dt.24.09.2024	980	604	6,064	609	6,064
					Total 4	6,064		6,064
			Nr. dt.24.12.2024	119	602	93,287		-
					Total 5	93,287		-
			Total #	152,476	Total 1+2+3+4+5	189,466		36,990

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga sa më sipër konstatohet se kanë ndodhur 5 ndryshime buxhetore, të cilat janë miratuar me VKB përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Durrës. Këto ndryshime sikurse shihet nga tabela janë rialokime shpenzimesh, ndërmjet programeve, si dhe për efekt të fondeve ta alokuara nga buxheti i shtetit për efekt të rritjes së pagave dhe mbështetje financiare për zbutjen e impaktit të krizës.

000/Lekë

Njësia	Bashkia Durrës + Ndërmarrjet e vartësisë Viti 2024 _ (përfshirë fondet e rindërtimit dhe transfertat e kushtëzuara)								
Art.	Emërtimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2023	(2) PBA Plan Viti 2024	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024 (VKB 195, datë 22.12.2023)	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	(5) Buxheti Vjetor Plan i periudhës progresiv Viti 2024	(6) Fakti i 12-mujorit	(7)=(6)-(5) Diferenca	% e realizimit
600	Paga	1,291,855	1,454,475	1,454,475	1,535,462	1,559,352	1,429,182	130,170	92
601	Sigurime Shoqërore	212,084	239,031	239,031	255,074	258,877	238,677	20,201	92
600+601	Paga +Sigurime	1,503,939	1,693,506	1,693,506	1,790,537	1,818,230	1,667,859	368,847	92
602	Mallra dhe shërbime	1,162,324	1,247,736	1,247,736	1,442,278	1,452,344	1,300,592	151,752	90
603	Subvencione	-	-	-	0	-	-	-	-
604	Transferta Korente të Brendshme	84,384	20,000	20,000	46,064	74,029	61,161	12,868	83
605	Transferta Korente të Huaja	-	-	-	0	-	-	-	-
606	Transf. për Buxh. Fam. & Indiv	1,469,106	93,500	93,500	105,669	1,677,936	1,673,102	4,834	100

Njësia	Bashkia Durrës + Ndërmarrjet e vartësisë Viti 2024 _ (përfshirë fondet e rindërtimit dhe transfertat e kushtëzuara)								
Art.	Emërtimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2023	(2) PBA Plan Viti 2024	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024 (VKB 195, datë 22.12.2023)	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	(5) Buxheti Vjetor Plan i periudhës progresiv Viti 2024	(6) Fakti i 12-mujorit	(7)=(6)-(5) Diferenca	% e realizimit
609	Rezervat dhe kontigjenca	-	50,000	50,000	67,384	20,000	-	20,000	-
602-609	Shpenzime operative korente	2,715,814	1,411,236	1,411,236	1,661,395	3,204,309	3,034,855	189,454	94
	Shpenzime Korrente	4,219,753	3,104,742	3,104,742	3,451,932	5,022,539	4,702,714	339,825	93
230	Kapitale të Patrupëzuara	24,756	15,000	15,000	29,627	23,130	9,616	13,514	42
231	Kapitale të Trupëzuara	3,443,982	1,394,361	1,394,361	1,850,203	3,558,793	2,158,109	1,400,684	61
Totali	Shpenzime Kapitale	3,468,738	1,409,361	1,409,361	1,879,829	3,581,923	2,167,725	1,414,198	61
	Totali (korrente + kapitale)	7,688,491	4,514,103	4,514,103	5,331,761	8,624,461	6,870,439	1,754,023	80

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Për të dyja periudhat ushtrimore (2023-2024, planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Durrës dhe janë raportuar periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE.

Situacionet e shpenzimeve janë plotësuar sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Plani-buxhetor, është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduar me Degën e Thesarit Durrës dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave dhe tarifave të Bashkisë dhe të granteve. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Durrës janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Durrës, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve, respektivisht **për vitin 2023** me Vendim të KB nr. 149, datë 22.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Durrës, viti 2023” dhe **për vitin 2024** me Vendim të KB nr. 194, datë 22.12.2023 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2024”.

Kryetari i Bashkisë ka raportuar normalisht në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare, referuar nenit 64, të Ligjit nr. 30/2015, datë 02.04.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” (të

ndryshuar), Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (me ndryshime), Udhëzimit të MF nr. 1, datë 9.1.1996 “Për procedurat e punës në sistemin e thesarit dhe institucioneve buxhetore”, si dhe UMF nr. 2, datë 27.1.1999 “Për urdhër shpenzimet dhe titullin e të ardhurave”.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Durrës, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Durrës, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktuar nga transfertat e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

Realizimi i treguesve të buxhetit **për vitin 2023**, referuar akt-rakordimeve me thesarin (*pa njësitë e varësisë*) është paraqitur në shkresën nr. 568 *prot*, datë 23.4.2024, ndërsa planifikimi i të ardhurave, referuar akt-rakordimeve me thesarin, është paraqitur në shkresën nr. 1383 *prot*, datë 26.01.2024.

Ndërsa realizimi i treguesve të buxhetit **për vitin 2024**, referuar akt-rakordimeve me thesarin (*pa njësitë e varësisë*) është paraqitur në shkresën nr. 1796 *prot*, datë 03.02.2025. Ndërsa realizimi i të ardhurave për vitin 2024, referuar akt-rakordimeve me thesarin, është paraqitur në shkresën nr. 1676/3 *prot*, datë 04.02.2025.

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelat e mësipërme, rezultoi se niveli i realizimit të treguesve të buxhetit **për vitin 2023**, varijon në masën 77% (*për zërin investime*) deri 96% (*ndihma ekonomike*), ndërsa për **vitin 2024** varijon në masën 60% (*për zërin investime*) deri 99.8% (*ndihma ekonomike*), gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Durrës dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

- Për buxhetin e vitit 2023.

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit, e zënë investimet në masën 23.7% e ndjekur nga shpenzimet operative dhe pagat në masën 15% (kjo për bashkinë Durrës pa njësitë vartëse).

Shpenzimet për Bashkinë Durrës pa njësitë vartëse janë parashikuar në vlerën 3,566,699 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 3,093,393 mijë lekë ose në masën 87%, ku përqindjen me të ulët e ka zëri investime në masën 77%, e cila nuk ka lidhje me mungesën e fondeve nga bashkia, por nga mos zbatimi i kontratave të afat, lidhja e kontratave të fund të periudhës ushtrimore (muaj dhjetor), si rezultat i zgjatjes së procedurave të investimeve, si dhe kryerjen e procedurave të prokurimit pa zgjidhur paraprakisht problemin e shpronësimeve.

Gjithashtu konstatohet se fondet e rindërtimit janë realizuar në masën 60%, ku nga vlera e parashikuar prej 4,505,939 mijë lekë është realizuar vlera 5,785,592 mijë lekë, kjo vjen si rezultat i mos mbylljes së kontratave të afatit të caktuara dhe mungesës së fondeve.

Fondet nga njësitë e varësisë janë realizuar në masën 95%, ku nga vlera e parashikuar prej 2,000,291 mijë lekë është realizuar vlera 1,902,899 mijë lekë.

Në total **për vitin 2023**, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit të Bashkisë Durrës me të gjithë elementët (*bashkia+njësitë vartëse+rindërtimi*), është realizuar në masën 76%, ku nga vlera e parashikuar prej 10,072,929 mijë lekë është realizuar vlera 7,688,491 mijë lekë, me një mos realizim në vlerë 2,384,438 mijë lekë, sipas **tabela B.14**, si vijon:

Tabela B.14: Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar akt-rakordimeve me thesarin (me njësitë e varësisë+ rindërtimi).

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2023		
		Plan	fakt	Realizimi ne %
I.	BASHKIA			
1	Paga (art.600)	452,584	410,616	91
2	Sigurime shoq. (art.601)	72,147	64,880	90
3	Shp. operative (art.602)	629,157	486,663	77
4	Transferime (art.604+606)	63,555	55,642	88
5	Fond I kushtëzuar emergj.civile (Min.17 art. 604)	38,975	28,504	73
6	Nd.ekonomike+PAK (Min.13 art.606)	1,175,523	1,132,027	96
7	Bonus qeraje familjet ne nevoje (Min.10 art.606)	15,151	15,152	100
8	Subvencion nga enti banesave (Min.10 art.606)	3,028	3,028	100
9	Bonus qeraje termeti (Min.10 art.606)	166,500	163,150	98
10	Investime 230+231	950,079	733,731	77
	Totali I.1	3,566,699	3,093,393	87
	Rindërtimi			
11	602 (transporti shembjeve) (grupi 00)	2,348	0	0
12	604-606 (grante rindërtimi DS1,DS2,DS3,DS4,DS5)(grupi 00)	79,178	72,835	92
13	230+231 (investime rindërtimi) (grupi 00)	4,424,413	2,619,364	59
	Totali I.2 (fondet rindërtimit)	4,505,939	2,692,199	60
	TOTALI I.1+I.2 (BASHKIA)	8,072,638	5,785,592	72
II.	Institucionet dhe Ndërmarrjet e Varësisë			
14	Paga (art.600)	936,411	881,239	94
15	Sigurime shoq. (art.601)	156,204	147,203	94
16	Shp. operative (art.602)	654,218	632,664	97
17	Shp. operative (Min. linj 11 art.602)	42,996	42,996	100
18	Transferime (art.604+606)	62,819	61,364	98
19	Transferime (Min. Linjës 10 art.604+606)	21,829	21,789	100
20	Investime 230+231	125,814	115,644	92
	TOTALI II (institucionet dhe ndërmarrjet e varësisë)	2,000,291	1,902,899	95
	TOTALI I+II	10,072,929	7,688,491	76

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela B.15. Realizimi i fondeve sipas njësive të varësisë dhe zërave të shpenzimeve.

Në 000/lekë

Emërtimi i Njësise Shpenzuese	Paga (600)		Sig.shoqerore (601)		ShP. Operative (602)		Transferime tek individ (604+606)		Investime (230+231)		Totali (000/lekë)	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Ndërmarrja Rruga	152,435	149,537	25,294	24,983	131,425	130,207	866	836	121,489	111,190	431,509	416,754
Qendra Ekono Arsimi	370,544	342,088	60,734	57,137	202,687	189,268	19,294	19,287	860	785	654,119	608,564
Ndërm.Shërb Komun	208,469	195,678	35,820	32,700	203,300	199,095	972	972	386	386	448,947	428,831
Ndërm.Komun Plazh	98,454	95,728	16,919	15,975	91,194	90,931	746	746	874	874	208,187	204,254
Klubi Futbollit Teuta	5,330	5,250	876	872	25,000	24,999	-	-	-	-	31,206	31,122
Qend Ditor Moshuar	30,150	26,292	4,926	4,534	9,960	8,672	3,537	3,503	99	411	48,672	43,412
Klub Shumsport Teut	15,551	14,518	2,555	2,425	9,700	9,555	59,060	57,635	119	119	86,985	84,251
Qend.Kulturor Fëmijë	10,308	9,129	1,631	1,524	3,500	3,476	-	-	-	-	15,439	14,130
Qend.Kultur A.Moisiu	31,611	30,153	5,224	4,904	14,548	14,488	173	173	1,988	1,880	53,544	51,598
Biblioteka	13,560	12,864	2,225	2,149	5,900	4,970	-	-	-	-	21,685	19,983
Totali	936,411	881,239	156,204	147,203	697,214	675,660	84,648	83,153	125,814	115,644	2,000,292	1,902,900

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Realizimi i buxhetit për vitin 2023, sipas burimit të financimit për Bashkinë Durrës (pa ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë) paraqitet në **tabelën B.16**, si vijon:

Tabela B.16: Buxheti sipas burimeve të financimit, (pa njësitë e varësisë).

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2023 (000/lekë)		
		plan	fakt	realizimi ne %
1.	Paga 600	452,584	410,616	91
	nga te ardhurat	-	-	-
	nga transfertat pakushtezuar+sektorale	416,093	379,015	91
	nga ministrinë e linjës	36,490	31,601	87
2.	Sigurime shoqërore 601	72,147	64,880	90
	nga te ardhurat	-	-	-
	nga transfertat pakushtezuar+sektorale	68,669	62,166	91
	nga ministrinë e linjës	3,478	2,714	78
3.	Shpenz.operative 602	631,505	486,663	77
	nga te ardhurat	90,967	52,495	58
	nga transfertat pakushtezuar+sektorale	535,699	432,847	81
	nga ministrinë e linjës	2,491	1,322	53
	nga rindërtimi (grupi 00)	2,348	-	0
4.	Transfer 604 (kuota Qarkut, fondi kushtezuar emergjenca civil)	100,826	84,384	84
	nga te ardhurat	40,030	40,030	100
	nga transfertat pakushtezuar+sektorale	-	-	-
	nga ministrinë e linjës	38,975	28,504	73
	nga rindërtimi (grupi 00)	21,821	15,850	73
5.	Transferime 606 (bonus strehimi, ndihma financiare)	1,441,085	1,385,983	96
	nga te ardhurat	21,640	14,146	65
	nga transfertat pakushtezuar+sektorale	1,826	1,437	79
	nga ministrinë e linjës	1,193,762	1,150,265	96
	nga ministrinë e linjës (bonusi qerese se termetit)	166,500	163,150	98
	nga rindërtimi	57,357	56,985	99
6.	Investime 230-231	5,374,492	3,353,095	62
	nga te ardhurat	881,538	718,416	81
	nga transfertat pakushtezuar+sektorale	48,217	8,509	18
	nga ministrinë e linjës	20,324	6,805	33
	nga rindërtimi (grupi 00)	4,424,413	2,619,364	59
7.	TOTALI	8,072,638	5,785,591	72
	nga te ardhurat	1,034,174	825,057	80
	nga transfertat pakushtezuar+sektorale	1,070,505	883,973	83
	nga ministrinë e linjës	1,462,021	1,384,361	95
	nga rindërtimi	4,505,939	2,692,199	60

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat e mësipërme, rezultoi se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitin 2023 të ketë mosrealizime.

Në totalin e fondeve të parashikuara për shpenzime, peshën kryesore e zënë fondet nga rindërtimi në masën 55.8% e ndjekur nga ministrinë e linjës në masën 18%. Ndërsa me të ardhurat e veta mbulon 12.8% të totalit. Gjithashtu, pjesën më të madhe të të ardhurave, bashkia e përdor për investime në masën 12.4% e ndjekur nga shpenzimet operative me 0.9%.

- **Për buxhetin e vitit 2024**

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit, e zënë investimet nga Fondi i Rindërtimit dhe janë në masën 27.5% e ndjekur nga shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe invaliditet në masën

27%, investimet nga të ardhurat e veta të bashkisë në masën 14%, shpenzimet operative me 12.8% , shpenzimet e personelit me 10.8% dhe kjo për bashkinë Durrës pa njësitë vartëse.

Shpenzimet për Bashkinë Durrës pa njësitë vartëse janë parashikuar në vlerën 3,980,251 mijë dhe janë realizuar në vlerën 3,301,299 mijë lekë ose në masën 83%, ku përqindjen me të ulët e ka zëri investime në masën 59%, e cila nuk ka lidhje me mungesën e fondeve nga bashkia, por nga mos zbatimi i kontratave të afat, lidhja e kontratave të fund të periudhës ushtrimore (muaj dhjetor), dhe si rezultat i zgjatjes së procedurave të investimeve, si dhe kryerjen e procedurave të prokurimit pa zgjidhur paraprakisht problemin e shpronësimeve.

Gjithashtu konstatohet se fondet e rindërtimit janë realizuar në masën 64%, ku nga vlera e parashikuar prej 2,524,223 mijë lekë është realizuar vlera 1,607,293 mijë lekë, kjo vjen si rezultat i mos mbylljes së kontratave të afatet e caktuara dhe jo për mungesë fondesh.

Ndërsa fondet nga njësitë e varësisë janë realizuar në masën 93%, ku nga vlera e parashikuar prej 2,119,988 mijë lekë është realizuar vlera 1,961,847 mijë lekë.

Në total niveli i realizimit të treguesve të buxhetit të bashkisë Durrës me të gjithë elementët (bashkia+njësitë vartëse+rindërtimi), është realizuar në masën 80%, ku nga vlera e parashikuar prej 8,624,462 mijë lekë është realizuar vlera 6,870,439 mijë lekë, sipas tabelës B.17, me një diferencë në vlerë prej 1,754,023 mijë lekë, si vijon:

Tabela B.17: Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2024, referuar akt-rakordimeve me thesarin (me njësitë e varësisë+ rindërtimi).

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2024		
		Plan	fakt	Realizimi ne %
I.	BASHKIA			
1	Paga (art.600)	490,641	454,486	93
2	Sigurime shoq. (art.601)	82,765	76,120	92
3	Shp. operative (art.602)	730,431	628,499	86
4	Transferime (art.604+606)	112,717	90,553	80
5	Fond I kushtëzuar emergj.civile (Min.17 art. 604)	21,955	13,847	63
6	Nd.ekonomike+PAK (Min.13 art.606)	1,271,561	1,269,415	100
7	Bonus qeraje familjet ne nevoje (Min.10 art.606)	34,624	34,624	100
8	Subvencion nga enti banesave (Min.10 art.606)	2,671	2,671	100
9	Bonus qiraje tërmeti (Min.10 art.606)	-	-	-
10	Investime 230+231	1,232,885	731,082	59
	Totali I.1	3,980,250	3,301,297	83
	Rindërtimi			
11	602 (transporti shembjeve) (grupi 00)	2,348	-	-
12	604-606 (grante rindërtimi DS1,DS2,DS3,DS4,DS5)(grupi 00)	263,775	258,567	98
13	230+231 (investime rindërtimi) (grupi 00)	2,258,100	1,348,726	60
	Totali 1.2 (fondet rindërtimit)	2,524,223	1,607,293	64
	TOTALI I.1+I.2 (BASHKIA)	6,504,474	4,908,592	75
II.	INSTITUCIONET DHE NDERMARRJET E VARESISE			
14	Paga (art.600)	1,068,711	974,696	91
15	Sigurime shoq. (art.601)	176,112	162,556	92
16	Shp. operative (art.602)	719,565	672,093	93
17	Shp. operative (Min. linj 11 art.602)	-	-	-
18	Transferime (art.604+606)	64,662	64,585	100
19	Transferime (Min. Linjës 10 art.604+606)	-	-	-
20	Investime 230+231	90,937	87,917	97
	TOTALI II (institucionet dhe ndërmarrjet e varësisë)	2,119,988	1,961,847	93
	TOTALI I+II	8,624,462	6,870,439	80

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Duke krahasuar dy buxhetet 2023/2024, konstatohet se buxheti i vitit 2024 në planifikim është më i ulët se buxheti i vitit 2023 për vlerën 1,448 mijë lekë, kjo vjen për faktin se në buxhetin e vitit 2024 nuk kemi fonde të parashikuara nga rindërtimi siç ka ekzistuar në buxhetin e vitit 2023.

Tabela B.18. Realizimi i fondeve sipas njësive të varësisë dhe zërave të shpenzimeve:

- Në 000/lekë

Emërtimi i Njësive Shpenzuese	Paga (600)		Sig.shoqerore (601)		Shp.operative (602)		Transferime tek individ (604+606)		Investime (230+231)		Totali (000/lekë)	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Ndërmarrja Rruga	104,542	96,500	16,757	16,197	129,250	114,079	811	735	75,171	75,166	326,531	302,676
Qendra Ekono Arsimi	433,690	388,962	71,750	64,966	184,757	179,628	1,505	1,505	-	-	691,702	635,062
Ndërm.Shërb Komun	235,926	215,141	39,317	35,929	206,520	188,478	917	917	666	666	483,346	441,130
Ndërm.Komun Plazh	106,436	102,859	17,845	17,275	91,000	89,700	564	564	185	185	216,030	210,582
Klubi Futbollit Teuta	5,707	5,201	947	868	25,000	24,999	132	132	-	-	31,786	31,201
Qend Ditor Moshuar	36,809	29,571	5,899	4,667	10,321	7,900	-	-	530	530	53,559	42,667
Klub Shumsport Teut	17,100	15,322	2,783	2,558	9,000	8,786	60,052	60,051	-	-	88,935	86,718
Qend.Kulturor Fëmijë	11,108	10,300	1,814	1,720	4,292	4,292	-	-	-	-	17,214	16,312
Qend.Kultur A.Moisiu	33,462	32,187	5,426	5,242	38,425	34,355	185	185	7,075	4,061	84,573	76,030
Biblioteka	14,507	13,762	2,378	2,298	6,000	5,302	135	135	120	120	23,140	21,616
Agjensia e Parqeve	69,425	64,891	11,197	10,836	15,000	14,575	360	360	7,190	7,190	103,172	97,853
Totali	1,068,712	974,696	176,113	162,556	719,565	672,094	64,661	64,584	90,937	87,918	2,119,988	1,961,847

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Realizimi i buxhetit për vitin 2024, sipas burimit të financimit për Bashkinë Durrës (pa ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë), paraqitet në Tabelën B.19, si vijon:

Tabela B.19: Buxheti sipas burimeve të financimit, (pa njësitë e varësisë)

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2024 (000/lekë)		
		Plan	Fakt	Realizimi në %
1.	Paga 600	490,641	454,486	93
	nga të ardhurat	30,624	28,613	93
	nga transfertat pakushtëzuar + sektoriale	436,128	403,188	92
	nga ministrinë e linjës	23,890	22,686	95
2.	Sigurime shoqërore 601	82,765	76,120	92
	nga të ardhurat	5,760	3,928	68
	nga transfertat pakushtëzuar + sektoriale	73,202	68,661	94
	nga ministrinë e linjës	3,803	3,531	93
3.	Shpenz.operative 602	732,779	628,499	86
	nga të ardhurat	148,562	121,966	82
	nga transfertat pakushtëzuar + sektoriale	553,330	481,577	87
	nga ministrinë e linjës	28,539	24,956	87
	nga rindërtimi (grupi 00)	2,348	-	-
4.	Transfer 604 (kuota Qarkut, fondi kushtëzu emergjenca civile)	74,029	61,161	83
	nga të ardhurat	46,102	46,064	100
	nga transfertat pakushtëzuar + sektoriale	-	-	-
	nga ministrinë e linjës	21,955	13,847	63
	nga rindërtimi (grupi 00)	5,972	1,250	21
5.	Transferime 606 (bonus strehimi, ndihma financiare)	1,613,274	1,608,518	100
	nga të ardhurat	24,300	23,029	95
	nga transfertat pakushtëzuar + sektoriale	2,707	2,384	88
	nga ministrinë e linjës	1,328,464	1,325,788	100
	nga ministrinë e linjës (bonusi qerasë së tërmetit)	-	-	-
	nga rindërtimi	257,803	257,317	100
6.	Fondi rezervë + kontigjencës 609	20,000	-	-
	nga të ardhurat	-	-	-

Nr.	Emërtimi	Viti 2024 (000/lekë)		
		Plan	Fakt	Realizimi në %
	<i>nga transfertat pakushtëzuar + sektoriale</i>	20,000	-	-
7.	Investime 230-231	3,490,985	2,079,808	60
	<i>nga të ardhurat</i>	1,066,803	685,357	64
	<i>nga transfertat pakushtëzuar + sektoriale</i>	101,568	124	0.12
	<i>nga ministritë e linjës</i>	64,514	45,601	71
	<i>nga rindërtimi (grupi 00)</i>	2,258,100	1,348,726	60
8.	TOTALI	6,504,474	4,908,592	75
	<i>nga të ardhurat</i>	1,322,150	908,957	69
	<i>nga transfertat pakushtëzuar + sektoriale</i>	1,186,935	955,934	81
	<i>nga ministritë e linjës</i>	1,471,166	1,436,408	98
	<i>nga rindërtimi</i>	2,524,223	1,607,293	64

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat e mësipërme, rezultoi se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitin 2024 të ketë mosrealizime.

Në totalin e fondeve të parashikuara për shpenzime, peshën kryesore e zënë fondet nga rindërtimi në masën 38.8% e ndjekur nga ministritë e linjës në masën 22.6%. Ndërsa me të ardhurat e veta mbulon 20.3% të totalit. Gjithashtu, pjesën më të madhe të të ardhurave, bashkia e përdor për investime në masën 80.6 % e ndjekur nga shpenzimet operative me 11.2%.

- **Realizimi i Investimeve për vitin 2023.**

Në total realizimi i treguesve të buxhetit pa njësitë vartëse është në masën 72%, ku nga vlera e planifikuar prej 8,072,638 mijë lekë është realizuar vlera 5,785,591 mijë lekë. Ndikim në këtë mosrealizim ka zëri investime, ku pa fondet e rindërtimit paraqitet me një realizim në masën 77%, pasi nga vlera e parashikuar prej 950,079 mijë lekë është realizuar vlera 733,730 mijë lekë, me një diferencë prej 216,349 mijë lekë. Ndikimi në këtë mosrealizim vjen nga fondet e transfertave të pakushtëzuar + sektoriale në masën 18%, ku nga vlera e parashikuar prej 48,217 mijë lekë është realizuar vlera 8,509 mijë lekë, e ndjekur nga ministritë e linjës me 33% nga vlera e parashikuar prej 20,324 mijë lekë është realizuar vlera 6,805 mijë lekë.

Sipas përfaqësuesve të Bashkisë Durrës (*Drejtoria Financë/Buxhet*), ky mosrealizim ka ardhur për shkak të mos zbatimit të kontratave në afat (zgjatje afati), lidhjes së kontratave të fund të periudhës ushtrimore (*muaj dhjetor*), si rezultat i zgjatjes së procedurave të prokurimit, si dhe kryerjen e procedurave të prokurimit pa zgjidhur paraprakisht problemin e shpronësimeve., duke bërë që realizimi i kontratës dhe financimi të shtrihet përtej vitit ushtrimor.

Ndërsa fondet e rindërtimit janë realizuar në masën 59%, ku nga vlera e parashikuar prej 4,424,413 mijë lekë është realizuar vlera 2,619,364 mijë lekë dhe kjo si rezultat i mos mbylljes në afat të kontratave dhe jo mungesës së fondeve.

Arsyet që kanë ndikuar në këtë realizim kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit, problematikat që kanë patur gjatë realizimit të punimeve. Të gjitha fondet e alokuara për projekte investimesh për rindërtimin janë prokuruar.

- **Realizimi i Investimeve për vitin 2024.**

Në total realizimi i treguesve të buxhetit pa njësitë vartëse është në masën 75%, ku nga vlera e planifikuar prej 6,504,474 mijë lekë është realizuar vlera 4,908,592 mijë lekë. Ndikim në këtë

mosrealizim ka zëri investime, ku pa fondet e rindërtimit paraqitet me një realizim në masën 59%, pasi nga vlera e parashikuar prej 1,232,885 mijë lekë është realizuar vlera 731,082 mijë lekë, me një diferencë prej 501,803 mijë lekë. Këtu ndikon mos realizmi i fondeve nga transfertat pakushtëzuar + sektoriale në masën 0.12%, ku nga vlera e parashikuar prej 101,568 mijë lekë është realizuar vlera 124 mijë lekë, e ndjekur nga të ardhurat e Bashkisë me 64%, ku nga vlera e parashikuar 1,066,803 mijë lekë është realizuar 685,357 mijë lekë dhe nga ministritë e linjës me 71%, ku nga vlera e parashikuar prej 64,514 mijë lekë është realizuar vlera 45,601 mijë lekë.

Sipas përfaqësuesve të Bashkisë Durrës (*Drejtoria Financë/Buxhet*), ky mosrealizim ka ardhur për shkak të mos zbatimit të kontratave në afat (zgjatje afati), lidhjes së kontratave të fund të periudhës ushtrimore (*muaj dhjetor*), si rezultat i zgjatjes së procedurave të prokurimit, si dhe kryerjen e procedurave të prokurimit pa zgjidhur paraprakisht problemin e shpronësimeve., duke bërë që realizimi i kontratës dhe financimi të shtrihet përtej vitit ushtrimor.

Ndërsa fondet e rindërtimit janë realizuar në masën 60%, ku nga vlera e parashikuar prej 2,258,100 mijë lekë është realizuar vlera 1,348,726 mijë lekë dhe kjo si rezultat i mos mbylljes në afat të kontratave dhe jo mungesës së fondeve.

Arsyet që kanë ndikuar në këtë realizim kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit, problematikat që kanë patur gjatë realizimit të punimeve. Të gjitha fondet e alokuara për projekte investimesh për rindërtimin janë prokuruar.

- **Miratimi i buxhetit faktik.**

- **Për periudhën e vitit 2023**, buxheti faktik nga Bashkia Durrës është miratuar me Vendim të KB nr. 37 datë 21.05.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 328/2 prot, datë 29.05.2024.

- **Për periudhën e vitit 2024**, buxheti faktik nga Bashkia Durrës është miratuar me Vendim të KB nr. 37 datë 21.05.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 328/2 prot, datë 29.05.2024.

Për të dy periudhat, në relacionin përfundimtar të zbatimit të buxhetit është hartuar vetëm realizimi i treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk është shoqëruar me analizë faktoriale për realizimet e fondeve dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës.

- **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 muajor në Këshillin Bashkiak.**

- **Për periudhën e vitit 2023**, nga ana e Bashkisë çdo 4 muaj janë hartuar raportet e monitorimit të cilat i janë dërguar elektronikisht Ministrisë së Financave dhe Këshillit Bashkiak. Këto raporte janë dërguar elektronikisht në Ministrinë e Financave. Raporti për 4 muajorin e I-re 2023 është dërguar më datë 31/5/2023, për 4 muajorin e II-të (progresivi) është dërguar me 2/10/2025 dhe për 4 muajorin e III-të (vjetori) është dërguar më 4/4/2023. Raporti vjetor i monitorimit të buxhetit 2023 është miratuar në Këshill Bashkiak me Vendimin nr. 37 datë 21.05.2024.

- **Për periudhën e vitit 2024**, nga ana e Bashkisë çdo 4 muaj janë hartuar raportet e monitorimit të cilat i janë dërguar elektronikisht Ministrisë së Financave dhe Këshillit Bashkiak. Këto raporte janë dërguar elektronikisht në Ministrinë e Financave. Raporti për 4 muajorin e I-re 2023 është dërguar më datë 31/5/2023, për 4 muajorin e II-të (progresivi) është dërguar me 2/10/2025 dhe për 4 muajorin e III-të (vjetori) është dërguar më 4/4/2023. Raporti vjetor i monitorimit të buxhetit 2023 është miratuar në Këshill Bashkiak me Vendimin nr. 37 datë 21.05.2024.

- **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.**

- **Për periudhën e vitit 2023**, me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës. Fondi rezervë i planifikuar prej 25,000 mijë lekë dhe fondi i kontigjencës i planifikuar në vlerën 15,000 mijë lekë, nuk janë përdorur.

- **Për periudhën e vitit 2024**, me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës. Fondi rezervë i planifikuar në vlerën 75,000 mijë lekë, *nga e cila*: përdorur vlera 22,616 mijë lekë dhe papërdorur vlera 52,384 mijë lekë.

Është përdorur në dy raste si më poshtë :

a- Në vlerën 6,064 mijë, në zbatim të VKB nr. 98 dt.28.10.2024 "Për miratimin e përdorimit të fondit prej 6.064 mijë lekë, të alokuara nga Bashkia Durrës në zbatim të VKB-së nr.90 datë.24.09.2024 "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Durrës për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit në Bashkinë Durrës".

b- Në vlerën 16,552 mijë, në zbatim VKB nr. 97 dt.28.10.2025 "Për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e këshillit bashkiak nr.195 dt.22.12.2023, "Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024".

Ndërsa Fondi i Kontigjencës i planifikuar në vlerën 15,000 mijë lekë nuk është përdorur.

- **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.**

- **Për periudhën e vitit 2023**, nga Bashkia Durrës është krijuar edhe fondi për emergjencat civile nga të ardhurat e veta të Bashkisë në vlerën 35,000 mijë lekë në programin e mbrojtjes civile (kodi programit 03280), por që nuk është përdorur, dhe për **periudhën e vitit 2024**, në vlerën 14,000 mijë lekë në programin e mbrojtjes civile (kodi programit 03280) dhe nuk është përdorur.

- **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Durrës.**

Për periudhën e vitit 2023 - 2024, nga Bashkia Durrës nuk është marrë asnjë subvencion për periudhën objekt auditimi.

2.2.3. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

- **Për periudhën e aktivitetit 2023.**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Me fondet e vitit buxhetor 2023, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta. Ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZSHH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetet respektive është paraqitur e detajuar në **tabelën B.20**, si vijon:

Tabela B.20: Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara

Në mijë lekë

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog. 602	Llog. 230-231
Viti 2022	110,374	6,609	Nr. 149, datë 22.12.2022	6,204	405
Viti 2023	309,915	267,083	Nr. 38 dt.21.05.2024 Nr.31 dt.06.03.2024	67,548 -	30,048 169,487

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat e tabelës B.20, rezultoi se nga totali i faturave të palikujduara për vitin 2022 me vlerë 110,374 mijë lekë, bashkia ka planifikuar për likuidim në buxhetin e vitit 2023 vlerën 6,609 mijë lekë ose 5.9% e detyrimeve, vlerë kjo shumë e ulët në krahasim me totalin e detyrimeve që kjo bashki ka dhe në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit” pika 106².

Ndërsa për detyrimet e vitit 2023, të cilat janë në vlerën 309,915 mijë lekë, bashkia ka planifikuar për likuidim në buxhetin e vitit 2024 vlerën prej 267,083 mijë lekë ose 86% e detyrimeve.

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar edhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura janë paraqitur të detajuara në **tabelën B.21**, si vijon:

Tabela B.21: Zhvillimi i shumës së detyrimit të prapambetur në fund të vitit 2023

Në mijë lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2022	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2023	Total detyrime	Shlyerja gjate vitit 2023	Mbetja në fund të vitit 2023
A	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrinë e linjës e FZSHS (trashëguar nga ish komunat)	36,370,104		36,370,104		36,370,104
b. Investime nga te ardhurat (trashëguar nga ish komunat)	535,060		535,060		535,060
b. Investime Bashkia		30,048,107			30,048,107
INVESTIME	36,905,164	30,048,107	66,953,271	0	66,953,271
Mallra dhe shërbime		5,554	5,554		5,554
Vendime gjyqësore	73,469,228		73,469,228		73,469,228
- Largim nga puna	6,204,042		6,204,042		6,204,042
- Te tjera	67,265,186		67,265,186		67,265,186
Tjera (Situacione Rindërtimi)		169,487,091	169,487,091		169,487,091
Totali	110,374,392	199,540,752	309,915,144	0	309,915,144

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar shkresës nr. 1366/1 prot, datë 09.03.2023 “Dërgohet vetëvlerësimi financiar për vitin 2022”, plani i shlyerjeve të detyrimeve të prapambetura për periudhën 2023-2025 të Bashkisë Durrës dërguar në MFE e për rrjedhojë dhe publikimit të detyrimeve të prapambetura në faqen e MFE.

² Në të cilën përcaktohet se: “Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim

Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 110,374 mijë lekë dhe në fund të vitit 2023 referuar shkresës nr.prot. 2900 prot, datë 29.02.2024 “Dërgohet vetëvlerësimi financiar për vitin 2023 dhe plani i shlyerjeve 2024-2026” në shumën 309,915 mijë lekë. Evidentohet fakti se gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 199,540, mijë lekë. Këto detyrime janë nga fondi i rindërtimit në vlerën 169,487 mijë lekë për 11 fatura dhe 30,053 mijë lekë, ndërsa nga fondet e Bashkisë i përkasin 3 faturave.

Detyrimet e mbartura nga ish komunat për investime, të cilat janë në vlerën 36,905 mijë lekë nuk janë likuiduar sepse kanë mungesë dokumentacioni, kurse detyrimet e reja të krijuara gjatë vitit 2023 në vlerën 199,540 mijë lekë (169,487 mijë lekë nga rindërtimi dhe 30,053 mijë lekë nga fondet e Bashkisë), nuk janë likuiduar për arsye se nga bashkia Durrës janë paraqitur për likuidim faturat në muajin Janar 2024, por që janë kthyer pas nga Dega e Thesarit duke mbetur për likuidim për vitin 2024 dhe janë planifikuar për t’u likuiduar gjatë vitit 2024, pra nuk ka të bëjë me mungesë fondesh. Analiza e detyrimeve të fundvitit 2023, paraqitet në Aneksin 1, bashkëlidhur.

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikuiduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, rezultoi se për vitin 2023, detyrimet e raportuara janë në vlerën 309,915 mije lekë, sipas ditarit të bankës dhe urdhër-shpenzimeve e dokumentacionit financiar shoqërues të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike, pra nuk ka diferenca.

- **Situata financiare viti 2023.**

Rezultoi se detyrimet e prapambetura janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të MFE rubrika “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Raportimet për vetëvlerësimin financiar dërguar çdo 4 mujour pranë MFE me shkresat nr. 5272 datë 31.05.2023 për 4 mujoin e I-të 2023, nr. 8866 dt.25.09.2023 për 4 mujoin e II-të , progresiv , 2023 dhe nr.2900 dt.29.02.2024 për vitin 2023.

NR.	Emërtimi	Stoku në vlerë (në lekë)	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzim e vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	140,428,053		
Llog. Ekon.	Emërtimi			3.96%
4864100	Vendime Gjyqesore	73,469,228		
4864200	Det.Prap. Sherbime	5,554		
4864201	D.P.Eneri Elektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	66,953,271		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			

NR.	Emërtimi	Stoku në vlerë (në lekë)	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzim e vjetore faktike të NJVQV-së
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	140,428,053	3,547,116,037	3.96%
	Vlera e detyrimeve sipas Thesarit	309,915,144		
	Diferenca me Thesarin	169,487,091	Kjo diference janë detyrime qe rrjedhin nga faturat e palikujduara te objekteve me fonde rindërtimi, te cilat ne thesar janë te regjistruara ne grupin 00 dhe sipas udhëzimit te MF kjo vlerë nuk duhet te përfshihet ne detyrimet e pasqyruara ne tabelën e mësipërme	

Analiza e vlerës së detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2023 dhe raportuar në MFE paraqitet më poshtë:

a. Shpenzime kapitale në vlerën 66,953,271 lekë.

Janë fatura të palikujduara për mungesë dokumentacioni të mbartura nga ish komunitat.

b. Vendime gjyqësore në vlerën 73,469,228 lekë. Kjo vlerë përfaqëson vendimet gjyqësore për mospagim faturash të Ujësjetllësit nga ish-Komuna Sukth në vlerën 64,128,642 lekë me kreditor UKD Durrës, për largim nga puna në vlerën 6,204,042 lekë dhe të tjera (1 shpronësim në vlerën 3,136,544 lekë).

Nga analiza e detyrimeve të pa likuiduara konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2022 Bashkia Durrës ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 110,374 mijë lekë, e cila në fund të vitit 2023 është rritur në vlerën 309,915 mijë lekë, pra kemi shtesë për vlerën 199,541 mijë lekë, ku peshën më të madhe e zënë detyrimet, që rrjedhin nga fondet e rindërtimit në vlerën 169,487 mijë lekë e ndjekur nga vendimet gjyqësore në vlerën 73,469,228 lekë.

Sipas raportimit në MFE detyrime të krijuara gjatë vitit 2023 paraqiten në vlerën 199,541 mijë lekë dhe në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 309,487 mijë lekë, vlerë e cila kuadron me bilancin gjendja e llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” në fund të vitit 2023.

- Për periudhën e vitit 2024.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Me fondet e vitit buxhetor 2024, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës apo FZSHH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve. Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetet respektive është paraqitur e detajuar në **Tabelën B.22**, si vijon:

Tabela B.22: Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara

Në mijë lekë

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog. 602	Llog. 230-231
Viti 2022	110,374	6,609	Nr. 149, datë 22.12.2022	6,204	405
Viti 2023	309,915	267,083	Nr. 38 dt.21.05.2024 Nr.31 dt.06.03.2024	67,548 -	30,048 169,487
Viti 2024	39,606				

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Planifikimi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nga vitet paraardhës në buxhetet është në vlerën 267,083 mijë lekë, e paraqitur me detaje në **Tabelën B.22** (si më sipër), nga ku rezultoi se Bashkia Durrës në planifikimin e fondeve buxhetore për likuidimin e faturave të prapambetura (kreditorët) me miratimin e buxheteve, janë planifikuar 87% të totalit të detyrimeve. Diferenca prej 39,606 mijë lekë nuk është planifikuar dhe likuiduar sepse janë detyrime të mbartura nga ish-komunat për të cilat nuk ka faturë tatimore si dhe situacion të punimeve faktike të realizuara. Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar edhe të dhënave të rubrikës “*Detyrimet e prapambetura*”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura janë paraqitur të detajuara në **Tabelën B.23**, si vijon:

Tabela B.23: Zhvillimi i shumës së detyrimit të prapambetur në fund të vitit 2024

Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2023	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2024	Total detyrime	Shlyerja gjatë vitit 2024	Mbetja në fund të vitit 2024
A	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrinë e linjës e FZHS (trashëguar nga ish komunat)	36,370,104		36,370,104	0	36,370,104
b. Investime nga te ardhurat (trashëguar nga ish komunat)	535,060		535,060	405,000	130,060
b. Investime Bashkia	30,048,107		30,048,107	30,048,107	
INVESTIME	66,953,271		66,953,271	30,453,107	36,500,164
Mallra dhe shërbime	5,554		5,554	5,554	0
Vendime gjyqësore	73,469,228		73,469,228	70,363,373	3,105,855
- Largim nga puna	6,204,042		6,204,042	6,204,042	0
- Te tjera	67,265,186		67,265,186	64,159,331	3,105,855
Tjera (Situacione Rindërtimi)	169,487,091		169,487,091	169,487,091	0
Totali	309,915,144	0	309,915,144	270,309,125	39,606,019

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar shkresës nr. 2900 prot, datë 29.02.2024 “*Dërgohet vetëvlerësimi financiar për vitin 2023 dhe plani i shlyerjeve 2024-2026*”, të Bashkisë Durrës dërguar në MF e për rrjedhojë dhe publikimit të detyrimeve të prapambetura në faqen e MF, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2023 paraqiten në shumën 309,915 mijë lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqiten në shumën 39,606 mijë lekë, referuar shkresës nr.2422 prot, datë 18.02.2025 “*Dërgohet vetëvlerësimi financiar për vitin 2024 dhe plani i shlyerjeve 2025-2027*”.

Evidentohet fakti se gjatë vitit 2024 nuk janë krijuar detyrime të reja dhe detyrimet e prapambetura të trashëguara nga viti i mëparshëm janë likuiduar në vlerën 270,309 mijë lekë, pra janë likuiduar 87% e tyre. Vlera e mbetur prej 39,606 mijë lekë janë detyrime të mbartura nga ish komunat, nga të cilat 36,500 mijë lekë janë fatura investimesh për të cilat nuk ka dokumentacion që të justifikojë

realizimin faktik të këtyre investimeve dhe 3,105 mijë lekë është një vendim gjyqësor i mbartur nga ish komunat për mospagesë faturash të ujësjellësit. Edhe për këtë vlerë mungon dokumentacioni. *Analiza e detyrimeve të fundvitit 2024, paraqitet në Aneksin 2 bashkëlidhur.*

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikuiduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, *rezultoi se për vitin 2024*, detyrimet e raportuara janë në vlerën 39,606 mijë lekë, sipas ditarit të bankës dhe urdhër-shpenzimeve e dokumentacionit financiar shoqërues të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike, pra nuk ka diferenca.

- **Faturat e pa likuiduara.**

Për periudhën e vitit 2023, nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me mos respektimin e afatit **60 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Durrës, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se janë pa paguar gjithsej **22** fatura me vlerë **200,075 mijë lekë**, sipas tabelës B.24. Ndërsa analitikisht paraqiten në Aneksin 3 bashkëlidhur PRA.

Tabela B.24: Shpërndarja e faturave të palikuiduara për vitin 2023

Në mijë lekë

Llog. 602		Llog. 230-231		Shuma (602+231)	
Nr. raste	Vlera	Nr. raste	Vlera	Nr. raste	Vlera
1	5	21	200,070	22	200,075

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit. Vlere e kuadruar ne pasqyrat financiare viti 2023

Sipas të dhënave, rezultoi se për një pjesë të objekteve të prokuruar megjithëse kanë përfunduar sipas kushteve dhe aftit të kontratave nuk janë paraqitur për likuidim faturat në bashkinë Durrës, duke bërë që situata kreditore në fund të periudhës 2023, të mos jetë ajo që paraqitet, duke mos pasqyruar vlera 87,264 mijë lekë, vlerë e cila i duhet shtuar vlerës 309,915 mijë lekë dhe situata e saktë e faturave të palikuiduara në fund të periudhës do duhej të ishte 397,179 mijë lekë, konkretisht tabelën B.25, si vijon:

Tabelë B.25. Lista e subjekteve që nuk kanë paraqitur faturë likuidimi.

Nr.	Objekti i prokuruar	Vlera kontratës lidhur TVSh e së me	Subjekti	Vlera mbetur e
1	Rikonstruksion dhe shtese Qendra Shëndetësore Spitalle	15,656,918	K.	4,269,498
2	Rikonstruksion rruga Dervish Hima	11,332,200	V.	1,133,447
3	Rikonstruksion rruge ne NJA Rrushbull	6,793,200	K.	6,793,200
4	Rehabilitim I Shëtiores Taulantia (Loti III)	15,230,588	M.P	15,230,588
5	Rehabilitim Rruga e Deshmoreve , segmenti nga kryqëzimi me rrugën Mujo Ulqinaku tek Stacioni I Trenit.	48,041,775	E.N	41,076,975
6	Rikualifikim hapësira publike ne Lagjen nr.13 dhe nr.6	18,760,674	K.K	18,760,674
		115,815,355		87,264,382

Ndërsa në lidhje me mos likuidimin e faturave në vlerën e plotë, konstatohet se nuk ka raste të tilla, pasi të gjithë faturat e paraqitura janë likuiduar totalisht për vlerën e faturës së paraqitur për likuidim.

Për aktivitetin e vitit 2024, nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me mos respektimin e afatit **60 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Durrës, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2024, janë pa paguar gjithsej **7** fatura me vlerë **130 mijë lekë**, të dhëna të cilat paraqiten në tabelën B.26. Ndërsa analitikisht janë paraqitur në *Aneksin 4 bashkëlidhur PRA*.

Tabela B.26: Shpërndarja e faturave të palikuiduara për vitin 2024

Në lekë

Llog. 602		Llog. 230-231		Shuma (602+231)	
Nr. raste	Vlera	Nr. raste	Vlera	Nr. raste	Vlera
0	0	7	130,060	0	130,060

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit. Vlera e kuadruar në Tabelat financiare viti 2024

- Situata financiare viti 2024.

Nga auditimi, rezultoi se detyrimet e prapambetura janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të MFE rubrika “*Detyrimet e prapambetura*”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Raportimet për vetëvlerësimin financiar dërguar çdo 4 mujor pranë MF me shkresat nr. 7259 *prot*, datë 07.06.2024 për 4 mujorin e I-rë 2024, nr. 11172 *prot*, dt. 26.09.2024 për 4 mujorin e II-të , progresiv , 2024 dhe nr. 2422 *prot*, dt.18.02.2025 për vitin 2024.

NR.	Emërtimi	Stoku në vlerë (në lekë)	Shpenzime vjetore faktike NJVQV-në për	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	39,606,019		1.03 %
Llog. Ekon.	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	3,105,855		
4864200	Det.Prap. Sherbime			
4864201	D.P.Eneri Elektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	36,500,164		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	39,606,019	3,826,738,563	1.03 %

NR.	Emërtimi	Stoku në vlerë (në lekë)	Shpenzime vjetore faktike NJVQV-në për	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
	Vlera e detyrimeve sipas Thesarit	39,606,019		
	Diferenca me Thesarin	0		

Analiza e vlerës së detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2024 dhe raportuar në MFE paraqitet më poshtë:
b. **Shpenzime kapitale në vlerën 36,500,164 lekë.** Janë fatura të palikujduara për mungesë dokumentacioni të mbartura nga ish komunat.

b. Vendime gjyqësore në vlerën 3,105,855 lekë. Kjo vlerë përfaqëson vendimet gjyqësore për mospagim faturash të Ujësjetllësit nga ish-Komuna Sukth.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2024, rezultoi se është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën e plotë të detyrimeve, për detyrimet të cilat ka patur dokumentacion.

Nga analiza e detyrimeve të pa likuiduara konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2023 Bashkia Durrës ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 309,915 mijë lekë, e cila në fund të vitit 2024 është pakësuar me 270,309 mijë lekë, duke arritur në vlerën 39,606 mijë lekë dhe këto janë detyrime të mbartura nga ish komunat, të cilat nuk likuidohen për mungesë dokumentacioni.

Sipas raportimit në MFE detyrime të reja të krijuara gjatë vitit 2024 nuk ka, dhe në fund të vitit 2024 detyrimet paraqiten në vlerën 39,606 mijë lekë, vlerë e cila kuadron me bilancin gjendja e llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” në fund të vitit 2024.

- Vështirësia Financiare për periudhën 2023 - 2024.

Për periudhën ushtrimore 2023, nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (të akumuluar) në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën 140,428 mijë lekë. Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 3.96 % kundrejt fondeve të miratuara. Ndërsa **për periudhën ushtrimore 2024,** detyrimet e papaguara (të akumuluar) në fund të vitit 2024 paraqiten në vlerën 39,606 mijë lekë. Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 1.03 % kundrejt fondeve të miratuara.

Kjo situatë tregon se, Bashkia Durrës nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të periudhave ushtrimor 2023 - 2024, por konsiderohet në një situatë normale financiare pasi raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës, detyrimet kontraktore dhe shpronësimet.

Për vitin ushtrimorë 2023, nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, rezultoi se deri në fund të vitit 2022 paraqitet gjithsej vlera prej 67,265 mijë lekë. Gjatë vitit 2023 është shtuar për vlerën 6,724 mijë lekë nga e cila likuiduar vlera prej 6,724 mijë lekë, duke mbetur për likuidim vlera prej 67,265 mijë lekë. Më hollësisht janë paraqitur të detajuara në **tabelës B.27, si vijon;**

Tabela B.27: Mbi pagesat e vendimet gjyqësore

Në lekë

Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2023	Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2023	Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2023	Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2023	Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2023	Detyrimi në lekë më 31.12.2023
Për paga	6,204,042	0	6,724,981	6,724,981	6,204,042
Të tjera	67,265,186	0	0	0	67,265,186

Nga shqyrtimi i ditarit të bankës mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa shkaqe ligjore, rezultoi se përgjatë vitit 2023 janë kryer likuidime të plota/pjesore, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet në vlerën **6,204 mijë lekë**, kjo për faktin se për një pozicion pune paguhen dy persona.

Këto vendime gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësi administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësi administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60.

Për periudhën ushtrimore të vitit 2024, nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, rezultoi se deri në fund të vitit 2024 paraqitet gjithsej vlera prej 73,469 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 është likuiduar vlera prej 70,363 mijë lekë, duke mbetur për likuidim vlera prej 3,106 mijë lekë. Më hollësisht janë paraqitur të detajuara në **Tabelën B.28**, si vijon:

Tabelën B.28: Mbi pagesat e vendimet gjyqësore

Në lekë

Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2023	Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2024	Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2024	Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2024	Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2024	Detyrimi në lekë më 31.12.2024
Për paga	6,204,042	0		6,204,042	-
Të tjera	67,265,186	0	0	64,159,331	3,105,855

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre:

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investimeve, burimi financimi nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta të Bashkisë Durrës duke përfshirë edhe fondet e trashëguara të investimeve nga viti i kaluar.

- Për periudhën e vitit 2023.

Plani i investimeve paraqitet në vlerën 950,079 mijë lekë, kurse realizimi është në vlerën 733,731 mijë lekë, ose 77% e parashikimit. Realizimi në masën 77% i investimeve ka ardhur si rezultat i disa shkaqeve, si:

- a- Nuk është prerë fatura nga ana e operatorit fitues;
- b- Një pjesë e prokurimeve nuk kanë përfunduar brenda vitit (me amendament shtesë afat kontrate), pasi ka pasur vonesa në vlerësimin e procedurës;

c- *Një pjesë e kontratave janë lidhur në muajt e fundit të vitit, gjë që ka sjellë që zbatimi i tyre të mos përfundojë brenda vitit.*

Referuar të dhënave dhe analizës së investimeve për vitin 2023, nisur nga planifikimi, realizimi i procedurave, zbatimi i kontratave dhe financimi i projekteve të investimeve me burim financimin nga të ardhurat e veta, transferta e pakushtëzuar fondet e specifike, paraqitet si vijon:

- Për vitin 2023, janë programuar dhe buxhetuar **85 projekte** investimi në vlerën 1,318,278,873 lekë për të cilat janë çelur fonde në vlerën 950,078,828 lekë, fonde të cilat janë realizuar në vlerën 733,730,562 lekë ose 77.2%.

- 10 kontrata kanë mbetur pa financuar në vlerën 191,173,781 lekë, pasi punimet nuk kanë përfunduar sipas afateve të caktuar (shitesë kontrate në afate);

- Nuk është mbyllur vlera prej 22,400,858 lekë, pasi nuk kanë përfunduar procedurat e shpronësimit, kjo për mungesë dokumentacioni argumentues;

- Detyrimet e papaguara të kredisë CEB (*ndërtim banesa sociale principal + interes*), për vlerën 13,646,131 lekë, i përket kredisë CEB (*ndërtim banesa sociale-principali*). të detyrimit të papaguar të vitit 2023 të kredisë CEB (*ndërtim banesa sociale- principal*). Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkisë Durrës për projektin “*Ndërtim i banesave me qëllim social*”, Bashkia Durrës i paguan Ministrisë së Financave principalin për fondet e dibursuara, sipas transheve të kredisë. Afati i përfundimit të kredisë është në vitin 2030. Bashkia Durrës nuk ka hua të marra nga ana e saj.

Nga 85 projekte investimi në vlerën 1,318,278,873 lekë, e detajuar :

- Për 30 projekte investimi dhe shpronësimi në vazhdim të trashëguara nga periudhat paraardhëse, janë buxhetuar për vitin 2023 në vlerën 386,855,586 lekë. Është çelur fondi për 29 projekte në vlerën 367,054,132 lekë dhe janë financuar 26 projekte në vlerën 272,096,235 lekë, ndërsa 3 projekte nuk janë financuar edhe pse janë çelur fondet, nga të cilat: për 1(një) rast është anuluar kontrata, 1(një) rast janë pezulluar punimet për arsye shpronësimi dhe 1 (një) rast nuk është paraqitur në finance dokumentacioni i plote sipas marrëveshjes së bashkëfinancimit, në 1 (një) rast është buxhetuar fondi në vlerën 4,967,903 lekë, por nuk është çelur për arsye se nuk është kryer procedura e shpronësimit.

- Për 31 projekte investimi janë lidhur kontratat në vlerën 678,010,752 lekë. Janë çelur fondet në vlerën 514,423,800 lekë dhe janë financuar në vlerën 450,022,932 lekë, ku 4 projekte nuk janë financuar në vlerën 76,222,262 lekë edhe pse janë çelur fondet për to, pasi është vonuar përfundimi i punimeve apo afatet e përfundimit të punimeve shtrihet përtej vitit ushtrimor pasi kontratat janë lidhur me vonesë në muajt e fundit të vitit buxhetor.

- Për 21 projekte investimi në vlerën 212,733,600 lekë, janë çelur fonde në vlerën 38,033,600 lekë, ku për 2 projekte investimi kanë përfunduar me vonesë procedurat e prokurimit, duke u lidhur kontratat në vitin 2024, ndërsa për 19 projekte investimi të buxhetuar në vlerën 197,733,600 lekë nuk janë kryer procedurat e prokurimit, duke mos i realizuar ato gjatë vitit 2023 pavarësisht se ato janë programuar, gjë që ka sjellë planifikim të investimeve përtej mundësive.

- Me financim nga Ministritë e linjës janë 3 projekte, si:

a. Objekti: “*Rindërtimi i Qendrës Rinore Multifunkionale Durrës*”, ku vlera e plote e projektit është 11,311,111 lekë (*bashkëfinancim i bashkisë me 12% ose vlera 1,311,111 lekë*), pjesa tjetër prej 10,000,000 lekë (*financim nga Agjencia Kombëtare e Rinisë*). Fondi i çelur në Thesar nga AKR është 9,000,000 lekë dhe realizuar 5,406,614 lekë. Kontrata është 9,344,354 lekë.

b. Objekti: “*Përforcim terreni nga rrëshqitja në zonën e NJA nr.2, nr.4, Ishëm (VKM nr.260 dt.27.04.2023)*” me fond limit 7,987,214 lekë. Fondi i çelur në thesar është 7,987,214 lekë. Për këtë projekt kontrata është lidhur në 3 janar 2024 me vlerë 5,541,743 lekë.

c. TVSH për projektin "Pajisje mobilierie për objekte të rindërtimit me UNDP", çelur fondi nga Ministria e Arsimit për vitin 2023 në vlerën 3,336,537 lekë dhe realizuar 1,398,692 lekë.

Për vitin 2023 planifikimi, realizimi i procedurave, zbatimi i kontratave dhe financimi i projekteve të investimeve me burim financimi nga Fondi i Rindërtimit paraqiten në *Aneksin 5, bashkëlidhur aktit.*

- **Për periudhën e aktivitetit të vitit 2024.**

Plani i investimeve paraqitet në vlerën 1,232,885 mijë lekë, kurse realizimi është në vlerën 731,082 mijë lekë, ose 60% e parashikimit. Realizimi në masën 60% i investimeve ka ardhur si rezultat i disa shkaqeve si:

a- *Nuk është prerë fatura nga ana e operatorit fitues;*

b- *Një pjesë e prokurimeve nuk kanë përfunduar brenda vitit (me amendament shtesë afat kontrate), pasi ka pasur vonesa në vlerësimin e procedurës;*

c- *Një pjesë e kontratave janë lidhur në muajt e fundit të vitit, gjë që ka sjellë që zbatimi i tyre të mos përfundojë brenda vitit.*

Referuar të dhënave dhe analizës së investimeve për vitin 2024 duke u nisur nga planifikimi, realizimi i procedurave, zbatimi i kontratave dhe financimi i projekteve të investimeve me burim financimin nga të ardhurat e veta, transferata e pakushtëzuar fondet e specifike, paraqitet si vijon:

- Për vitin 2024, janë programuar dhe buxhetuar 83 projekte investimi në vlerën 1,834,854,195 lekë për të cilat janë çelur fonde në vlerën 1,232,885,112 lekë, ku në fakt fondet janë realizuar në vlerën 731,081,760 lekë ose 59.3% e fondeve të çelura.

- 20 kontrata kanë mbetur pa financuar në vlerën 314,127,164 lekë, pasi janë në proces përfundimi;

- Për shpronësimet paraqitet vlera e mbetur prej 26,869,419 lekë, kjo për mungesë dokumentacioni argumentues.

Nga 83 projekte investimi në vlerën 1,834,854,195 lekë, e detajuar :

- Për **21 projekte** investimi janë buxhetuar për vitin 2024 në vlerën 611,843,699 lekë. Është çelur fondi për **20** projekte në vlerën 500,739,307 lekë dhe janë financuar **16** projekte në vlerën 322,651,089 lekë, ndërsa **4** projekte nuk janë financuar edhe pse janë çelur fondet, nga të cilat: për 1(një) rast është anuluar kontrata, 1(një) rast janë pezulluar punimet për arsye shpronësimi , 1 (një) rast nuk është paraqitur në financë situacion punimesh të kryera , 1 (një) rast është shpronësim që ka mungesë dokumentacioni. Në 1 (një) rast është buxhetuar fondi në vlerën 18,986,134 lekë, për shpronësim por nuk është çelur për arsye se nuk ka përfunduar procedura e shpronësimit.

- Për 40 projekte investimi për të cilat janë lidhur kontratat në vitin 2024, janë buxhetuar për vitin 2024 në vlerën 926,609,658 lekë. Janë çelur fondet në vlerën 622,523,819 lekë dhe janë financuar në vlerën 358,597,437 lekë, ku 6 projekte nuk janë financuar në vlerën 158,858,165 lekë edhe pse janë çelur fondet për to, pasi është vonuar përfundimi i punimeve apo afatet e përfundimit të punimeve shtrihet përtej vitit ushtrimor pasi kontratat janë lidhur me vonesë në muajt e fundit të vitit buxhetor.

- Për 7 projekte investimi të buxhetuar për vitin 2024 në vlerën 112,019,150 lekë, përfunduan me vonesë procedurat e prokurimit, duke u lidhur kontratat në janar 2025 dhe për to janë çelur fonde në vlerën 25,000,000 lekë, ndërsa për 13 projekte investimi të buxhetuar në vlerën 95,752,000 lekë nuk janë kryer procedurat e prokurimit, duke mos i realizuar ato gjatë vitit 2024 pavarësisht se ato janë programuar, gjë që ka sjellë planifikim të investimeve përtej mundësive.

- *Me financim nga Ministritë e linjës janë 3 projekte, si:*

a. Objekti: "Rikonstruksion i Pallatit të Kulturës". Ky projekt është bashkëfinancim ndërmjet Bashkisë Durrës dhe MEKI. Vlera e plotë e projektit është 595,529,187 lekë, ku MEKI financon 278,000,000 lekë në total të shtrira në 2 vite 2024-2025. Vlera e kontratës është 586,451,603 lekë. Për vitin 2025 plani nga MEKI është 55,720,000 lekë dhe realizimi financiar 40,058,952 lekë.

b. Objekti: “Përforcim terreni nga rrëshqitja ne zonën e NJA nr.2, nr.4, Ishëm (VKM nr.260 dt.27.04.2023)” me fond limit 7,987,214 lekë. Për këtë projekt kontrata është lidhur në 3 janar 2024 me vlerë 5,541,743 lekë. Fondi i çelur në thesar për vitin 2024 është 5,541,743 dhe realizimi financiar është 100% , pra 5,541,743 lekë.

c. Objekti: “Pajisje mobilierie arsimit i mesëm i përgjithshëm”, çelur fondi nga Ministria e Arsimit për vitin 2024 në vlerën 3,252,092 lekë, por nuk është financuar , pasi kontrata është lidhur më dt.17.01.2025 me vlerë 1,940,640 lekë.

Për vitin 2024 planifikimi, realizimi i procedurave, zbatimi i kontratave dhe financimi i projekteve të investimeve me burim financimi nga Fondi i Rindërtimit paraqiten sipas Aneksit 6, bashkëlidhur aktit.

Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator liqior/nënliqior dhe përdorimi i tyre.

Për vitin 2023, sipas informacionit të marrë në Drejtorinë Ekonomike, mbi të ardhurat e realizuara dhe mënyrën e përdorimit të tyre, kemi këtë situatë:

Tabela 29. Burimi i krijimit të të ardhurave.

EMERTIMI	VITI 2023		
	PLANI	FAKTI	GJENDJE
Të ardhurat e trashëguara, nga të cilat:	1,572,051	1,555,857	16,194
-Transferta e pakushtëzuar trashëguara	84,486	84,486	-
-Transferta Specifike të trashëguara	71,072	71,072	-
-Të ardhurat e veta	509,319	509,319	-
- Transferta e kushtëzuar(fondet e rindertimit)	907,174	890,980	16,194
- Donacion			
Të ardhurat e vitit ushtrimore, nga të cilat:	6,974,033	4,683,488	2,290,545
-Transferta e pakushtëzuar	1,206,215	1,013,598	192,617
-Transferta specifike	689,665	641,215	48,450
-Të ardhurat e veta	1,479,388	1,227,456	251,932
-Transferta (Fondi i rindertimit)	3,598,765	1,801,219	1,797,546
Transferta kushtëzuar të Vitit ushtrimor, nga të cilat:	1,526,845	1,449,146	77,699
- Nga FZHR	-	-	
- Nga donatore te ndryshëm			
- Nga ministritë e linjës	351,322	317,120	34,202
- Invalit dhe ndihme ekonomike	1,175,523	1,132,026	43,497
TOTALI	10,072,929	7,688,491	2,384,438

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit, përpunuar nga grupi auditimit.

Referuar evidencës së fundviti rakorduar me Degën e thesarit, rezultoi se në total të ardhurat e vitit janë parashikuar në vlerën 10,072,929 mijë lekë, nga e cila janë përdorur gjatë vitit 2023 vlera 7,688,491 mijë lekë dhe nga diferenca prej 2,306,739 mijë shkon e trashëguar në buxhetin e Bashkisë Durrës për vitin 2024 dhe 77,699 mijë lekë i kalojnë buxhetit të Ministrive të linjës.

Në totalin e shpenzimeve me të ardhurat e veta mbulon 22.5%, ku për investime janë në masën 10.6%, për shpenzime operative në masën 5.8% për paga në masën 3.8%, etj. Pra pjesa dërrmuese e të ardhura të veta shkon shpenzime investime, të dhëna të cilat paraqiten në **tabelën B.30, mëposhtëm:**

Tabela B.30. Përdorimit i të ardhurave sipas destinacioneve.

Në 000/lekë

Emërtimi	Fakt 2023				
	Gjithsej	Transferta e pakushtëzuar dhe specifike	Te ardhurat e Veta	Transferta e kushtëzuar (Min. e linjës)	Rindërtimi
600-Paga	1,291,855	962,996	297,258	31,601	
601-Sigurime Shoqërore	212,083	154,972	54,398	2,713	
602-Shpenzime Operative	1,162,324	668,996	449,010	44,318	

Emërtimi	Fakt 2023				
	Gjithsej	Transferta e pakushtëzuar dhe specifike	Te ardhurat e Veta	Transferta e kushtëzuar (Min. e linjës)	Rindërtimi
603-Subvencion		-	-	-	
604 -Transferime korrente te brendshme	84,384		40,030	28,504	15,850
605-Transferta korrente te jashtme		-	-	-	-
606-Transferta Buxh.Fam.Ind	1,469,106	14,897	62,020	1,335,204	56,985
230-Projekte	24,756	6,600	18,156	-	-
231-Investime	3,443,983	1,909	815,904	6,805	2,619,364
SHUMA.....	7,688,491	1,810,371	1,736,775	1,449,146	2,692,199

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit, përpunuar nga grupi auditimit

- Mbulimi me fonde i pagave të punonjësve sipas periudhave:

Në mijë lekë

Emërtimi	Fakt 2023			
	Gjithsej	Tr. Pakushtëzuar dhe Specifike	Te ardhurat e Veta	Transferta e Kushtëzuar
600-Paga	338,334	338,334	-	-
601-Sigurime Shoqërore	55,366	55,366	-	-
Shuma	393,701	393,701	-	-
Në %je				

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat rezultoi se i gjithë fondi i pagave përballohet nga transfertat e pakushtëzuara të buxhetit të shtetit dhe asnjë vlerë nga të ardhurat e veta.

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Bashkinë Durrës jepet nga pasqyrat në vijim:

Në mijë lekë

Emërtimi		Plan	Fakt
Kap.1 (Tr. pakushtëzuar dhe specifike)	600	365,661	338,334
	601	86,923	55,366
	600	-	-
Kap.5(Te ardhurat)	601	-	-

- Për periudhën e aktivitetit të vitit 2024, sipas informacionit të marrë në Drejtorinë Ekonomike, mbi të ardhurat e realizuara për vitin 2024 dhe mënyrën e përdorimit të tyre, kemi këtë situatë:

Tabela 31. Burimi i krijimit të të ardhurave.

EMERTIMI	VITI 2024		
	PLANI	FAKTI	GJENDJE
Të ardhurat e trashëguara, nga të cilat:	2,678,921	2,093,713	585,208
-Transferta e pakushtëzuar trashëguara	192,618	80,673	111,944
-Transferta Specifike të trashëguara	48,450	38,950	9,500
-Të ardhurat e veta	624,114	624,114	0
- Transferta e kushtëzuar(fondet e rindërtimit)	1,813,740	1,349,976	463,764
- Donacion			0
Të ardhurat e vitit ushtrimore, nga të cilat:	4,474,374	3,340,318	1,134,057
-Transferta e pakushtëzuar	1,377,968	1,230,261	147,708
-Transferta specifike	744,161	703,476	40,685
-Të ardhurat e veta	1,641,761	1,149,264	492,497
-Transferta (Fondi i rindërtimit)	710,483	257,317	453,167
Transferta kushtëzuar të Vitit ushtrimor, nga të cilat:	1,471,166	1,436,408	34,758
- Nga FZHR	-	-	-
- Nga donatore te ndryshëm	-	-	-
- Nga ministrinë e linjës	245,939	212,386	33,553

EMERTIMI	VITI 2024		
	PLANI	FAKTI	GJENDJE
- Invalit dhe ndihme ekonomike	1,225,227	1,224,022	1,205
TOTALI	8,624,461	6,870,439	1,754,022

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit, përpunuar nga grupi auditimit.

Referuar evidencës së fundviti rakorduar me Degën e thesarit, rezultoi se në total të ardhurat e vitit janë parashikuar në vlerën 8,624,461 mijë lekë, nga e cila janë përdorur gjatë vitit 2024 vlera prej 6,870,439 mijë lekë dhe nga diferenca prej 1,754,022 mijë lekë, vlera prej 1,719,264 mijë lekë shkon e trashëguar në buxhetin e Bashkisë Durrës për vitin 2024 dhe 34,758 mijë lekë i kalojnë buxhetit të Ministrive të linjës.

Në totalin e shpenzimeve me të ardhurat e veta mbulon 25.8%, ku për investime janë në masën 11.2%, për shpenzime operative në masën 7.7%, për paga dhe sigurime në masën 5.2%, etj. Pra pjesa dërrmuese e të ardhura të veta shkon shpenzime investime, të dhëna të cilat paraqiten në **Tabela 32**, mëposhtëm:

Tabela 32. Përdorimit i të ardhurave sipas destinacioneve.

Në 000/lekë

Emërtimi	Fakt 2024				
	Gjithsej	Transferta e pakushtëzuar dhe specifike	Te ardhurat e Veta	Transferta e kushtëzuar (Min. e linjës)	Rindërtimi
600-Paga	1,429,182	1,104,924	301,573	22,686	0
601-Sigurime Shoqërore	238,677	181,783	53,363	3,531	0
602-Shpenzime Operative	1,300,592	749,283	526,353	24,956	0
603-Subvencion	-	0	0	0	0
604 -Transferime korrente te brendshme	61,161	0	46,064	13,847	1,250
605-Transferta korrente te jashtme	-	0	0	0	0
606-Transferta Buxh.Fam.Ind	1,673,102	17,246	72,752	1,325,788	257,317
230-Projekte	9,616	0	9,616	0	0
231-Investime	2,158,109	124	763,658	45,601	1,348,726
SHUMA.....	6,870,439	2,053,360	1,773,379	1,436,408	1,607,293

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit, përpunuar nga grupi auditimit

Për vitin 2024, numri i punonjësve është përcaktuar me Vendim të KB nr. nr. 195, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024”, paraqitet në **Tabelën B.33**, si vijon:

Tabela B.33- Numri i punonjësve dhe struktura e bashkisë Durrës.

Viti	Buxheti Faktik në 000/lekë	Nr. i drejtorive	Nr. i Sektorëve	Nr. i stafit gjithsej
2024	381,233	14	47	399

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Largimet dhe emërimet e punonjësve nga puna janë paraqitur në **Tabelën B.34**, si vijon:

Tabela B.34- Të dhënat mbi largimet dhe emërimet e punonjësve nga puna:

Periudha	Emërimet e punonjësve				Largimet nga puna					
	Gjithsej	Me kontrate	Me vendim	Me konkurs	Gjithsej	Dorëheqje	Pension	Mbyllje kontrate	Transferime	Procedura
Viti 2024	35	10	-	25	30	13	8	6	-	3

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

- Mbulimi me fonde i pagave të punonjësve sipas periudhave:

Në mijë lekë

Emërtimi	Fakt 2024			
	Gjithsej	Tr. Pakushtëzuar dhe Specifike	Te ardhurat e Veta	Transferta e Kushtëzuar
600-Paga	381,233	355,210	26,023	-
601-Sigurime Shoqërore	64,145	60,304	3,841	-
Shuma	445,377	415,514	29,864	-
Në %je		93	7	

Burimi: Sipas të dhënave të Bashkisë Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat rezultoi se fondi i pagave përballohet nga transfertat e pakushtëzuara të buxhetit të shtetit më masën 93% dhe 7% nga të ardhurat e veta.

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Bashkinë Durrës jepet nga Tabelat në vijim:

Në mijë lekë

Emërtimi		Plan	Fakt
Kap.1 (Tr. pakushtëzuar dhe specifike)	600	384,349	355,210
	601	26,774	26,023
Kap.5(Te ardhurat)	600	64,536	60,304

Si përfundim: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2023 – 2024, rezultoi se:

a. Realizimi i buxhetit për vitin 2023 është në vlerën 7,688,491 mijë lekë, nga vlera 10,072,929 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 76%. Në mos realizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 77% (të bashkisë), e cila ka ardhur nga mos realizimi dhe finalizimi me kontratë i **19 projekteve** të planifikuara në vlerën 197,733,600 lekë, për të cilat nuk janë kryer procedurat e prokurimit, duke mos i realizuar ato gjatë vitit 2023 pavarësisht faktit se ato janë programuar, gjë që ka sjellë planifikim të investimeve përtej mundësive. Ndërsa për 66 projekte të planifikuara, për të cilat janë çelur edhe fondet janë financuar pjesërisht ose nuk janë financuar për arsye të mos mbylljes së punimeve brenda vitit buxhetor nga zhvillimi i procedurave të periudhat e fundvitit dhe lidhja e kontratave me vonesë.

Gjithashtu dhe nga mos realizimi i projekteve të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 të planifikuara janë financuar nga fondet e rindërtimit në masën 61%, ku nga vlera e parashikuar prej 4,505,939 mijë lekë është realizuar vlera 2,692,199 mijë lekë, për shkak të mos përfundimit të punimeve sipas afateve të përcaktuara dhe mos paraqitjes së faturave për likuidim.

- Realizimi i buxhetit për vitin 2024 është në vlerën 6,870,439 mijë lekë nga 8,624,462 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 80%. Në mos realizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 60% (të bashkisë), e cila ka ardhur nga mos realizimi dhe finalizimi i **13 projekteve** të planifikuara në vlerën 95,752,000 lekë, pasi nuk janë kryer procedurat e prokurimit, duke mos i realizuar pavarësisht se ato janë programuar, dhe për **28 projekte** të planifikuara, për të cilat janë çelur edhe fondet janë financuar pjesërisht ose nuk janë financuar për arsye të mos mbylljes së punimeve brenda vitit buxhetor nga lidhja e kontratave me vonesë.

Gjithashtu dhe nga mos realizimi i projekteve të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 të planifikuara, të cilat janë financuar nga fondet e rindërtimit në masën 64%, ku nga vlera e parashikuar prej 2,524,223 mijë lekë është realizuar vlera 1,607,293 mijë lekë, për shkak të mos përfundimit të punimeve sipas afateve të përcaktuara dhe mos paraqitjes së faturave për likuidim.

b. Për vitin 2023, nuk është bërë planifikimi i plote i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura të rezultuara në fund të vitit 2022 në vlerën 110,374,3892 lekë. **Ndërsa për vitin 2024**, ato janë në vlerën 39,606,019 lekë, të cilat nuk janë paraqitur për arkëtim në vitin vijues për faktin se janë detyrime të ish- komunave të cilat nuk kanë dokumentacion të rregullt ligjorë për të mundësuar planifikimin në buxhet pasardhës për likuidim.

c. Financimi i buxhetit vjetor 2023, është bërë në masën më të madhe prej 75.3% nga Buxheti i Shtetit (*transferta e pakushtëzuar, transfertat specifike transferta e kushtëzuar dhe Fondi i Rindërtimit*) dhe 24.6% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat, që siguron njësi vendore nga burimet të tjera. Ndërsa **për vitin 2024**, financimi i buxhetit vjetor është bërë në masën më të madhe prej 74% nga Buxheti i Shtetit (*transferta e pakushtëzuar, transfertat specifike transferta e kushtëzuar dhe Fondi i Rindërtimit*) dhe 26% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat, që siguron njësi vendore nga burimet të tjera.

d. Për vitin 2023, shpenzime për paga (600) janë planifikuar 32% e totalit të shpenzimeve, e ndjekur nga shpenzimet operative (602) në masën 29.6% dhe shpenzimet për investime në masën 25%. Ndërsa **për vitin 2024**, shpenzime për paga (600) janë planifikuar 32.2% e totalit të shpenzimeve, e ndjekur nga shpenzimet për investime në masën 31.2 % dhe shpenzimet operative (602) në masën 27.6%.

Kjo tregon se nga bashkia fondet janë përqendruar më shumë në paga e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të të punësuarave pa bërë asnjë analizë sektoriale mundësi/nevojë, sesa në investime për përmisimin e nevojave të komunitetit në infrastrukturës rrugore, arsim, etj.

e. Në lidhje me mos respektimin e afatit prej 60 ditë të likuidimit të faturave dhe mos likuidimit në vlerën e plotë të tyre, rezultoi se **për vitin 2023**, janë konstatuar papaguar gjithsej **22** fatura me vlerë **200,075** mijë lekë, dhe për **vitin 2024** janë konstatuar **7** fatura me vlerë 130 mijë lekë. Nuk ka fatura të cilat të mos jenë likuiduar në vlerë të plotë në momentin e paraqitjes.

Për aktivitetin e **vitet 2023**, konstatohet se për një pjesë të objekteve të prokuruar megjithëse kanë përfunduar sipas kushteve dhe aftit të kontratave nuk janë paraqitur për likuidim faturat në bashkinë Durrës, duke bërë që situata kreditore në fund të periudhës 2023, të mos jetë ajo që paraqitet, duke mos pasqyruar vlera 87,264 mijë lekë, vlerë e cila i duhet shtuar vlerës 309,915 mijë lekë dhe situata e saktë e faturave të palikujduara në fund të periudhës do duhej të ishte 397,179 mijë lekë, konkretisht tabelën B.23, si vijon

Veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 43 paragrafi 4,47,48,52; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40/h,42; Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3, me Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit” pika 106 dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Nga subjekti audituar Bashkia Durrës, nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projekt raport Auditmit në lidhje me pikën e buxhetit.

Pika 2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

U shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare individuale dhe të konsoliduar për vitin ushtrimor 2023;
- Pasqyrat Financiare individuale të aparatit të Bashkisë Durrës për vitin ushtrimor 2024;
- Ditarët e kontabilitetit për vitin ushtrimor 2023-2024;
- Listë pagesat me zgjedhje për vitin ushtrimor 2023-2024;
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për vitin ushtrimor 2023;
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit Durrës, për vitin ushtrimor 2023-2024;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Tatim-Taksave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, për vitin 2023-2024, u konstatua:

Për vitin 2023-2024 Bashkia Durrës ka hartuar pasqyrat e konsoliduar në të cilat përfshihen aparati i Bashkisë Durrës dhe njësitë shpenzuese. Bashkia Durrës për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

• **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduar.**

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- ☐ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- ☐ Formati nr.2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

• **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.**

Bashkia Durrës për vitin 2023 dhe 2024 ka hartuar pasqyrat financiare të konsoliduar në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 12.

Bashkia Durrës në vitin 2023 duke marrë në konsideratë dhe aparatit e bashkisë përbehet nga 10 njësi shpenzuese, si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Datë depozitimi në thesar	Miraturar	Hartuesi	Konfirmuesi
1	Bashkia Durrës	29.03.2024	09.04.2024	H. H.	G. K.
2	Qendra ekonomike arsimore	27.03.2024	28.03.2024	M. G.	L. M.
3	Ndërmarrja Rruga Durrës	27.03.2024	28.03.2024	E. D.	A. H.
4	Nd/Shërbimeve Komunale	21.03.2024	25.03.2024	L. Xh.	L. H.
5	Ndërmarrja Komunale Plazh	29.03.2024	29.03.2024	G. A.	A. DH.
6	Njësia Ekonomike Biblioteka	29.03.2024	29.03.2024	O. J.	
7	Qendra Kulturore e Fëmijëve	29.03.2024	29.03.2024	E. M.	A. C.

Nr.	Emërtimi	Datë depozitimi në thesar	Miratuar	Hartuesi	Konfirmuesi
8	Klubi Shumë Sporteve "Teuta"	25.03.2024	26.03.2024	G. Sh.	K. L.
9	Qendra Ditore e të Moshuarëve	29.03.2024	29.03.2024	R. Gj.	M. H.
10	Klubi i Futbollit Teuta	29.03.2024	29.03.2024	E. Ç.	E. F.
11	Qendra Kulturore	29.03.2024	29.03.2024	R. S.	E. B.

Pasqyrat Financiare paraqesin informacionin mbi pozicionin financiar të Bashkisë Durrës në fund të periudhës kontabël, për vitin ushtrimor 2023.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë: Aktivet, Detyrimet dhe Kapitali.

Klasifikimi i elementeve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare.

Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse .

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënçërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

Bashkia Durrës në vitin 2023 duke marrë në konsideratë dhe aparatin e bashkisë përbehet nga 10 njësi shpenzuese.

Shënim: Vlerat e mëposhtme të shprehura gjatë raportit të auditimit për periudhën 2023 janë nxjerrë nga Grupi i Auditimit sipas 11 pasqyrave financiare të njëjësive shpenzuese të dorëzuara në Thesar. Për mospërputhjet e vlerave të llogarive kontabël sipas pasqyrave individuale me pasqyrat e konsoliduar do të pasqyrohen në materialin e mëposhtëm.

Shënim: Për vitin 2024 janë audituar vetëm pasqyrat individuale të Bashkisë Durrës për shkak sepse referuar udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022 " Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes ,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pikës 24 "Njësitë e vetëqeverisje vendore brenda muaj prill hartojnë pasqyrat e konsoliduar të cilat i depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të thesarit".

Bashkia Durrës ka depozituar në degën e thesarit Durrës pasqyrat financiare në datën 27.03.2024, të cilat janë miratuara në datën 27.03.2024. Pasqyrat Financiare janë përgatitur nga H. H. në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare të institucionit dhe janë konfirmuar nga zv. Kryetari i Bashkisë Durrës, E. J. cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

• **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për të siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor. Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave.

Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentacionit bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimet, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Durrës për aktivitetin ekonomiko- financiar për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024, të cilat janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

• **Qasja dhe metodologjia e auditimit.**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2023 ka marrë në konsideratë vlerën e materialitetit **78,904 mijë lekë** për shpenzimet dhe për vitin 2024 në vlerën **90,282 lekë** sipas **Pasqyrës** më poshtë:

Përllogaritja e Materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet në Bashkinë Durrës, për vitin ushtrimor 2023, sipas **Aneksit 2.3.1 bashkëlidhur RPA.**

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Bashkisë Durrës në 31.12.2023, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar (F1) 2023.

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=7,369,272,530 lekë.**

- Aktivet 20,551,547,105 lekë
- Detyrimet 13,182,274,575 lekë
- Aktivet Neto 7,369,272,530 lekë

Pasqyra individuale e pozicionit financiar të Bashkisë Durrës në 31.12.2024, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar (F1) 2024.

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=5,465,154,557 lekë.**

- Aktivet 7,305,453,431 lekë
- Detyrimet 1,840,298,874 lekë
- Aktivet Neto 5,465,154,557 lekë

Fondi i Konsoliduar:

Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar/Deficit i akumuluar)

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF1: Detajet e nënrubrikës ‘Teprica’.

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zerat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Pakësimet gjatë vitit	-	1,502,783,713	Çelje
Amortizim i vitit	86,570,959	24,563,073	Investime + Dhurime
		7,123,508	Ndryshim i gjendjes së inventarit
Shuma	86,570,959	1,534,470,294	Shuma
Shuma	86,570,959	1,447,899,335	

Burimi: Bashkia Durrës

Konstatim: Referuar pasqyrës së pozicionit financiar llogaria 101 “Teprica” është kontabilizuar për vlerën 1,431,805,993 lekë.

Sipas tabelës së mësipërme e përlllogaritur dhe sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” vlera e raportuar në bilanc është nënvlerësuar në vlerën 16,093,342 lekë.

Aktivët afatshkurtra:

Aktivët afatshkurta më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **4,989,048,518 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 2,993,991,954 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 222,605,346 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” 1,462,536,074 në shumën lekë.

Pasqyra PF5: Detajet e nënrubrikës “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022
531	Mjete Monetare në arkë		
512	Mjete monetare në bankë	28,883,611	33,982,278
520	Disponibilitete në thesar	2,953,173,056	1,871,865,322
50	Letra me vlerë	161,100	175,100
532	Vlera të tjera	11,774,187	12,867,687
54	Akreditiva dhe paradhënie		
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë		
Totali		2,993,991,954	1,918,890,387

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 2,953,173,056 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” në shumën 2,679,140,148 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” në shumën 274,032,908 lekë.

1-Bashkia Durrës:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të Bashkisë Durrës për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 5,895,344,389 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 3,216,204,241 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 2,679,140,148 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Sipas akt mbajtjet e të ardhurave për vitin 2023 si mëposhtë:

1- *Trasfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2023 e papërdorur 241,285,890 lekë.*

2- *Të ardhurat pa çelur viti 2023 në shumën 372,182,677 lekë.*

3- *Të ardhura të çelura të papërdorura në shumën 251,932,058 lekë.*

4- *Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme rindërtimi viti 2023 në vlerën 1,813,739,523 lekë.*

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 2,679,140,148 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2024.

2-Ndërmarrja Rrugë Durrës:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të Ndërmarrjes së Rrugëve Durrës për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 340,355,779 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 281,075,851 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 4,964,470 lekë e cila nuk kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Diferenca e të ardhurave dhe shpenzimeve 59,279,928 lekë.

3-Ndërmarrja e Shërbimit Komunal Durrës:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të Ndërmarrjes së Shërbimit Komunal Durrës për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 451,089,007 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 454,693,747 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën (3,604,740)lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4-Qendra Ekonomike e Arsimit:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të Qendrës Ekonomike të Arsimit Durrës për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 634,370,051 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 634,370,051 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën (3,604,740)lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

5-Ndërmarrja Komunale Plazh:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të Ndërmarrjes Komunale Plazh për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 214,301,475 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 183,866,943 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 30,434,532 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

6-Biblioteka:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të Bibliotekës për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 19,982,970 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 19,877,004 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 105,966 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

7-Qendra Kulturore e Fëmijëve Durrës:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të qendrës kulturore të fëmijëve Durrës për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 15,046,473lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 14,984,208 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 62,265 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

8-Klubi i Shumë Sporteve “Teuta”:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 84,230,645 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 83,590,250 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 640,395 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

9-Qendra Ditore e të Moshuarëve:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 43,157,245 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 43,159,470 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën (2,225) lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

10-Klubi i Futbollit Teuta:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 31,135,625 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 31,534,900 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën (399,275) lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

11-Qendra Kulturore:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të për vitin 2023 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 49,983,666 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 48,618,693 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 1,364,973 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

• Aktivet afatshkurtra (pasqyra individuale e aparatit):

Aktivët afatshkurta më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën **4,356,224,022 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 2,993,991,954 lekë;

- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 222,605,346 lekë;

- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 1,462,536,074 lekë

Pasqyra PF6: Detajet e nënrubrikës “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llog. kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023
531	Mjete Monetare në arkë		
512	Mjete monetare në bankë		
520	Disponibilitete në thesar	2,948,920,267	3,002,965,220
50	Letra me vlerë		
532	Vlera të tjera		
54	Akreditiva dhe paradhënie		
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë		
	Totali	2,948,920,267	3,002,965,220

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 2,948,920,267 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 2,616,332,323 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 332,587,885 lekë.

1-Bashkia Durrës:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të Bashkisë Durrës për vitin 2024 kemi informacionin si mëposhtë:

Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 8,750,420,057 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 6,134,087,734 lekë).

Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 2,616,332,323 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Sipas akt mbajtjet e të ardhurave për vitin 2024 si mëposhtë:

- 1- *Trasferte e pakushtëzuar dhe specifike viti 2024 e papërdorur 1,037,455,901 lekë.*
- 2- *Të ardhurat të papërdorura viti 2024 në shumën 661,946,250 lekë.*
- 3- *Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme rindërtimi viti 2024 në vlerën 916,930,172 lekë.*

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 2,679,140,148 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2024.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF7: Detajet e nënrubrikës “Gjendje inventari qarkullues”.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
31	Materiale	91,103,681	53,761,808	37,341,873
32	Inventar i imët	93,344,015	84,462,781	8,881,234
33	Prodhim në proces			
34	Produkte	38,157,650	24,245,541	13,912,109
35	Mallra			
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarëve			
	Totali	222,605,346	169,858,114	60,135,216

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

1-Aparati i Bashkisë Durrës:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Durrës në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 14,776,063 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 4,357,915 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 10,418,147 lekë.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas ditarit të bankës u verifikuan disa shpenzime për të cilat u kërkuar dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të gjitha shpenzimet e mëposhtme disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

-Urdhër furnizim hyrje (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë hyrje në magazinë

-Urdhër furnizim shpërndarje sipas kërkesave (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë dalje nga magazine.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën = 5,925,889 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 5,925,889 lekë

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 4,357,915 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF8: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	727,507
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	20,240,110
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	16,609,702
Gjendja në 31.12.2023	4,357,915

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 10,418,147 dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF9: Detajet e llogarisë 327 “*Inventar i imët*”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	8,122,667
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	4,159,765
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	1,864,285
Gjendja në 31.12.2023	10,418,147

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Durrës ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

2-Ndërmarrja Rruga Durrës:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Ndërmarrjes Rruga Durrës në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 55,986,777 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 15,021,555 lekë ,nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 3,998,682 lekë dhe Inventar Dekori në vlerën 36,966,540 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 15,021,555 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF10: Detajet e llogarisë 312 “*Materiale*”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	17,102,821
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	
Gjendja në 31.12.2023	15,021,555

Burimi: Ndërmarrja Rruga Durrës

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 40,965,222 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF10: Detajet e llogarisë 327 “*Inventar i imët*”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	33,919,486
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	
Gjendja në 31.12.2023	40,965,222

Burimi: Ndërmarrja Rruga Durrës

3-Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 39,500,053 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 37,276,828 lekë ,nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 1,032,115 lekë dhe Prodhim në proces në vlerën 1,191,110 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 37,276,828 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF11: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	11,259,239
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	164,207,778
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	137,190,189
Gjendja në 31.12.2023	37,276,828

Burimi: Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 1,032,115 dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF12: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	229,204
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	1,263,734
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	460,822
Gjendja në 31.12.2023	1,032,115

Burimi: Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale

Llogaria 34 “Produkte”, ka vlerën 1,191,110 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 34 “Produkte” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF13: Detajet e llogarisë 34 “Produkte”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	1,791,801
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	7,927,858
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	8,528,549
Gjendja në 31.12.2023	1,191,110

Burimi: Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale

4-Qendra Ekonomike e Arsimit:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Qendrës Ekonomike të Arsimit në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 66,095,059 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 11,211,372 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 54,883,687 lekë

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 11,211,372 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF14: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	7,644,190
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	106,686,982
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	103,119,800
Gjendja në 31.12.2023	11,211,372

Burimi: Qendra Ekonomike e Arsimit

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 54,883,687 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF15: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	50,877,078
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	8,567,767

Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	4,561,158
Gjendja në 31.12.2023	54,883,687

Burimi: Qendra Ekonomike e Arsimit

5-Ndërmarrja Komunale Plazh:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Ndërmarrjes Komunale Plazh në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 32,111,002 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 19,827,614 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 12,283,388 lekë
Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 19,827,614 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF16: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	13,960,601
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	112,302,084
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	106,435,071
Gjendja në 31.12.2023	19,827,614

Burimi: Ndërmarrja Komunale Plazh

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 12,283,388 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF17: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	11,796,962
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	4,332,807
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	3,846,381
Gjendja në 31.12.2023	12,283,388

Burimi: Ndërmarrja Komunale Plazh

6-Biblioteka:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bibliotekës në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 1,157,559 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 293,181 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 864,378 lekë

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 293,181 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF18: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	187,215
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	570,700
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	464,733
Gjendja në 31.12.2023	293,181

Burimi: Biblioteka

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 864,378 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF19: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	864,378
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	-
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	-
Gjendja në 31.12.2023	864,378

Burimi: Biblioteka

7-Qendra Kulturore e Fëmijëve Durrës:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Qendrës Kulturore të Fëmijëve Durrës në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 642,644 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 267,179 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 375,465 lekë

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 267,179 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF20: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	122,644
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	455,996
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	311,461
Gjendja në 31.12.2023	267,179

Burimi: Qendra Kulturore e Fëmijëve

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 375,465 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF21: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	475,735
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	10,000
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	92,270
Gjendja në 31.12.2023	375,465

Burimi: Qendra Kulturore e Fëmijëve

8-Klubi Shumë Sporteve “Teuta”:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Klubi Shumë Sporteve “Teuta” në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 2,501,428 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 1,384,855 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 1,116,573 lekë

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 1,384,855 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF22: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	744,460
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	3,073,290
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	2,432,895
Gjendja në 31.12.2023	1,384,855

Burimi: Klubi Shumë Sporteve Teuta

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 1,116,573 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF23: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	1,116,573
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	-
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	-
Gjendja në 31.12.2023	1,116,573

Burimi: Klubi Shumë Sporteve Teuta

9-Qendra Ditore e të Moshuarëve:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Qendrës Ditore të Moshuarëve në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 563,550 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 0 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 563,550 lekë

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 0lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF24: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	52,650
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	-
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	52,650
Gjendja në 31.12.2023	0

Burimi: Qendra Ditore e të Moshuarëve

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 563,550 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF25: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	513,125
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	50,425
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	0
Gjendja në 31.12.2023	563,550

Burimi: Qendra Ditore e të Moshuarëve

10-Klubi i Futbollit Teuta:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Klubit të Futbollit Teuta në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 1,860,161 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 953,722 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 906,439 lekë

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 953,722 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF26: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	1,126,727
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	2,828,125
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	3,001,130
Gjendja në 31.12.2023	953,722

Burimi: Klubi i Futbollit Teuta

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 906,439 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF27: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	1,132,709
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	570,000
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	796,270
Gjendja në 31.12.2023	906,439

Burimi: Klubi i Futbollit Teuta

11-Qendra Kulturore:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Qendrës Kulturore në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 8,053,694 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 776,638 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 7,277,056 lekë

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 776,638 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF28: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	956,398
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	6,376,395
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	6,556,155
Gjendja në 31.12.2023	776,638

Burimi: Qendra Kulturore

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 7,277,056 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF29: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	5,732,323
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	1,887,320
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	342,587
Gjendja në 31.12.2023	7,277,056

Burimi: Qendra Kulturore

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF30: Detajet e nënrubrikës “Gjendje inventari qarkullues”.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca vitit 2023-2024
31	Materiale	4,940,738	4,357,915	582,823
32	Inventar i imët	16,958,832	10,418,147	6,540,685
33	Prodhim në proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarëve			
Totali		21,899,570	14,776,063	7,123,507

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

1-Aparati i Bashkisë Durrës:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Durrës në 31.12.2024 paraqitet në vlerën 21,899,570 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 4,940,738 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 16,958,832 lekë.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas ditarit të bankës u verifikuan disa shpenzime për të cilat u kërkua dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të gjitha shpenzimet e mëposhtme disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

-Urdhër furnizim hyrje (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë hyrje në magazinë

-Urdhër furnizim shpërndarje sipas kërkesave (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë dalje nga magazine.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën = 7,123,508 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 7,123,508 lekë

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF31: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2024	4,357,915
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2024	-
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	-
Gjendja në 31.12.2024	4,940,738

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 16,958,832 dhe lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF32: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2024	10,418,147
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2024	-
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	-
Gjendja në 31.12.2024	16,958,832

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Titullari i Bashkisë Durrës ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

- **Inventarizimi i aktiveve:**

Gjatë vitit 2023, mbështetur dhe në Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.216 datë 20.06.2023 për ngritjen e komisionit të inventarizimit, dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2023 të Bashkisë Durrës dhe Drejtorinë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.

Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit ka në përbërje: 1-H.R; 2-V.B; 3-E.I; 4-D.K; 5-R.K.

Komisioni për vlerësimin dhe inventarizimi sipas relacionit të mbajtur ka verifikuar se gjendja fizike e inventarëve sipas fletëve të inventarizimit kontabël të hartuara nga financa rezulton i barabartë pa diferenca në plus dhe minus.

Relacioni i drejtuar Titullarit të Institucionit është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit.

Për vitin 2024 nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.311 datë 06.09.2024 për ngritjen e komisionit të inventarizimit, dhe vlerësimit të aktiveve të Njësive Administrative, Policisë Bashkiake, Inspektoratit të Mbrojtjes të Territorit dhe Drejtorinë për Mbrojtjen nga zjarri dhe Shpëtimi.

Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit ka në përbërje: 1-E.L (Kryetar); 2-E.K; 3-I.C; 4-M.T ; 5-G.J.C ; 6-A.M dhe 7- M.XH (Anëtar).

Komisioni për vlerësimin dhe inventarizimi sipas relacionit të mbajtur ka verifikuar se gjendja fizike e inventarëve sipas fletëve të inventarizimit kontabël të hartuara nga financa rezulton i barabartë pa diferenca në plus dhe minus.

Relacioni i drejtuar Titullarit të Institucionit është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme ” & “Të tjera aktive afatshkurtra”:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF33: Detajet e nënrubrikës “Llogari të arkëtueshme”.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022
	Llogari të arkëtueshme		
411	Klientë e llogari te ngjashme	25,733,498	23,383,833
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	1,245,698	1,245,698
431	Tatime e taksa		
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari të pushtetit vendor		
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti		
435	Sigurime Shoqërore		
436	Sigurime Shëndetësore		
437,438	Organizma te tjerë shoqërore		
44	Institucione te tjera publike		
466	Kreditore për mjete ne ruajtje		
468	Debitorë te ndryshëm	1,305,741,348	647,402,797
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	129,815,530	139,967,207
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit		
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
	Totali		
	Të tjera aktive afatshkurtra		
409	Furnitorë (Debitorë),parapagime pagesa pjesore		
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime për t’u shpërndarë në disa ushtrime		
	Totali	1,462,536,074	811,999,535

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

1-Aparati i Bashkisë Durrës:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 635,037,652 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,291,299,993 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2023 ka pasur rritje me vlerë 656,262,341 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, .Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” kemi detyrimet si mëposhtë:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF33: Detajet e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Lloji i Detyrimit	Detyrim 31.12.2022	Shtesa viti 2023	Pakësim viti 2023	Detyrim datë 31.12.2023
Detyrime Familjarë, Biznesi	165,047,159	614,115,113	-	779,162,272
Detyrime nga Drejtoria e Investimeve	69,366,188	8,397,228	-	77,763,416
Detyrime Drejtoria Urbanistikës	143,726,805	-	-	143,726,805
Gjoba IMTV	253,869,500	33,750,000	-	287,619,500

Lloji i Detyrimit	Detyrim 31.12.2022	Shtesa viti 2023	Pakësim viti 2023	Detyrim datë 31.12.2023
Detyrime punonjës ish-komuna	3,028,000	-	-	3,028,000
Shuma	635,037,652	656,262,341	0	1,291,299,993

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, janë kontabilizuar detyrimet duke i grupuar sipas llojit të detyrimit informacioni për debitorë sipas detyrimeve gjendet në tabelën e mësipërme:

-Në grupimin e detyrimeve nga Drejtoria e Investimeve janë detyrimet të cilat janë nxjerrë gjatë auditimeve nga Grupet e Kontrollit të KLSH për punime të pakryera në projekte publike ose detyrime për taksa dhe tarifa vendore të llogaritura jo në përputhje me paketën fiskale përgjatë viteve. Për këto detyrime nga Drejtoria e Financës disponohet listë analitike për subjektet debitoare.

-Detyrimet e kontabilizuara për Drejtorinë e Urbanistikës nga Drejtoria e Financës nuk disponohet listë analitike me debitorët përkatës për detyrimet por detyrimi është i regjistruar si vlerë totale.

-Detyrimet progresive të kontabilizuara për gjobat e IMTV janë në vlerën 253,869,500 lekë. Gjatë vitit 2023 Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit me shkresën nr.986 prot, datë 19.01.2024 ka dërguar informacionin për debitorët për vitin 2023 në Drejtorinë e Financës. Për debitorët para vitit 2023 nuk disponohet listë analitike për detyrimet.

-Detyrimet e punonjësve nga ish-komunat janë detyrimet që janë nxjerrë nga grupet e auditimit përgjatë viteve për të cilët disponohet listë analitike.

-Detyrimet për taksat dhe tarifave vendore për abonentë familjarë dhe biznes në datën 31.12.2022 janë kontabilizuar në vlerën 165,047,159 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në fund të vitit 2023 nuk ka paraqitur informacion në Drejtorinë e Financës për gjendjen e debitorëve progresivë në fund të vitit 2023. Detyrimet për abonentët familjarë dhe biznes janë shtuar gjatë vitit 2023 në vlerën 614,115,113 lekë, kjo shtesë e debitorëve nuk janë debitorë të krijuar gjatë vitit 2023 por nga konstatimi i Grupit të Auditimit është vlera e kontabilizuar e debitorëve në vitin 2022 në shumën 165,047,159 lekë nuk janë debitorët progresive por debitorët e krijuar vetëm në vitin 2022. Vlera progresive e debitorëve në fund të vitit 2022 duhet të ishte kontabilizuar për vlerën e detyrimit 799,162,272 lekë.

Vlera e kontabilizuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” është kontabilizuar pa u kryer një analizë me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për debitorët dhe vlerat përkatëse të tyre referuar dokumentacionit përkatës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 7, pika 1 dhe 2.

2-Qendra Ekonomike e Arsimit:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 12,310,965 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 14,441,355 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2023 ka pasur rritje me vlerë 2,130,390 lekë.

Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” kemi detyrimet si mëposhtë:

Pasqyra PF34: Detajet e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Lloji i Detyrimit	Detyrim 31.12.2022	Shtesa viti 2023	Pakësim viti 2023	Detyrim datë 31.12.2023
Detyrime ushqimore për çerdhe, kopshte	12,310,965	48,354,663	46,224,273	14,441,355
Shuma	12,310,965	48,354,663	46,224,273	14,441,355

Burimi: Qendra Ekonomike e Arsimit

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në pasqyrat e konsoliduara në vlerën 129,815,530 lekë. Referuar udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës gjendja e llogarive të klasës 4 është në vlerën 498,378,655 lekë pasqyruar si mëposhtë:

- Llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”: 54,343,294 lekë.
- Llogaria 421 “Detyrime ndaj personelit” : 84,856,876 lekë.
- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” : 5,183,424 lekë.
- Llogaria 435 “Sigurime Shoqërore” : 25,798,007 lekë.
- Llogaria 436 “Sigurime Shëndetësore” : 6,284,919 lekë.
- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” : 321,912,135 lekë

Sipas analizës së nxjerrë nga grupi i auditimit për llogaritë e klasës 4 (401-408,421,431,435,436,467) referuar pasqyrave individuale të Bashkisë Durrës dhe të Njërive Shpenzuese të dorëzuara në thesar totali i kësaj llogarie është në vlerën 471,150,473 lekë.

- Llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”: 19,567,499 lekë.
- Llogaria 421 “Detyrime ndaj personelit” : 91,768,607 lekë.
- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” : 5,602,084 lekë.
- Llogaria 435 “Sigurime Shoqërore” : 28,174,821 lekë.
- Llogaria 436 “Sigurime Shëndetësore” : 4,125,327 lekë.
- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” : 321,912,135 lekë

Referuar analizës së mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” duhej të paraqitet në pasqyrat e konsoliduara për vlerën 471,150,473 lekë. Kjo llogari është nënvlerësuar për vlerën 27,228,182 lekë. Ky veprim është në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”:

Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës gjendja e llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerë 90,639,938 lekë.

Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit u konstatua se vlera e llogarisë është 126,782,226 lekë. Referuar analizës së mësipërme për llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, e cila është llogari kuadruese për llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” kjo llogari duhet të paraqitet në vlerën 471,150,473 lekë, llogaria është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 380,510,535 lekë. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Llogaritë e Marrëdhënieve me shtetin

Në marrëdhëniet e institucioneve me shtetin përdoren dy llogari specifike dhe karakteristike për sektorin publik buxhetor.

□ Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”

□ Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore,

por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

- ☐ Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “Shpenzime sipas natyrës”;
- ☐ Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42,43,40,e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

- ☐ Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;
- ☐ Kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Në **aneksin nr.1** bashkëlidhur PRA, paraqitet analiza e detajuar e llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin*”.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme ”& “Të tjera aktive afatshkurtra” (pasqyra individuale e Bashkisë Durrës):

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF35: Detajet e nënrubrikës “*Llogari të arkëtueshme*”.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023
	Llogari të arkëtueshme		
411	Klientë e llogari të ngjashme		
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	690,698	690,698
431	Tatime e taksa		
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari të pushtetit vendor		
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti		
435	Sigurime Shoqërore		
436	Sigurime Shëndetësore		
437,438	Organizma të tjerë shoqërore		
44	Institucione të tjera publike		
466	Kreditore për mjete në ruajtje		
468	Debitorë të ndryshëm	1,290,757,993	1,291,299,993
4342	Të tjera operacione me shtetin(të drejta)	54,349,475	39,006,932
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit		
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		
	Totali		
	Të tjera aktive afatshkurtra		
409	Furnitorë (Debitorë),parapagime pagesa pjesore		
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime		
	Totali	1,345,798,166	1,330,997,623

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

1-Aparati i Bashkisë Durrës:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 1,291,299,993 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,290,757,993 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2024 ka pasur rënie vlerë me vlerë 542,000 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët. Nga analiza e **llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”** kemi detyrimet si mëposhtë:

Pasqyra PF36: Detajet e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Lloji i Detyrimit	Detyrim 31.12.2023	Shtesa viti 2024	Pakësim viti 2024	Detyrim datë 31.12.2024
Detyrime Familjarë, Biznesi	779,162,272	-	-	779,162,272
Detyrime nga Drejtoria e Investimeve	77,763,416	-	23,369,549	54,393,867
Detyrime Drejtoria Urbanistikës	143,726,805	-	-	143,726,805
Gjoha IMTV	287,619,500	10,681,000	-	298,300,500
Detyrime punonjës ish-komuna	3,028,000	-	-	3,028,000
Shuma	1,291,299,993	10,681,000	0	1,278,611,444

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2024 paraqitet në pasqyrën individuale të Bashkisë Durrës në vlerën 54,349,475 lekë. Referuar udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhet nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Sipas pasqyrave individuale të Bashkisë Durrës gjendja e llogarive të klasës 4 është në vlerën 93,955,494 lekë pasqyruar si mëposhtë:

-Llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”: 5,065,200 lekë.

-Llogaria 421 “Detyrime ndaj personelit” : 33,598,258 lekë.

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” : 3,785,555 lekë.

-Llogaria 435 “Sigurime Shoqërore” : 10,464,813 lekë.

-Llogaria 436 “Sigurime Shëndetësore” : 1,435,649 lekë.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” : 39,606,019 lekë

Referuar analizës së mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” duhej të paraqitet në pasqyrat e konsoliduara për vlerën 93,955,494 lekë. Kjo llogari është nënvlerësuar për vlerën 44,953,926 lekë. Ky veprim është në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 309,915,144 lekë.

Referuar udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

42. Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në varësi të natyrës së tyre:

☐ “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore”

☐ “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për shërbime”

☐ “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për mirëmbajtje”;

☐ “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për investime”;

☐ “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura të tjera”.

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura të bëhen si më poshtë:

- ☐ Debitohet llogaria përkatëse 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura" dhe
- ☐ Kreditohet llogaria përkatëse 467 "Kreditorë të ndryshëm".

Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme". Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Përfaqësojnë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si p.sh.qera të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara në avancë dhe të tjera.

Referuar ndryshimeve sipas udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithme", paragrafi 42 ndryshon si vijon:

Degët e Thesarit regjistrojnë në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruar sipas pikës 6 (b) të këtij udhëzimi lidhur me detyrimet e prapambetura të njërive të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara për shkak të mungesës së fondeve publike. Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesarit përdorin llogaritë kontabël 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njërive të qeverisjes së përgjithshme. Regjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me keto të fundit.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura" në debi të llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31.12.2021.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM) 2023:

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale", përbëhen nga llog.202 "Studime dhe Kërkime", dhe paraqiten me kosto historike 250,813,498 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 95,527,044 lekë, shtesa gjatë vitit 2023 në vlerën 24,755,995 lekë, amortizim i vitit 2023 në vlerën 19,579,569 lekë dhe vlerë neto në vlerën 135,706,885 lekë. Nga auditimi i llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime" gjatë vitit 2023 janë kontabilizuar në këtë llogari 7 projekte me vlerë 24,770,184 lekë. Për këto projekte procedurat e prokurimit janë kryer gjatë vitit 2021-2022.

Pasqyra PF37:Lista e projekteve të kontabilizuara gjatë vitit 2023:

Nr	Emri	Viti	Shuma
1	Rehabilitimi rrugës Apulia, Daunia, Pelioni, Gentiani	2023	2,105,052
2	Hartim Projekti shkolla Nënë Tereza	2023	4,126,870
3	Projekt për godinat e dëmtuara nga tërmeti	2023	1,610,824
4	Studim projektim për Rikonstrukcion pallati Ramazan Njala	2023	6,600,000
5	Hartim projekt rehabilitimi rrugës "Kasëm Durrësi"	2023	2,600,869
6	Projekt rehabilitimi i rrugës A.Goga	2023	4,615,148
7	Studim projektim për rikonstrukcion Rr. Adria, Stacioni i Trenit- Ura Dajlan	2023	3,097,232
Totali			24,770,184

Burimi:Bashkia Durrës

Llogaria 202 "Studime dhe Kërkime" përbehet nga 41 projekte me kosto historike 250,813,498 lekë dhe vlerë neto 135,706,885 lekë. Regjistri elektronik i vendosur në dispozicion grupit të auditimit për aktivet e llogarisë 202 përmban vitin e kontabilizimit, përshkrimin e aktivitetit dhe koston historike. Drejtoria e Financës Bashkia Durrës nuk disponon një regjistër për aktivet e llogarisë 202 sipas

udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kreu III, “Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” .

30. *Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.*

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF38: Detajet e nënrubrikës “Studime dhe Kërkime”.

Kosto Historike	Amortizim i akumuluar datë 31.12.2022	Shtesa 2023	Amortizim vjetor 2023	Vlera kontabël neto 2023
226,057,503	95,527,044	24,755,995	19,579,569	135,706,885

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Amortizimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” nuk mund të vlerësohet nëqoftëse është në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” sepse referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe regjistrimit të aktiveve në format elektronik kemi vetëm koston historike të aktivitetit. Sipas pasqyrave të konsoliduara vlera e amortizimit të akumuluar është 95,527,044 lekë.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM), (pasqyrat individuale të Bashkisë Durrës 2024):

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 253,440,251 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 131,993,485 lekë, shtesa gjatë vitit 2024 në vlerën 2,626,753 lekë, amortizim i vitit 2024 në vlerën 19,799,023 lekë dhe vlerë neto në vlerën lekë. 114,821,216 Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” gjatë vitit 2024 është kontabilizuar në këtë llogari 1 projekt me vlerë 2,626,753 lekë. Lista e projekteve të kontabilizuara në llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në **Aneksin nr.2** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM) 2023 pasqyrat e konsoliduara:

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës për vitin ushtrimor 2023, paraqiten me tepricë neto 9,690,949,235 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 8,457,729,913 lekë. Gjatë viti 2023 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 130,036,523 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 452,103,192 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 82,104,749 lekë. Pakësimet nga amortizimi gjatë vitit 2023 kanë qenë në vlerën 271,716,109 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 313,440,078 lekë.

Konstatim: Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit AAM për vitin ushtrimor 2023, paraqiten me tepricë neto 12,639,808,415 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 11,669,838,744 lekë. Gjatë viti 2023 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 196,249,224 lekë, shtesa pa pagesë jashtë sistemit janë në shumën 1,216,499,935 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 39,027,822 lekë shtesat kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje , në Bashkinë Durrës dhe NJ.A Administrative. Pakësimet nga amortizimi gjatë vitit 2023

kanë qenë në vlerën 108,200,500 lekë dhe pakësime neto nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 15,274,817 lekë. Referuar analizës së mësipërme vlera neto e klasës 2 “Aktive Afatgjata Materiale” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiarë për vlerën 2,948,859,180 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF39: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale”.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2022	Shtesa 2023	Amortizim 2023	Pakësime neto 2023	Gjendja me 31.12.2023
210	Toka, Troje, Terrene	183,102,409	-	-	-	183,102,409
211	Pyje, Kullota, Plantacione	22,684,643	-	-	-	22,684,643
212	Ndërtime e Konstruksione	2,942,361,698	1,114,309,451	27,630,817	-	3,393,265,051
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	7,540,573,219	76,972,584	-	-	7,617,545,803
214	Instalime dhe paisje	134,142,965	38,872,849	29,142,501	3,448,585	130,534,205
215	Mjete Transporti	204,404,389	115,807,502	41,925,023	11,471,394	244,915,337
217	Gjelbërimi	266,131,632	33,765,000	-	-	299,896,632
218	Inventar Ekonomik	239,630,673	32,329,243	9,502,159	354,838	201,864,336
	Shuma	11,533,031,628	1,412,056,629	108,200,500	15,274,817	12,093,808,416

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Aktivet e afatgjata materiale (AAM) 2024:

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale” Bashkia Durrës (aparati), AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2024, paraqiten me tepricë neto 1,352,300,766 lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,387,510,266 lekë. Gjatë viti 2024 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 24,563,073 lekë, shtesa pa pagesë jashtë sistemit janë në shumën 80,545,116 lekë. Shtesat kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje , në Bashkinë Durrës dhe NJ.A Administrative. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2024 kanë qenë në vlerën 87,070,959 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF40: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale”.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2023	Shtesa 2024	Amortizim 2024	Pakësime neto 2024	Gjendja me 31.12.2024
210	Toka, Troje, Terrene	180,594,841	80,545,116	-	-	261,139,957
211	Pyje, Kullota, Plantacione	-	-	-	-	-
212	Ndërtime e Konstruksione	1,117,692,776	-	55,884,639	-	1,061,808,137
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	-	-	-	-	-
214	Instalime dhe paisje	20,194,726	-	4,038,945	-	16,155,781
215	Mjete Transporti	18,424,267	11,880,000	3,684,853	-	26,619,413
218	Inventar Ekonomik	15,394,157	10,056,320	3,663,499	-	21,786,978
	Shuma	1,352,300,767	102,481,436	67,271,937	-	1,387,510,266

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

1. Llogaria 210 “Toka, troje terrene” (2023) sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës është paraqitur me kosto historike 183,102,409 lekë. Gjatë vitit 2023 llogaria 210 “Toka, troje terrene” nuk ka pasur shtesa. Aktivët e kontabilizuar i përkasin njërive si mëposhtë:

-Bashkia Durrës, 12 aktive me kosto historike 180,594,841 lekë.

-Ndërmarrja e Rrugëve, 1 aktiv me kosto historike 2,507,568 lekë.

Pasqyra PF43: Aktivët e kontabilizuar në llogarinë 210:

Nr Llog	Emërtimi	Lloji i aktivit	Kosto Historike	Vlera neto kontabël 31.12.2023
210	IB Albania Elektronik (Urt)	truall	113,501,372	113,501,372

Nr Llog	Emërtimi	Lloji i aktivitet	Kosto Historike	Vlera neto kontabël 31.12.2023
210	Komuna Rrashbull	truall	1,000,000	1,000,000
210	MZSH	truall	25,056,989	25,056,989
210	Q. shend L. 13	truall	5,723,160	5,723,160
210	Q. shend L. 15	truall	4,795,579	4,795,579
210	Q. shend L. 16	truall	2,343,045	2,343,045
210	Terren Sportiv Manzë	truall	3,898,500	3,898,500
210	Terren Sportiv Manzë Hamallaj	truall	2,082,500	2,082,500
210	Terren Sportiv Rrashbull Xhafzotaj	truall	1,909,500	1,909,500
210	Terren Sportiv Rrashbull Vrrin	truall	2,791,800	2,791,800
210	Terren Sportiv Sukth Hamallaj	truall	12,237,900	12,237,900
210	Terren Sportiv Sukth	truall	5,254,496	5,254,496
210	Gurrë mermeri (Ndërmarrja e Rrugëve)		2,507,568	2,507,568
Total			183,102,409	183,102,409

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Konstatim: Aktiv Gurrë mermeri i regjistruar në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” me kosto historike 2,507,568 lekë është regjistruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Gurrë mermeri janë materiale të cilat duhet të kontabizohen në llogarinë 31 “Materiale”.

1. Llogaria 210 “Toka, troje terrene” (2024) sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës është paraqitur me kosto historike 261,139,957 lekë. Gjatë vitit 2024 llogaria 210 “Toka, troje terrene” ka pasur shtesa për 1 (një) aktiv. Aktivet e kontabilizuara i përkasin njësitë si mëposhtë:

-Bashkia Durrës, 13 aktive me kosto historike 261,139,957 lekë.

Pasqyra PF44: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 210:

Nr Llog	Emërtimi	Lloji i aktivitet	Kosto Historike	Vlera neto kontabël 31.12.2024
210	IB Albania Elektronik (Urt)	Truall	113,501,372	113,501,372
210	Komuna Rrashbull	Truall	1,000,000	1,000,000
210	MZSH	Truall	25,056,989	25,056,989
210	Q. shend L. 13	Truall	5,723,160	5,723,160
210	Q. shend L. 15	Truall	4,795,579	4,795,579
210	Q. shend L. 16	Truall	2,343,045	2,343,045
210	Terren Sportiv Manzë	Truall	3,898,500	3,898,500
210	Terren Sportiv Manzë Hamallaj	Truall	2,082,500	2,082,500
210	Terren Sportiv Rrashbull Xhafzotaj	Truall	1,909,500	1,909,500
210	Terren Sportiv Rrashbull Vrrin	Truall	2,791,800	2,791,800
210	Terren Sportiv Sukth Hamallaj	Truall	12,237,900	12,237,900
210	Terren Sportiv Sukth	Truall	5,254,496	5,254,496
210	Troje parkim publik	Truall	80,545,116	80,545,116
Total			261,139,957	261,139,957

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

2.Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” (2023) sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës është paraqitur me kosto historike 22,684,643 lekë. Gjatë vitit 2023 llogaria 211 nuk ka pasur shtesa. Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 211 “Pyje, Plantacione” janë kontabilizuar në këtë llogari në kundërshtim me nomenklaturën e llogarive kontabël sepse këto aktive janë vepra arti dhe duhet të kontabilizohen në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione”.

Pasqyra PF45: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 211:

Nr Llog	Emërtimi	Viti	Lloji i aktivitet	Kosto Historike	Vlera neto kontabël 31.12.2023
211	Shtatore MJ	2014	Vepër Arti	1,000,000	1,000,000
211	Shtatore T.T+ B.Dilan	2016	Vepër Arti	3,400,000	3,400,000
211	Abstraksion	2016	Vepër Arti	2,300,000	2,300,000
211	Peshkatari në bronz		Vepër Arti	2,300,000	2,300,000
211	Guaska		Vepër Arti	2,115,000	2,115,000
211	Eva në bronz		Vepër Arti	2,300,000	2,300,000
211	Shtatorja Fan Noli		Vepër Arti	1,700,000	1,700,000
211	Balerinat		Vepër Arti	2,300,000	2,300,000
211	Puse		Vepër Arti	1,514,722	1,514,722
211	Puse		Vepër Arti	1,514,722	1,514,722
211	Puse		Vepër Arti	1,514,722	1,514,722
211	Statuja e Barit		Vepër Arti	725,477	725,477
Total				22,684,643	22,684,643

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

2.Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” (2024) sipas të dhënave të pasqyrave financiare individuale të Bashkisë Durrës kjo llogari është paraqitur me kosto historike 0 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari nuk ka pasur shtesa.

3. Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” (2023) sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës për vitin ushtrimor 2023, paraqiten me tepërcë neto 3,916,118,247 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 2,917,996,641 lekë. Gjatë viti 2023 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 130,036,523 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 452,103,192 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 82,104,749 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2023 kanë qenë në vlerën 271,716,109 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 313,440,078 lekë.

Konstatim: Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” për vitin ushtrimor 2023 paraqiten me tepërcë neto 3,939,265,051 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 2,942,361,698 lekë. Gjatë viti 2023 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 482,000 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 1,098,363,484 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën (19,513,911) lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2023 kanë qenë në vlerën 27,630,817 lekë. Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 23,146,804 lekë në kundërshtim me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Analiza e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” është paraqitur në **aneksin nr.3** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Në analizën e mëposhtme do të pasqyrohen aktivet e njërive shpenzuese Bashkia Durrës dhe Qendra Ekonomike Arsimore të cilat kanë vlerat më të larta të aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Referuar pasqyrave individuale të Bashkisë Durrës të depozituar në thesarin Durrës në datën 29.03.2023, llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 1,117,692,776 lekë dhe përbëhet nga 55 aktive, gjatë vitit 2023 nuk ka pasur shtesa në këtë llogari.

Aktivitet e kontabilizuar në llogarinë 212 *Ndërtesa dhe Konstruksione* janë **paraqitur në aneksin nr.4** bashkëlidhur PRA.

Referuar pasqyrave individuale të Qendrës Ekonomike Arsimore të depozituar në thesarin Durrës në datën 28.03.2023, llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 2,520,695,896 lekë dhe përbëhet nga 75 aktive, gjatë vitit 2023 ka pasur shtesa 13 aktive me vlerë kontabël 1,098,363,484 lekë.

Aktivitet e kontabilizuara në llogarinë 212 *Ndërtesa dhe Konstruksione* janë **paraqitur në aneksin nr.5** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Shtesa e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”.

Gjatë vitit 2023 llogaria 212 është shtuar në vlerën 1,114,309,451 lekë. Shtesa e aktiveve i përket 3 ndërmarrjeve shpenzuese si mëposhtë:

1-Qendra Kulturore me vlerë 482,400 lekë.

2-Qendra Ekonomike Arsimore me vlerë 1,098,363,484 lekë.

3-Ndërmarrja Komunale me vlerë 15,463,567 lekë.

Pasqyra PF46: Aktivitet e kontabilizuara në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, qendra ekonomike arsimore:

Nr	Objekti	Vlera Kontabël
1	Ndërtim Shk.9.vjeçare Hamallaj date 11.04.2023	52,237,800
2	Rikonstruksion Kopshti Hasan Koçi date 27.07.2023	9,649,962
3	Rikonstruksion Çerdhe nr.4 date 27.07.2023	9,649,962
4	Ndërtim Shk.9.vjeçare Fshati Rinia date 27.10.2023	62,883,169
5	Rikonstruksion Shk.filllore & parashkolllore Perlat Sukth date 29.12.2023	35,333,373
6	Rikonstruksion Shk.filllore & parashkolllore Njazi Mastori date 29.12.2023	214,666,626
7	Rikonstruksion PLM, date 29.12.2023	12,538,914
8	Rikonstruksion shk.9 vjeçare Isuf Ferra datë 29.12.2023	23,162,838
9	Rikonstruksion shk.9 vjeçare Armath datë 07.11.2023	40,411,799
10	Rikonstruksion/rindërtimi Kopshtit Met Hasa date 29.12.2023	57,748,135
11	Rikonstruksion/rindërtimi Shkolla 9-vj Naim Babametodt.29.12.2023	213,275,000
12	Rikonstruksion/rindërtimi Shkolla 9-vjeçare Qemal Mici dhe kopshti dt.29.12.23	267,330,000
13	Rikonstruksion/rindërtimi Shkolla 9-vjeçare Bedrie Bebeziqi dt.29.12.23	99,475,906
	Totali	1,098,363,484

Burimi: Qendra Arsimore Durrës

3. Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” (2024) sipas të dhënave të pasqyrave financiare individuale të Bashkisë Durrës për vitin ushtrimor 2024, paraqiten me tepriçë neto 1,061,808,137 lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,117,692,776 lekë. Gjatë viti 2024 nuk ka patur shtesë të AAM-ve .Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2024 kanë qenë në vlerën 55,884,639 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 0 lekë.

4. Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës për vitin ushtrimor 2023, paraqiten me tepriçë neto 7,617,545,803 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera kontabël neto e llogarisë 213 “rrugë, rrjete, vepra ujore paraqitet në shumën 7,540,573,219 lekë. Gjatë viti 2023 kemi patur shtesë të llogarisë 213 blerje me pagesë në shumën 76,972,584 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2023 kanë qenë në vlerën 0 lekë. Veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 36

Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi.

Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;

Referuar informacionit analitik të vendosur në dispozicion Grupit të Auditimit në llogarinë 213 janë kontabilizuar kazanët për hedhjen e mbeturinave, kontabilizimi i mësipërm është kryer në kundërshtim me nomenklaturën e planit të llogarive këto aktive duhet të kontabilizohen në llogarinë 214 dhe të amortizohen konform udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018.

5. Llogaria kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune” (2023). Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Durrës. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerë neto kontabël 129,581,074 lekë.

Konstatim: Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit u konstatua se vlera kontabël neto e cila duhet të paraqitet llogaria 214 në pasqyrën e konsoliduar është 144,848,230 lekë. Referuar analizës së mësipërme vlera neto e llogarisë 214 është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiarë për vlerën 15,267,156 lekë.

Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 39,565,379 lekë. Kjo shtesë në llogarinë 214 është përfituar nga blerje me pagesë në shumën 8,498,612 lekë, blerje pa pagesë në vlerën 31,066,767 lekë. Informacioni për ndryshimet e ndodhura në llogarinë 214 gjatë vitit 2023 gjendet në tabelën e mëposhtme.

Pasqyra PF47: Shtesat gjatë vitit 2023 në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit	
1	Bashkia	5,299,800	16,731,450	0	0
2	Ndërmarrja e .Rrugëve	0	692,530	0	0
3	Kultura	542,400	0	0	0
4	Biblioteka	1,015,052	599,207	0	0
5	Klubi Shumë Sportesh	0	0	0	0
6	Ndërmarrja Komunale Plazh	856,800	0	0	0
7	Klubi i Futbollit	0	0	0	0
8	Qendra e të moshuarëve	0	0	411,000	0
9	Qendra Arsimore	784,560	11,732,910	899,670	0
10	Ndërmarrja Komunale	0	0	0	0
11	Qendra kulturore e Fëmijëve	0	0	0	0
Total		8,498,612	29,756,097	1,310,670	-

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Bashkia Durrës gjatë vitit 2023 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit materiale me vlerë 5,299,800 lekë. Blerje pa pagesë gjatë vitit 2023 në Bashkisë Durrës janë në vlerën 16,731,450 lekë. Vlera prej 16,731,450 lekë i përket donacioneve të dhëna nga OJF PNUD për paisje për funksionimin e Drejtorisë së MZHZ.

Gjatë vitit 2023 llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune” është pakësuar për vlerën 26,969,277 lekë. Pakësimi i llogarisë 214 vjen nga procedura e nxjerrjes nga përdorimi për 3 (tre) njësitë shpenzuese sipas tabelës së mëposhtme.

Pasqyra PF48: Pakësimet gjatë vitit 2023 në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”:

Nr	Njësitë Shpenzuese	Pakësimet	
		Kosto Historike	Amortizim
1	Bashkia	0	0
2	Ndërmarrja e .Rrugëve	25,820,971	22,506,461
3	Kultura	0	0
4	Biblioteka	0	0
5	Klubi Shumë Sportesh	0	0
6	Ndërmarrja Komunale Plazh	1,145,126	1,011,051
7	Klubi i Futbollit	0	0
8	Qendra e të moshuarëve	0	0
9	Qendra Arsimore	0	0
10	Ndërmarrja Komunale	0	0
11	Qendra kulturore e Fëmijëve	3,180	3,180
Total		26,969,277	23,520,692

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Analiza e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune*” është paraqitur **në aneksin nr.6** në anekset e projekt raportit të auditimit.

5. Llogaria kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune” (2024). Referuar pasqyrave individuale të Bashkisë Durrës kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Durrës. Sipas pasqyrave financiare individuale të Bashkisë Durrës gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2024 paraqitet me vlerë neto kontabël 16,155,781 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari nuk ka pasur shtesa dhe amortizimi vjetor për këtë llogari është në shumën 4,038,945 lekë.

6. Llogaria 215 “Mjete transporti”. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës gjendja e llogarisë 215 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerë neto kontabël 208,866,597 lekë.

Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit u konstatua se vlera kontabël neto e cila duhet të paraqitet llogaria 215 në pasqyrën e konsoliduar është 244,915,337 lekë .Kjo llogari është e paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 36,048,740 lekë në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat përgatitjes , paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Analiza e llogarisë 215 “*Mjete Transporti*” është paraqitur **në aneksin nr.7** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Bashkia Durrës (2023):

Bashkia Durrës në datën 31.12.2023 disponon 27 mjete me kosto historike 124,675,938 lekë, amortizim të akumuluar në shumën 106,251,671 lekë dhe me vlerë neto kontabël 18,424,267 lekë. Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur shtesa në llogarinë 215 “Mjete Transporti” për aparatën e Bashkisë Durrës. Analiza e llogarisë 215 “*Mjete Transporti*” vetëm për aparatën e Bashkisë Durrës është paraqitur **në aneksin nr.8** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Bashkia Durrës (2024):

Bashkia Durrës në datën 31.12.2024 disponon 28 mjete me kosto historike 136,555,938 lekë, amortizim të akumuluar në shumën 109,936,525 lekë dhe me vlerë neto kontabël 26,619,413 lekë. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në llogarinë 215 “Mjete Transporti” për aparatën e Bashkisë Durrës mjet zjarrfikës i cili është blere me procedurë prokurimi nga Bashkia Durrës. Gjithashtu gjatë 2024 nuk ka pasur lëvizje të mjeteve në

Pasqyra PF49: Mjetet e Transportit të Bashkisë Durrës:

Nr.	Drejtoria	Emërtimi	Viti	Vlera
1	PMNZH	Ranger (6FPPXXMJ2PPU11046) Mjet I vogel Pic Ëp zjarrfikës	2024	11,880,000
Total				11,880,000

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Gjatë vitit 2023 kjo llogari 215 “Mjete Transporti” ka pasur shtesa në vlerën 115,807,502 lekë. Kjo shtesë në llogarinë 215 është përfituar nga blerje me pagesë në shumën 70,094,000 lekë, blerje pa pagesë në vlerën 27,841,584 lekë dhe lëvizje të aktiveve në vlerën 17,871,118 lekë. Informacioni për ndryshimet e ndodhura në llogarinë 215 gjatë vitit 2023 gjendet në tabelën e mëposhtme.

Pasqyra PF50: Shtesat gjatë vitit 2023 në llogarinë 215 “Mjete Transporti”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit	
1	Bashkia	0	0	0	0
2	Ndërmarrja e .Rrugëve	42,428,000	0	7,200,000	0
3	Kultura	0	0	0	0
4	Biblioteka	0	0	0	0
5	Klubi Shumë Sportesh	0	0	0	0
6	Ndërmarrja Komunale Plazh	0	0	20,641,584	0
7	Klubi i Futbollit	0	0	0	0
8	Qendra e të moshuarëve	0	0	0	0
9	Qendra Arsimore	0	0	0	0
10	Ndërmarrja Komunale	26,666,800	0	0	17,871,118
11	Qendra kulturore e Fëmijëve	0	0	0	0
Total		70,094,800		27,841,584	17,871,118

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Ndërmarrja e Rrugëve në fund të vitit 2023 posedon 39 mjete me kosto historike 179,091,938 lekë, amortizim të akumuluar në vlerën 85,168,880 lekë dhe me vlerë neto kontabël 93,923,058 lekë. Ndërmarrja e Rrugëve gjatë vitit 2023 ka blerë 3 mjete me vlerën 43,428,000 lekë dhe 1 mjet me vlerë 7,200,000 lekë është transferuar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale.

Pasqyra PF51: Shtesat gjatë vitit 2023 në llogarinë 215 “Mjete Transporti” Ndërmarrja e Rrugëve:

Nr	Llogaria	Mjeti	Vlera Fillestare	Amortizimi	Vlera Neto
1	215	Eskavator Shantui	37,788,000	1,259,600	36,528,400
2	215	Automjet Daimler Chrystel AB562BP	2,640,000	88,000	2,552,000
3	215	Autmjet tip DAF AB885JM	3,000,000	100,000	2,900,000
4	215	Auto Fshesë nga NSHK 2023	7,200,000	240,000	6,960,000
Total			50,628,000	1,687,600	48,940,400

Gjatë vitit 2023 llogaria 215 “Mjete Transporti” është pakësuar për vlerën 26,969,277 lekë. Pakësimi i llogarisë 214 vjen nga procedura e inventarizimit nga 3 njësitë shpenzuese sipas tabelës së mëposhtme.

Pasqyra PF52: Pakësimet gjatë vitit 2023 në llogarinë 215 “Mjete Transporti”:

Nr	Njësitë Shpenzuese	Pakësimet	
		Kosto Historike	Amortizim
1	Bashkia	0	0
2	Ndërmarrja e .Rrugëve	27,726,687	24,095,293
3	Kultura	0	0
4	Biblioteka	0	0
5	Klubi Shumë Sportesh	0	0
6	Ndërmarrja Komunale Plazh	7,840,000	0
7	Klubi i Futbollit	0	0
8	Qendra e të moshuarëve	0	0
9	Qendra Arsimore	0	0
10	Ndërmarrja Komunale	0	0
11	Qendra kulturore e Fëmijëve	0	0
Total		35,566,687	24,095,293

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria kontabël 216 “Rezervë shtetërore”, është pasqyruar në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar për vlerën 36,987,524 lekë. Referuar pasqyrave individuale të pozicionit financiar të 11 njësive kjo llogari është paraqitur me vlerë 0 lekë. Regjistrimi i llogarisë 216 “Rezervë shtetërore” është kryer në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat përgatitjes , paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Kontabilizimi i mësipërm ka sjell mbivlerësimin e llogarisë 216 “Rezervë shtetërore” për vlerën 36,987,524 lekë.

Llogaria kontabël 217 “Kafshë pune dhe Prodhimi”, është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në datë 31.12.2022 në vlerën 266,131,632 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari është shtuar për vlerën 33,765,000 lekë. Në datën 31.12.2023 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 299,896,317 lekë. Referuar përmbledhësës së vendosur në dispozicion në këtë llogari janë kontabilizuar pemë të llojeve të ndryshme. Vlera e kontabilizuar në këtë llogari nuk i plotësojnë kushtet e kontabilizimit të aktiveve. Pemët e kontabilizuar në këtë llogari janë asete të cilat fillimisht duhet të hynë në magazinë si materiale në llogarinë 31 “Materiale” dhe më pas ti bashkohen vlerës së aktivitetit përkatës në llogaritë e klasës 2. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat përgatitjes , paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Gjithashtu kjo llogari është regjistruar në kundërshtim me nomenklaturën e planit të llogarive sepse llogaria 217 i përket aktiveve “Kafshë pune dhe prodhimi”.

7. Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Durrës. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerë neto kontabël 200,938,270 lekë.

Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit u konstatua se vlera kontabël neto e cila duhet të paraqitet llogaria 218 në pasqyrën e konsoliduar është 241,386,955 lekë. Kjo llogari është e paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 40,448,685 lekë në

kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat përgatitjes , paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 32,329,243 lekë. Kjo shtesë në llogarinë 218 është përfituar nga blerje me pagesë në shumën 5,223,350 lekë, blerje pa pagesë në vlerën 25,463,100 lekë dhe lëvizje të aktiveve në vlerën 1,642,793 lekë. Informacioni për ndryshimet e ndodhura në llogarinë 218 gjatë vitit 2023 gjendet në tabelën e mëposhtme.

Pasqyra PF53: Shtesat gjatë vitit 2023 në llogarinë 218 “Inventar Ekonomik”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit	
1	Bashkia	3,699,000	400,000	0	0
2	Ndërmarrja e .Rrugëve	0	0	0	0
3	Kultura	855,600	0	0	0
4	Biblioteka	0	0	0	0
5	Klubi Shumë Sportesh	118,500	0	50,000	0
6	Ndërmarrja Komunale Plazh	163,250	0	0	0
7	Klubi i Futbollit	0	0	0	0
8	Qendra e të moshuarëve	0	0	0	0
9	Qendra Arsimore	0	795,500	24,217,600	0
10	Ndërmarrja Komunale	386,400	0	0	1,642,793
11	Qendra kulturore e Fëmijëve	0	0	0	0
Total		5,223,350	1,195,500	24,267,600	1,642,793

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Gjatë vitit 2023 llogaria 218 “Inventar Ekonomik” është pakësuar për vlerën 1,810,339 lekë. Pakësimi i llogarisë 218 vjen nga procedura e nxjerrjes nga përdorimi e 3 njësive shpenzuese sipas tabelës së mëposhtme.

Pasqyra PF54: Pakësimet gjatë vitit 2023 në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”:

Nr	Njësitë Shpenzuese	Pakësimet	
		Kosto Historike	Amortizim
1	Bashkia	0	0
2	Ndërmarrja e .Rrugëve	0	0
3	Kultura	627,248	417,856
4	Biblioteka	0	0
5	Klubi Shumë Sportesh	0	0
6	Ndërmarrja Komunale Plazh	141,300	0
7	Klubi i Futbollit	0	0
8	Qendra e të moshuarëve	0	0
9	Qendra Arsimore	0	0
10	Ndërmarrja Komunale	0	0
11	Qendra kulturore e Fëmijëve	1,041,791	1,037,645
Total		1,810,339	1,455,501

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Analiza e llogarisë 218 “*Inventar Ekonomik*” është paraqitur në **aneksin nr.9** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Aktivet Afatgjata Financiare

Llogaria 26 Pjesëmarrje në kapitalin e vet rezultojnë në fund të vitit 2023 dhe 2024 është regjistruar në vlerën 0 lekë.

-Bashkia Durrës në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 32.47 % të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës” sh.a me NUIS M22031502M e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”.

Numri i aksioneve është 32,468 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,246,800lekë.

Vlera e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit në asnjë rast nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2023 dhe 2024, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje”.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël 3,246,800 lekë dhe investitori është Bashkia Durrës.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivët Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në Pjesëmarrje me vlerë kontabël 3,246,800 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

Investimet:

Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës për vitin ushtrimor 2023, paraqiten me tepriçë neto 2,654,791 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera e llogarisë 231 paraqitet në shumën 2,851,347,683 lekë.

Konstatim: Sipas të dhënave të përpunuara nga grupi i auditimit gjatë vitit 2023 kanë qenë aktiv 25 projekte rindërtimi të financuara nga transfertat e kushtëzuar të rindërtimit. Vlera totale për 25 projektet është 5,517,905,369 lekë. Gjatë vitit 2023 për këto projekte është likuiduar shuma 2,073,490,011 lekë. Vlera progresive e likuidimeve për kontratat e rindërtimit është në shumën 3,551,987,098 lekë.

Lista e investimeve në proces (kontratat e rindërtimit) gjenden në **aneksin nr. 10** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Gjatë vitit 2023 kanë përfunduar 6 projekte rindërtimi me vlerë kontratë 819,326,061 lekë. Lista analitike e projekteve të përfunduara gjendet në tabelën mëposhtë.

Pasqyra PF55: Detajet e nënrubrikës “*Investimet*” kontratat e mbyllura rindërtimi.

Nr	Projekti në proces	Operatori	Vlera e kontratës	Vlere likuiduar 2023	Total Pagesa
1	Loti 1: Rikonstruksioni dhe riparimi I mjediseve ne bashkëpronësi ose te përbashkëta ne ndërtesa (pallat) Bashkia Dures njësite Administrative nr. 1,2,3,4,5, Sukth ,Manzez	E. O Shpk	176,327,975	52,521,325	176,327,975
2	Loti 2: Rikonstruksioni dhe riparimi I mjediseve ne bashkëpronësi ose te përbashkëta ne ndërtesa	R.N.	206,840,256	11,492,289	206,840,247

Nr	Projekti në proces	Operatori	Vlera e kontratës	Vlere likujduar 2023	Total Pagesa
	(pallat) Bashkia Durrës njesite Administrative nr.5 dhe Rrashbull				
3	Riforcim I godines se banimit 8 kate+bodrum, lagja nr.3 , Rruga Egnatia kod GIS 27258	T.	23,183,046	23,183,046	23,183,046
4	Riforcim godinë banimi 12 kate mbi tokë dhe një kat nëntoke, Rruga “Neki Libohova”, nr.70, kod GIS 5061, 5063	E.B Shpk/ L....N	204,334,356	150,625,732	204,492,514
5	Riforcimi pallateve me kod gis: 7339, 23247 dhe riforcimi banesave individuale ne Njesine Administrative Ishëm te banoreve : Albana Beja, Altlin Koka, Shaban Kurti	V.N Shpk	78,610,873	19,083,701	78,374,063
6	Riforcim pallatit me kode gis 1023,1025	I.I	94,700,423	15,129,107	94,700,377
7	Riforcim godine banimi 10-11 kate mbi toke dhe një kat nentok, rruga "Neki Libohova" nr.15, rruga "Abaz Celkupa" nr.26, kdo GIS 24907, 24923, Faza II	R.N. Shpk	35,329,132	35,329,132	35,329,132
Total			819,326,061	307,364,332	819,326,061

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Investimet të cilat janë mbyllur dhe kolauduar gjatë vitit 2023 në kuadër të procesit të rindërtimit, janë aktive të cilat nuk janë në pronësi të Bashkisë Durrës, por janë aktive në pronësi të popullatë dhe në të cilat janë kryer rikonstrukcion në varësi të dëmtimit të cilat kanë pësuar nga tërmeti. Këto investime nuk kontabilizohen në klasën 2 të aktivitetit.

Konstatim: Referuar të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Durrës për vitin 2023 llogaria 231 “Investime” është pasqyruar në vlerën 2,654,791,631 lekë. Referuar të dhënave të nga pasqyrat individuale llogaria 231 “Investime” është paraqitur në vlerën 2,636,289,778 lekë. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave individuale u konkludua se kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 96,371,259 lekë. Kjo llogari duhet të kontabilizohet për vlerën 2,732,661,037 lekë shumë e cila i përket 16 projekteve të investimeve.

Investimet:

Sipas të dhënave të pasqyrave financiare individuale të Bashkisë Durrës për vitin ushtrimor 2024, paraqiten me teprice neto 1,417,016,241 lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera e llogarisë 231 paraqitet në shumën 2,636,289,728 lekë.

Lista analitike e projekteve në proces është paraqitur **në aneksin nr.11 dhe nr.12** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Në fund të vitit 2024 për rindërtimin janë 10 kontrata në proces me vlerë të mbetur 783,625,873 lekë. Lista analitike e projekteve në proces (kontratat e rindërtimit) është paraqitur **në aneksin nr.13** në anekset e projekt raportit të auditimit.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Durrës më datë 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Pasqyra PF56: Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.

Llogaritë		Viti 2023
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	54,343,294
42	Detyrime ndaj personelit	84,856,876
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	5,183,424
432	Tatime mbledhur për llogari të pushtet lokal	362,922
435	Sigurime shoqërore	25,798,007
436	Sigurime shëndetësore	6,284,919
467	Kreditor të ndryshëm	321,912,135

Burimi: Bashkia Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit..

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31.12.2023 për vlerën 54,343,294 lekë.

Referuar pasqyrave individuale të njësive shpenzuese në Bashkinë Durrës kemi të dhënat si mëposhtë:

Pasqyra PF57: Detajet e nënrubrikës “401-408”.

Llogaria	Institucioni	Shuma
401-408	Bashkia Durrës	-
401-408	Ndërmarrja Rruga	18,804,722
401-408	Kultura	-
401-408	Biblioteka	-
401-408	Shumë Sportesh	-
401-408	Komunale Plazh	262,972
401-408	Klubi i futbollit Teuta	-
401-408	Qendra Ditore e të Moshuarëve	27,504
401-408	Qendra Ekonomike Arsimore	87,174
401-408	Ndërmarrja Komunale	369,754
Totali		19,552,126

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Nga analiza e mësipërme rezultoi se llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” në pasqyrat financiare të konsoliduara është paraqitur për vlerën 54,343,294 lekë nga auditimi i pasqyrave individuale të njësive shpenzuese të Bashkisë Durrës rezultoi se llogaria 401-408

“Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 34,791,168 lekë. Kjo llogari duhet të paraqitet në vlerën 19,552,126 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 5 , datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat përgatitjes , paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (Bashkia Durrës 2024):

Referuar të dhënave të pasqyrave individuale të Bashkisë Durrës për vitin 2024 llogaria “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” është paraqitur në vlerën 5,065,200 lekë. Kjo vlerë detyrimi i përket 1 (një) fature e cila është e periudhës nëntor-dhjetor veshje policia bashkiake.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Durrës, paraqitet në vlerën 84,856,876 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar në muajin janar 2024

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 5,185,424 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 25,798,007 lekë dhe 6,284,919 lekë.

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar të Bashkisë Durrës, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 274,032,008 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit. Vlera e kontabilizuar në llogarinë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” i përket njësive shpenzuese si mëposhtë:

Pasqyra PF58: Detajet e nënrubrikës “466”.

Llogaria	Institucioni	Shuma
466	Bashkia Durrës	268,836,706
466	Ndërmarrja Rrugë	-
466	Kultura	-
466	Biblioteka	-
466	Shumë Sportesh	-
466	Komunale Plazh	-
466	Klubi i futbollit Teuta	-
466	Qendra Ditore e të Moshuarëve	-
466	Qendra Ekonomike Arsimore	5,096,202
466	Ndërmarrja Komunale	-
Totali		274,032,908

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” (Bashkia Durrës) viti 2024: Referuar pasqyrës individuale të pozicionit financiar për Bashkinë Durrës kjo llogari është regjistruar për vlerën 332,587,885 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2024, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë e të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes janë paraqitur **në Aneksin nr.14** bashkëlidhur PRA.

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 86,728,364 lekë, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

Sistemi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50, ku përcaktohet:

Pika 30: “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50: “Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditore për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”.

Udhëzimi i KM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10 ku përcaktohet:

Pika 10: “Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.”

Llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduara të Bashkisë Durrës, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 309,915,144 lekë dhe në fund të vitit 2024 pasqyrat individuale të pozicionit financiar Bashkia Durrës paraqiten në vlerën 39,606,919 lekë.

Pasqyra PF59: Detajet e nënrubrikës “Kreditorë të ndryshëm”

Llogaria	Viti 2024	Viti 2023
467 “Kreditorë të ndryshëm”	39,606,919	309,915,144
Total	39,606,919	309,915,144

Burimi : Bashkia Durrës

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancën financiare” të PF të vitit 2023-2024 paraqiten të analizuar si mëposhtë.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 5,895,344,389 lekë dhe për vitin 2024 janë në vlerën 8,750,420,057 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Durrës paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 1,165,331,842 lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 1,399,254,252, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 4,425,961 lekë dhe për vitin 2024 janë në vlerën 4,821,518 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 361,861,385 lekë dhe për vitin 2024 janë në vlerën 513,103,933 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 799,044,496 lekë dhe për vitin 2024 janë në vlerën 881,328,801 lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 432,671,489 lekë dhe për vitin 2024 janë në vlerën 627,357,645, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 35,691,126 lekë dhe për vitin 2024 janë në vlerën 41754,180, e cila përfshin, *taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet*, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 396,980,363 lekë dhe për vitin 2024 janë në vlerën 585,603,465 lekë. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 3,216,204,241 lekë dhe për vitin 2024 janë në vlerën 6,134,087,734 paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 410,362,944 lekë dhe për vitin 2024 paraqiten në vlerën 454,486,148 lekë, sipas akt-rakordimit me thesarin për vitin 2024 nuk ka diferenca.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 64,880,463 lekë dhe për vitin 2024 janë në vlerën 76,120,477, sipas akt-rakordimit me thesarin për vitin 2024, nuk ka diferenca.

- Gjendja e llogarisë **602 ‘Blerje mallra e shërbime’** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 486,663,373 lekë dhe për vitin 2024 janë në vlerën 628,498,858 sipas akt-rakordimit me thesarin për vitin 2024 janë në vlerën 628,498,858 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 ‘Transferime për Buxhetet familjare e Individë’** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 1,385,953,214 lekë, dhe për vitin 2024 janë në vlerën 1,608,517,533 lekë, sipas akt-rakordimit me thesarin për vitin 2024 nuk ka pasur diferenca.

Për vitin 2023 totali i te ardhurave në vlerë është 5,895,344,389 lekë dhe totali shpenzimeve është 3,216,204,241 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 2,679,140,148 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Për vitin 2024 totali i te ardhurave në vlerë është 8,750,420,057 lekë dhe totali shpenzimeve është 6,134,087,734 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 2,616,332,323 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

• **Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Durrës).**

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Referuar kërkesave të VKM nr.177, datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Durrës është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2023 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës E. L dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga zv.Kryetari Bashkisë. Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Drejtori i Burimeve Njerëzore DH. GJ

Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2023-2024.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2023-2024) dhe konstatohet se ato plotësohen sipas rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Durrës, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Durrës, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2023-2024)konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës E. L dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës E. L dhe nga zv. Kryetari Bashkisë Durrës.

Tabela e burimit të Financimit të pagave paraqitet në **Pasqyrën PF60** më poshtë:

000/lekë

Viti	Llogaria	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
					Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transferte specifike
2023	600	432,531	397,810		336,235	0	18,796	42,779
2023	601	71,575	64,880		54,851	0	2,714	7,315
2024	600	486,792	451,895		352,075	26,022	22,686	51,112
2024	601	82,149	76,032		59,734	3,841	3531	8,926

Burimi: Bashkia Durrës

- **Auditimi i shpenzimeve sipas kontratës së pastrimit.**

Grupi i Auditimit verifikoi pagesat e kryera nga thesari për pagesat e kryera gjate vitit 2023 për depozitim e mbetjeve në vendgrumbullimin e mbetjeve në Sharrë. Gjatë vitit 2023, Bashkia Durrës ka kryera pagesa nëpërmjet thesarit Durrës shumën 261,584,340 lekë. Nga këto pagesa detyrime për vitin 2022 janë në vlerën 25,674,983 lekë të cilat i përkasin periudhës nëntor-dhjetor 2022. Pagesa të cilat i përkasin vitit 2023 janë në shumën 235,909,357 lekë dhe i përkasin periudhës janar-tetor 2023.

Pasqyra PF61: Tabela e likuidimit për depozitim e mbetjeve paraqitet në më poshtë:

Nr	Data	Faturimi i Shërbimit	Shuma e Faturës
1	02.02.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion muaji dhjetor 2022	22,089,728
2	07.03.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion muaji janar 2023	20,927,195
3	21.03.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane pagese pjesore e nëntorit 2022	3,585,255
4	24.03.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion muaji shkurt 2023	16,670,233
5	09.05.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion muaji mars 2023	20,396,832
6	30.05.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion muaji prill 2023	20,950,969
7	17.07.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion muaji maj 2023	23,022,819
8	16.08.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion muaji qershor 2023	25,691,126
9	08.09.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion muaji korrik 2023	31,212,513
10	12.10.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion muaji gusht 2023	33,798,200
11	28.12.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion muaji shtator 2023	24,876,707
12	29.12.2023	I.....E..... depozitim i mbetjeve urbane situacion tetor 2023 diference fature	18,362,763
Total			261,584,340

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar pagesave të mësipërme Grupi i Auditimit ka përzgjedhur muaj gusht 2023 për auditim. Bashkia Durrës ka nënshkruar kontratën kuadër më I.....E..... me datë 08.10.2021 me objekt shërbimet për depozitim e mbetjeve urbane të Bashkisë Durrës me fond limit 1,148,864,000 lekë pa tvsh për një afat deri në 4 vjet nga data e lidhjes së saj. Për vitin 2023, Bashkia Durrës ka lidhur kontratën me nr.101/81 prot, datë 28.10.2022.

Me urdhër nr.22, datë 18.01.2022 të Titullarit të Institucionit është ngritur grupi i punës për mbikëqyrjen e marrëveshjes kuadër nr.9853/7, datë 08.10.2021 me objekt depozitimi i mbetjeve urbane Bashkia Durrës.

Përbërja e Grupi të Punës: 1-F.A (Kryetar); 2-K.D (Anëtar); 3-E.K (Anëtar)

Me urdhrin nr.234, datë 10.05.2022, të Titullari të Institucionit është ndryshuar grupi i punës për mbikëqyrjen e marrëveshjes kuadër nr.9853/7, datë 08.10.2021 me objekt depozitimi i mbetjeve urbane Bashkia Durrës.

Përbërja e Grupi të Punës: 1-F.A (Kryetar); 2-E.K(Anëtar); 3-E.K (Anëtar)

Referuar marrëveshjes kuadër nr.9853/7, datë 08.10.2021 me objekt depozitimi i mbetjeve urbane Bashkia Durrës mjetet të cilat do të depozitohen mbetjet në landfillin e Sharrës duhet të konfirmohen nga subjekti kontraktor çdo fillim viti dhe për ndryshimet e mjeteve do të duhet të përcillet informacion.

Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale me shkresën nr.57 prot, datë 17.01.2023 ka dërguar listën e mjeteve të autorizuar për depozitimin e mbajtjeve në landfillin e Sharrës. Sipas tabelës së mëposhtme gjenden mjetet e NSHK dhe shoqërive sipërmarrëse “A” Grup dhe “R” shpk të kontraktuara për pastrimin e njësive Ishëm dhe Sukth.

Tabela e mjeteve të autorizuar nga NSHK për depozitimin e mbetjeve paraqitet në **Pasqyrën PF62** më poshtë:

Nr	Tipi i mjetit	Ndërmarrja
1	Agregat Dafi	NSHK
2	Agregat Iveko	NSHK
3	Agregat Skania	NSHK
4	Agregat Benz	NSHK
5	Agregat Iveco	NSHK
6	Agregat Iveco	NSHK
7	Agregat Iveco	NSHK
8	Agregat Iveco	NSHK
10	Kamion	NSHK
11	Kamion	NSHK
12	Kamion	NSHK
13	Kamion	NSHK
14	Kamion	NSHK
15	Kamion	NSHK
16	Kamion	Ndërmarrja e Rugëve
17	Kamion	Ndërmarrja e Rugëve
18	Agregat Skania	A Grup
19	Agregat Skania	A Grup
20	Agregat Skania	A Grup
21	Agregat Renault	R Shpk
22	Agregat Renault	R Shpk
23	Agregat Renault	R Shpk
24	Agregat Renault	R Shpk

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Autorizim datë 13.02.2023 për shtim mjeti i kompanisë “R” shpk për depozitim mjeteve në landfillin e Sharrës

Nr	Tipi i mjetit	Ndërmarrja
1	Agregat	SUKTH

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Autorizim datë 08.03.2023 për shtim mjeteve Ndërmarrja Komunale Plazh për depozitim mjeteve në landfillin e Sharrës

Nr	Tipi i mjetit	Ndërmarrja
1	Kamion vetëshkarkues	N.K.PLAZH
2	Kamion vetëshkarkues	N.K.PLAZH

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Autorizim datë 04.07.2023 për shtim mjeteve Ndërmarrja Komunale Plazh dhe “R” shpk për depozitim mjeteve në landfillin e Sharrës.

Nr	Tipi i mjetit	Ndërmarrja
1	Kamion vetëshkarkues	N.K.PLAZH
2	Kamion agregat	R Shpk

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Tabela e mjeteve të autorizuar nga NSHK (plazh) për depozitim të mbetjeve paraqitet në **Pasqyrën PF63** më poshtë:

Nr	Tipi i mjetit	Ndërmarrja
1	Kamion teknologjik për kazanë	N.K.PLAZH
2	Kamion teknologjik për kazanë	N.K.PLAZH
3	Kamion teknologjik për kazanë	N.K.PLAZH
4	Kamion vetëshkarkues	N.K.PLAZH
5	Kamion vetëshkarkues	N.K.PLAZH
6	Kamion vetëshkarkues	N.K.PLAZH
7	Kamion vetëshkarkues	N.K.PLAZH
8	Kamion teknologjik për kazanë	N.K.PLAZH
9	Kamion vetëshkarkues	N.K.PLAZH
10	Kamion teknologjik për kazanë	N.K.PLAZH
11	Kamion vetëshkarkues	N.K.PLAZH
12	Kamion teknologjik për kazanë	N.K.PLAZH

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Tabela e mjeteve të kompanisë “F.” për depozitim të mbetjeve paraqitet në **Pasqyrën PF64** më poshtë:

Nr	Tipi i mjetit	Ndërmarrja
1	Kompatator Iveco	Kompania F
2	Kompatator Iveco	Kompania F
3	Kompatator Iveco	Kompania F
4	Kompatator Skania	Kompania F
5	Kompatator Skania	Kompania F
6	Kompatator Skania	Kompania F
7	Kompatator Skania	Kompania F
8	Kompatator Skania	Kompania F
9	Kompatator Skania	Kompania F
10	Kompatator Skania	Kompania F
11	Kompatator Skania	Kompania F
12	Kamionçinë Benz	Kompania F
13	Kamionçinë Benz	Kompania F
14	Kamion 4 akse	Kompania F
15	Kamion 4 akse	Kompania F
16	Kamion 4 akse	Kompania F

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyrën PF65: Referuar situacionit për muajn gusht 2023 sasia mbetjeve të depozituara në landfillin e Sharrës është 8,004 ton me vlerë prej 33,798,199 lekë pa tvsh.

Data	Sasia faktike e mbetjeve	Çmimi/njësi pa tvsh	Vlera pa tvsh	TVSH	Vlera me Tvsh
01.08.2023	253.11	3,518.86	890,658	178,131	1,068,790
02.08.2023	249.35	3,518.86	877,427	175,485	1,052,913
03.08.2023	226.43	3,518.86	796,775	159,355	956,130
04.08.2023	244.23	3,518.86	859,411	171,882	1,031,293
05.08.2023	245.79	3,518.86	864,900	172,980	1,037,880
06.08.2023	267.44	3,518.86	941,083	188,216	1,129,300
07.08.2023	286.42	3,518.86	1,007,871	201,574	1,209,446
08.08.2023	287.56	3,518.86	1,011,883	202,376	1,214,260
09.08.2023	264.49	3,518.86	930,703	186,140	1,116,843
10.08.2023	249.79	3,518.86	878,976	175,795	1,054,771
11.08.2023	282.35	3,518.86	993,550	198,710	1,192,260
12.08.2023	265.61	3,518.86	934,644	186,928	1,121,573
13.08.2023	267.04	3,518.86	939,676	187,935	1,127,611
14.08.2023	299.87	3,518.86	1,055,200	211,040	1,266,240
15.08.2023	263.88	3,518.86	928,556	185,711	1,114,268
16.08.2023	261.96	3,518.86	921,800	184,360	1,106,160
17.08.2023	255.90	3,518.86	900,476	180,095	1,080,571
18.08.2023	264.95	3,518.86	932,321	186,464	1,118,786
19.08.2023	269.10	3,518.86	946,925	189,385	1,136,310
20.08.2023	222.64	3,518.86	783,438	156,687	940,126
21.08.2023	266.71	3,518.86	938,515	187,703	1,126,218
22.08.2023	268.08	3,518.86	943,335	188,667	1,132,003
23.08.2023	260.88	3,518.86	918,000	183,600	1,101,600
24.08.2023	230.92	3,518.86	812,575	162,515	975,090
25.08.2023	267.14	3,518.86	940,028	188,005	1,128,033
26.08.2023	240.95	3,518.86	847,869	169,573	1,017,443
27.08.2023	235.99	3,518.86	830,415	166,083	996,498
28.08.2023	273.18	3,518.86	961,282	192,256	1,153,538
29.08.2023	239.22	3,518.86	841,781	168,356	1,010,138
30.08.2023	236.96	3,518.86	833,829	166,765	1,000,594
31.08.2023	256.12	3,518.86	901,250	180,250	1,081,500
Totali	8,004.06		28,165,166	5,633,033	33,798,199

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Sipas tabelës së mësipërme nga Grupi i Auditimit u verifikua dokumentacioni justifikues për sasinë e mbetjeve të depozituara në landfillin e Sharrës.

Dokumentacioni bashkëngjitur është si më poshtë:

1-Fletë pranimi i mbetjeve i firmosur nga personi i autorizuar për transportin dhe përfaqësuesi i impiantit të depozitimit.

2-Rregjistri i ngarkesave ditore në landfillin e Sharrës sipas targës së mjeteve, peshën e mjetit të ngarkuar, peshën e mjetit bosh dhe orarin e depozitimit të mbetjeve.

3-Përmbledhëse ditore e sasisë së depozituar në landfillin e Sharrës e firmosur nga kompania I..E..

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **E. L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.**

2. **H. H. me detyrë Përgjegjës i Drejtorisë Ekonomike.**

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Durrës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1216/15 prot., datë 22.8.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1347/12 prot., datë 26.8.2025, nga H. H dhe E. L, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me rekomandimin nr.4 bazuar në rekomandimin e KLSH është kryer korrigjimi i vlerës 614,115,113 lekë. Përsa i përket konstatimit, Drejtoria Ekonomike ka të drejtë të pasqyrojë në pasqyrat financiare detyrimet e subjekteve (debitorët) ky informacion merret nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me shkresë zyrtare dhe listë analitike. Gjatë vitit 2023 nga DTTV nuk është dërguar ky informacion.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Referuar konstatimit dhe rekomandimit të mëparshëm është kërkuar që shuma e detyrimit prej 614,115,113 lekë të kontabilizohet në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” sipas listës analitike që i përket sepse gjatë vitit 2018 ky detyrim është pakësuar nga llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” pa dokumentacion justifikues. Sa më sipër shuma 614,115,113 lekë është kontabilizuar thjesht si shuma pa pasur një listë analitike.

Sa më sipër observacioni nuk do të merret në konsideratë në hartimin e raportit përfundimtar të auditimit.

2. Pretendimi i subjektit:

Sipas gjetjes për llogarinë 4342 duhet të ishte përfshirë dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” referuar udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 sipas pikës 59 të këtij udhëzimi këto shpenzime nuk janë të vitit që raportohet dhe nuk janë realizuar në vitin raportues.

Sipas pikës 42 të udhëzimit nr.8, Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjtore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzimet apo shërbimet e parealizuara për mungesë të fondeve. Për të evidentuar këto detyrime do të përdoret llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Referuar udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rregjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me keto të fundit.

Sa më sipër observacioni nuk do të merret në konsideratë në hartimin e raportit përfundimtar të auditimit.

3. Pretendimi i subjektit:

Përsa i takon pjesës për hartimin e pasqyrave të konsoliduara, Drejtoria Ekonomike nuk ka tagër të bëjë kontrollin dhe miratimin e bilanceve të institucioneve të varësisë por bën vetëm bashkimin mekanik të bilanceve sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave.

Bilancet individuale janë të kontrolluara dhe të konfirmuara nga Dega e Thesarit Durrës dhe pasi vijnë në Drejtorinë Ekonomike bëhet konsolidimi sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave.

Përsa i takon nënvlerësimit apo mbivlerësimit të llogarive të pasqyrave të konsoliduara, Pasqyrave e Pozicionit Financiar totali i konsolidimit është i saktë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Referuar konstatimeve sipas gjetjeve 7.1,8.1, 9.1, 10.1, 11.1, 12.1, 14.1, problematikat janë trajtuar tek pasqyrat individuale dhe pasqyrat e konsoliduara. Përgjegjësitë janë përcaktuar në akt- konstatimet dhe projekt raportin e auditimit. Referuar auditimit të pasqyrave individuale shumatorja e tyre nuk përputhet me pasqyrën e kontabilizuar.

Sa më sipër observacioni nuk do të merret në konsideratë në hartimin e raportit përfundimtar të auditimit.

4. Pretendimi i subjektit:

Ju bëjmë me dije se për pagesën e kësaj llogarie ka procedura të cilat kryhen nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe nga komisioni i marrjes në dorëzim të objektit për të cilin janë kredituar 5% të fondeve.

Drejtorja e Financës pas plotësimit të të gjitha procedurave bën kthimin e shumës së mbajtur me shkresë nga Nëpunësi Autorizues dhe sipas aktit të marrjes në dorëzim të objektit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në rekomandimin e lënë është përcaktuar se në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike duhet zhblokuar garancitë për të cilat ka kaluar afati i garancisë.

Pika 2.8. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi fundit.

Në mbështetje të shkronjave (a), (b) dhe (c) të nenit 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 765/22 prot, datë 02.05.2024 i ka dërguar Bashkisë Durrës, “Raportin përfundimtar” të shoqëruar me rubrikën e masave administrative dhe disiplinore për përmirësimin e gjendjes.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmblendhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Bashkia Durrës **ka respektuar** këtë afat, duke kthyer përgjigje sipas shkresës me nr.946/16 Prot., datë 22.05.2024.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masat për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, duke kthyer përgjigje me anë të shkresës me Nr. 946/28 Prot., datë 11.11.2024, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2.

III. Rekomandimet e KLSH.

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 765/22 prot., datë 02.05.2024, janë rekomanduar gjithsej 95 masa me vlerë 2,974,896 lekë, si më poshtë vijon:

a. 39 masa organizative;

b. 7 masa për shpërblim dëmi në vlerën **2,794,896 lekë**;

c. 9 masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;

d. 3 masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit;

e. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Durrës që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e **masave disiplinore për 37 punonjës**.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 765/22 Prot., datë 02.05.2024, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (Bashkia Durrës)	Pa pranuar
1	Organizative	39 masa	39 masa	-

2	Shpërblim dëmi	7 masa	7 masa	-
3	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	9 masa	9 masa	-
4	Për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit	3 masa	3 masa	-
5	Masa Disiplinore	37 masa	37 masa	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmblëdhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1.	Organizative	39 masa	7 masa	2 masa	14 masë	16 masa
2.	Shpërblim dëmi	7 masa	5 masa	2 masa	-	-
3.	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	9 masa	4 masë	1 masa	1 masa	-
4.	Për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit	3 masa	-	-	-	3 masë
5.	Masa Disiplinore	37 masa	-	37 masa	-	-

Konkluzion i përgjithshëm:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 39 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 7(shtatë) janë zbatuar, 14 (katërmbëdhjetë) janë në proces zbatimi, 2 (dy) janë zbatuar pjesërisht dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) nuk janë zbatuar. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohen 15 masa organizative pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 7 rekomandime për 7 subjekte në vlerën **2,794,896 lekë** dhe janë pranuar plotësisht, të cilat janë 2 (dy) pjesërisht dhe 5 (pesë) janë zbatuar.

- Për uljen e borxhit tatimor janë lënë 9 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat 4 (katër) janë zbatuar plotësisht, 1 (një) zbatuar pjesërisht, 4 (katër) në proces zbatimi. Masa e zbatuar pjesërisht nuk do të rikërkohen pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 3 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht, 3 nuk janë zbatuar. Masat e pa zbatuara nuk do të rikërkohen pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

-Për masa disiplinore janë lënë 37 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat 37 janë zbatuar pjesërisht.

Në mënyrë analitike statusi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Durrës në bazë të Programit të Auditimit nr.1347/1 Prot, datë 13.11.2024, për periudhën nga 01.01.2023 deri në 31.12.2024, paraqitet si më poshtë:

A. Masa Organizative:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk është hartuar plani vjetor i punës. Nga auditimi rezultoi se nuk ka raportime periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit.. Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të. Takimet e GMS nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale. Bashkia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.

Aktivitetet e rëndësishme (me vlera të konsiderueshme) dhe aktivitetet afatgjata nuk ruhen nga përdorimi i paautorizuar me anë të një procedure të shkruar. Bashkia nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që

i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Bashkia nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 20-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Durrës, Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori i MFK -së të merren masa për:

- Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performancë, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

- Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin e konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.

- Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.

Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimit i Bashkisë Durrës për periudhën 01.01.2023-31.12.2024 u konstatuan se nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Durrës. Mungojnë manualët e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit. Referuar programit të auditimit nr.1347/1 rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual

Statusi: Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Durrës përgjatë vitit 2022, u konstatua se bashkia nuk ka ngritur Komitetin e Auditimit. Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në MAB. Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm nuk ka të përcaktuara mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës. Programit të miratuar i mungon komponenti “Reagimet e subjektit të audituar” sipas kërkesave e MAB, Kapitulli VII, pika 7.1.1.

Nga auditimi rezultoi se audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit,

Në raportet e auditimit audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar sipas kërkesave të MAB, kapitulli IV, pika 4 .1.12. Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të MAB, kapitulli IV, pika 4.1.12. Dosjet e auditimit nuk përmbajnë “Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit” sipas kërkesave të MAB, kapitulli VI, pika 2;

NJAB, nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të

brendshëm, asetet, etj. Planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në mospërputhje me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 20-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Durrës, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të merren masa për:

-Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si një organ i pavarur.

-Përditësimin e Kartës së Auditimit dhe Programit për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese,

-Shqyrtimin e risqeve më të rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e projekteve, programeve në të cilat janë fokusuar objektivat strategjikë, të njësive publike,

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimit i Bashkisë Durrës, për periudhën 01.01.2023-31.12.2024. Referuar rekomandimit nr.2 nuk është ngritur komiteti i auditimit.

Me urdhër nr.360 prot, datë 25.09.2024 është miratuar karta e përditësuar e auditit të brendshëm. Karta e auditimit me shkresën nr.11138/2 prot, datë 30.09.2024 është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave.

Me shkresën nr.11138/1, datë 30.09.2024 është miratuar programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Durrës është përditësuar sipas komponentëve të përcaktuar në manualin e auditit të brendshëm kapitulli VII, pika 7.1

Statusi: Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2022 u konstatua se:

a. Realizimi i buxhetit për vitin 2022 është 7,235,165 mijë lekë nga 8,648,771mijë lekë të planifikuara, ose në masën 84%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi i zërit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 62%, që ka ardhur nga mos finalizimi i 56 projekteve të planifikuara, për të cilat nuk janë kryer procedurat e prokurimit, ndërsa për 41 projekte të planifikuara, për të cilat janë çelur edhe fondet, janë financuar pjesërisht ose nuk janë financuar për arsye të mos mbylljes së punimeve brenda vitit buxhetor, për shkak të lidhjes së kontratave me vonesë. Gjithashtu 12 projekte investimi të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 të planifikuara janë financuar nga fondet e rindërtimit në masën 50%, për shkak të mosrakordimi të fondeve nga buxheti i shtetit për mbylljen e këtyre investimeve.

b. Nuk është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura të rezultuara në fund të vitit 2021 në vlerën 156,887,958 lekë. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 110,374,392lekë.Detyrimet e papaguara rakordojnë me gjendjet e llog. të klasë 4 të bilancit të vitit 2022, por nuk rakordojnë për shumën 36,370,104 lekë me raportimin në MFE të vitit 2022 në vlerën 74,004,288 lekë, diferencë që i përket e detyrimeve të prapambetura për investime të pa financuara nga Ministritë e linjës dhe FZSH, të cilat nuk janë përfshirë në raportim. Ndërsa gjatë vitit 2022 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura.

c. Gjithashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 89% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 11% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat, që siguron njësia vendore nga burimet të tjera. Këto veprime janë në kundërshtim me ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 43 paragrafi 4,47,48,52: ligji nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40/h,42; Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes

Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3 me Udhëzimin e MFE nr.09, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit” pika 106. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës, nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit, të kryejë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara.

- Gjithashtu Bashkia të sigurojë realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara, sipas prioriteteve strategjike, duke shmangur vonesat në procedurat e prokurimit, në lidhjen e kontratave dhe eliminuar limitimin e likuidimeve për angazhime të marra.

- Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, duke hartuar një grafik me radhën e pagesave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 3.1, nga auditimi i buxheteve të viteve 2023-2024 u konstatua se programet e shpenzimeve buxhetore janë të argumentuara. Me shkresën nr.9796, datë 18.10.2023 Drejtoria e Buxhetit i është drejtuar drejtorive të Bashkisë Durrës për të përgatitur kërkesat buxhetore.

Gjatë vitit 2023-2024 në lidhje me realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara nga auditimi u konstatuan vonesa në procedurat e prokurimit dhe në lidhjen e kontratave.

Në lidhje me detyrimet e prapambetura me VKB nr.37, datë 21.05.2024 është miratuar “Raporti mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit”.

Statusi: Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, e cila paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 591,457,852 lekë, ku në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 102,497,719 lekë. Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” konstatohet se, vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 prej 165,047,159 lekë, është e pasaktë, pasi kjo vlerë i përket vlerës debitorëve të krijuar në vitin ushtrimor 2022. Nga të dhënat e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vlera progresive në datë 31.12.2022 e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 799,162,272 lekë, duke sjellë një mosrakordimi për vlerën 634,115,113 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu III., pika 2, Aneksi 1 pika 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat që të bëjë kontabilizimin e saktë të të drejtave të arkëtueshme nga të tretët në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”. Të bashkëpunojë me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për saktësimin e vlerës, duke rakorduar zyrtarisht si për vlerën debitorëve të krijuar gjatë vitit ushtrimor dhe për vlerën progresive të akumuluar në fund të vitit ushtrimor të argumentuar me dokumentacion.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 4.1 për kontabilizimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Drejtoria Ekonomike ka kryer kontabilizimin e shumës 634,115,113 lekë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” vetëm si vlerë debitorëve totale pa e ndarë analitike sipas debitorëve përkatës. Procedura për identifikimin e borxhit tatimor progresiv analitik do të kryhet në mënyrë manuale nga specialistët. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 4342 *“Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”* në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 36,767,298 lekë, kur në fakt duhet të ishte në vlerën 49,010,534 lekë, pasi në analizë përfshin gjendjet e llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasivin e bilancit: llog.401-404 *“Furnitore e llogari te lidhura me to”* në vlerën 12,243,236 lekë, llog.42 *“Detyrime ndaj personelit”* për vlerën 25,440,333 lekë, llog.431 *“Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”* për vlerën 2,393,534 lekë, llog.435 *“Sigurime shoqërore”* për vlerën 7,862,602 lekë, llog.436 *“Sigurime shëndetësore”* për vlerën 1,070,830 lekë. Pra gjendja e llog. 4342 *“Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”* nuk rakordon për shumën prej 12,243,236 lekë me shumën e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, vlerë kjo që i përket llog.401-404 *“Furnitore e llogari te lidhura me to”*, e cila nuk është përfshirë edhe pse është detyrim, që i ka shteti/Bashkia të tretëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, i ndryshuar, Kreu II pika 15/b,59 /a, Kreu III, pika 32, Aneksi 1 pika 3.3 nënpika 8. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që të bëjë kontabilizimin e saktë në llog. 4342 *“Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”* të detyrimit që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, duke përfshirë edhe gjendjen e llog.401-404 *“Furnitore e llogari te lidhura me to”*, detyrim që i ka shteti/Bashkia të tretëve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 5.1 për kontabilizimin e llogarisë 4342 *“Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”*, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Referuar auditimit për periudhën 01.01.2023-31.12.2024 llogaria 4243 *Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”* rezultoi e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar e nënvlerësuar. Kjo llogari është pasqyruar në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar në vlerën 129,815,530 lekë, referuar pasqyrave individuale të njërive shpenzuese kjo llogari duhet të pasqyrohej për vlerën 471,150,473 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 146,665,977 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 *“Studime dhe Kërkime”*, për 27 projekt-studime për investime të kryera apo për investime të pakryera, ku për një pjesë nuk ka të dhëna nëse janë kryer investimet dhe përse vlera e këtyre studimeve nuk i është shtuar vlerës së aktivitetit të kapitalizuar. Në gjendjen e kësaj llogarie një pjesë e vlerave të këtyre studim-projekttimeve kanë mbetur në vite dhe një pjesë janë trashëguar nga ish-Komunat. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se në këtë gjendje janë përfshirë 3 zëra në vlerën 10,275,736 lekë, që nuk mund të jenë pjesë e gjendjes së llog. 202 *“Studime dhe Kërkime”*, referuar nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, i ndryshuar, Kreu II pika 16/b.d, Aneksi 1 pika 2 Klasa 2 dhe me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Durrës të verifikojë dhe të shqyrtojë dokumentacionin financiar në lidhje me blerjen e AAGJM dhe të kryejë kontabilizimet përkatëse për shpërndarjen e vlerës të studim-projekttimeve, sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi

afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë sistemimet e duhura për vlerën 10,275,736 lekë, duke e shpërndarë në investimet përkatëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 6.1 për kontabilizimin e vlerës së projekteve në llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime”, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Referuar rekomandimit të mësipërm, Drejtoria Ekonomike nuk ka kryer sistemin e vlerës 10,275,736 lekë për 3 projektet të cilat duhet të kontabilizohen në klasën e aktivitetit përkatës. Për 27 projektet nuk ka informacion nga Zyra e Projekteve. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 212 “Ndërtesa Konstrukione” u konstatua se 9 aktive afatgjatë materiale në vlerë 118,775,472 lekë, ku në 8 raste prej tyre kanë emërtesa të paplota, ta paqarta dhe të pasakta, dhe 1 rast në vlerën 1,157,939 lekë nuk ka emërtim, gjë që do të thotë se inventari kontabël nuk përputhet me gjendjen kontabël për këtë vlerë. Për këto aktive nuk është bërë asnjë inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu III, Seksioni 3.1, pika 31 Aneksi 1 pika 2 Klasa 2 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pika 74. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Titullari e Bashkisë Durrës të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në llog. 212 “Ndërtesa Konstrukione” dhe vlerësimit të tyre nëse ekzistojnë e nëse kanë vlerë përdorimi dhe më pas të marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore në rast dëmtimesh apo shembjesh. Ndërsa Drejtoria e Financës të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 7.1 për inventarizimin e aktiveve në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione”, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Nga Titullari i Bashkisë Durrës me urdhrin nr.216, datë 20.06.2023 është ngritur grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të Bashkisë Durrës. Referuar urdhrin të mësipërm nuk është kryer inventarizimi për llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione”. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga Titullari i Bashkisë Durrës nuk është ngritur komisioni nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, duke mos u kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe ajo e asgjësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 2,201,233 lekë. Për këto aktive janë kryer veprimet kontabël të pakësimit konkretisht në llog. 214 “Instalime teknike, makineri dhe paisje” në vlerën 573,162 lekë dhe llog. llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,628,071 lekë, pa u kryer procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe ajo e asgjësimit të këtyre aktiveve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

i ndryshuar, pika 95-114. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Durrës të ngrejë komisionin për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimi në vlerën 2,201,233 lekë, të cilat të shoqërohen me dokumentacionin ligjor përkatës. Më pas nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi të bëhet ndarja e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi në material të riciklueshëm dhe nëse s'ka, të kryhet procedura e asgjësimit, duke ndryshuar formën e tyre fillestare, gruposur apo djegur, të dokumentuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 8.1 për komisionin e nxjerrjes së aktiveve, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Nga Titullari i Bashkisë Durrës me urdhrin nr. 235, datë 05.07.2023 “Për caktimin e kryetarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit/tjetërsimit të aktiveve të panevojshme të Bashkisë Durrës”. Me shkresën nr.6384/1 prot, datë 25.07.2023 janë caktuar anëtarët e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit/tjetërsimit të aktiveve të Bashkisë Durrës. Me shkresën nr.5043/2, prot, datë 03.10.2024 është mbajtur procesverbali nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit/tjetërsimit të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra të Bashkisë Durrës.

Statusi: Zbatuar plotësisht

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 16 “Hua Afatgjata” në pasiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe 2021 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që Bashkia Durrës ka marrë në vitin 2014 Kredi të financuar nga CEB në vlerën 3,341,000 euro ose në 352,937,752 lekë për ndërtimin e Banesave Sociale investim i kryer që në ato vite. Kjo kredi është ratifikuar në Parlament dhe lëvrimi i kredisë është bërë nëpërmjet Marrëveshjes së nënshkruar nga Bashkia Durrës me MFE, pagesa e secilës ndiqet nga kjo e fundit. Nuk ka një evidentim të shumës së kësaj huaje në kredi të llog. 16 “hua afatgjata” dhe për pagesat e kryera në vlerën 171,479,202 lekë në debi të kësaj llogarie, në mënyrë që gjendja e kësaj llogarie të paraqesë vlerën e kredisë së mbetur papaguar prej 181,458,550 lekë. Në fakt për pagesat e kësteve të kredisë është rënduar më pa të drejtë llogaria 231 “Investime në proces”, kur ky investim është kryer si punime dhe si financime dhe kjo vlerë ka kaluar në llogarinë e aktiveve 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II, pika 2.3 nënpika 22, 23, Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për kontabilizimin e saktë të kredisë për banesat sociale të financuar nga CEB për Bashkinë Durrës në llogarinë përkatëse 16 “Hua Afatgjata”, ku në mbyllje të vitit 2023 për pagesat e bëra të kësteve të kontabilizuar më parë në llog.231 “Investime në proces” të kryhen veprimet kontabël sistemuese, duke i kaluar ato në gjendjen e llog.16 “Hua Afatgjata” dhe në vazhdim për pagesat e tjera deri në likuidimin e plotë të kredisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 9.1 për kontabilizimin e kredisë në llogarinë 16 “Hua afatgjatë”, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Referuar auditimit të pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2023 të Bashkisë Durrës është kryer kontabilizimi në llogarinë përkatëse 16 “Hua Afatgjatë”.

Statusi: Zbatuar plotësisht

10. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që shuma e gjendjeve të debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit është në vlerën 592,148,550 lekë përkatësisht: (gjendja e llog.468 "debitorë të ndryshëm" në vlerën 591,457,852 lekë + gjendja e llog.423-429

"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" në vlerën 690,699 lekë). Këto gjendje janë paraqitur në mënyrë të gabuar në llogaritë në pasiv të bilancit në gjendjen e llog. 475 "Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse" në vlerën 591,457,852 lekë dhe gjendjen e llog.480 të ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar në vlerën 690,699 lekë, kur duheshin paraqitur në gjendjen e llog. 4341 "*Operacione me shtetin (detyrime)*". Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu III., pika 42, Aneksi 1 pika 3.3 nënpika 8. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që të kryejë veprimet e sakta kontabël për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit si debitorët, duke i përfshirë në gjendjen e llogarisë 4341 "*Operacione me shtetin (detyrime)*", me qëllim që të kontabilizohet në mënyrë të saktë detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 10.1 për kontabilizimin e saktë të llogarisë 4341 "*Operacione me shtetin (detyrime)*", rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitet 2023-2024 të Bashkisë Durrës rezultoi se kjo llogari është kontabilizuar në vlerën 0 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në 21 raste faturash me vlerë 406,300,574 lekë, mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime/ investime të mbërritura në Bashkinë Durrës, të cilat 23 raste në vlerën 10,502,565 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 "shpenzime operative" dhe në 39 raste në vlerën 395,798,009 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 "investime", ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar për mungesë fondesh nga Ministria, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 44 "Kontrolli i shpenzimeve". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 113-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1.Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (*përgjashtuar kufizimet e MFE*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 11.1 për likuidimin në kohë të faturave nga auditimi i dokumentacionit përgjatë periudhës 2023-2024 rezultoi se janë kryer likuidime faturash me afat mbi 30 ditë nga dërgimi i faturave.

Statusi: Në proces zbatimi

12. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 8 **praktika**, tek të cilat pasqyrohen situatat në lidhje me:

- mosrespektimin i kriterëve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi;

- *plani i vendosjes së strukturës të miratuar për leje ndërtimi nuk përputhet plotësisht me projektin e ndërtimit, pasi në të nuk pasqyrohen daljet dhe faqet konsol të objektit;*
- *projekti konstruktiv nuk përputhet me projektin arkitektonik;*
- *mosrespektimin i distancave nga kufiri i pronës dhe distancave nga trupi i rrugës;*
- *mos përcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosjen dhe në lejen e ndërtimit të miratuar, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi;*
- *mungesa e dokumentacionit të plotë të pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje;*
- *në lejen e ndërtimit janë miratuar zhvillimi i objekteve që nuk janë në përputhje me përdorimet e lejuara në njësinë strukturore përkatëse, të evidentuara në projektin e ndërtimit dhe në relacionin teknik pasi janë propozuar edhe funksione të tjera;*

- *miratimi i ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit duke tejkaluar masën 2% të sipërfaqes ndërtimore. Situatat e mësipërme janë evidentuar përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt:*

1. “Godinë industriale 1 dhe 2 kat + vendroje + kabinë elektrike dhe mur rrethues”, miratuar me vendimin Nr. 2775, datë 28/01/2022, me zhvillues “M.O” ShPK, në adresën rruga “Vath Turja”, Spitallë, Durrës;
2. “Godinë shërbimi dhe banimi 6 kat+1 kat nën tokë dhe banesë 2 kat +1 kat nën tokë”, miratuar me vendimin Nr. 104, datë 29.04.2022, me zhvillues “A.K” ShPK, në adresën Lagjia 17, Rruga “Doktor Remzi”, Durrës;
3. “Strukturë industriale 2 dhe 3 kate dhe 1 kat nëntokë”, miratuar me vendimin Nr. 2884, datë 14/02/2022, me zhvillues “P.B” ShPK, në adresën Rruga “Athina”, Durrës.
4. “Kompleks Vila Banimi 2 kat + 1 kat nëntokë, “B. Residences D. H.”, miratuar me vendimin Nr. 2737, datë 18/01/2022, me zhvillues shoqëria “B.N” ShPK, në adresën rruga “Kont Urani”, Lagja 1, Durrës;
5. “Struktura akomoduese turistike 2 dhe 3 kat dhe rrethim i pronës”, miratuar me vendimin Nr. 925-22/6, datë 21/12/2022, me zhvillues “CH.L” ShPK, në adresën Hamallë, Njësia Administrative Manëz, Durrës;
6. “Shtëpi banimi 2 kat + podrum + papafingo dhe mur rrethues”, miratuar me vendimin Nr. 2859, datë 08/02/2022, me zhvillues V.N.P, në adresën rruga “Idriz Xhafi”, Shkallnur, Durrës;
7. “Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore”, miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R.S/ V.S, në adresën Lalëz, njësia administrative Ishëm, Durrës;
8. “Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat”, miratuar me vendimin Nr.2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B.M, në Lalz, Durrës.

Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin Nr.107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor, me Planin e Përgjithshëm Vendor i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 27, datë 10.05.2013 “Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës”; me VKM Nr. 502, datë 13.07.2011, “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 39; Neni 40; me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika c dhe pika 1/1, ii; neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës; neni 37, lartësia e ndërtimeve; neni 17, pika e; me Vendimin Nr.12, datë 27.02.2019, “Për miratimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban, bujqësor dhe natyror”, në pikën 4. me Ligjin 111/2018, për “Kadastrën”, datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4; VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 15, në pikën 1, germa b. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: DPKZHT Durrës të marrë masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 12.1 nga auditimi i dokumentacionit përgjatë periudhës 2023-2024 u konstatuar se në vitin 2023 ka hyrë në fuqi plani i përgjithshëm vendor. Nga verifikimi i dokumentacionit për lejet e ndërtimit gjatë periudhës 2023-2024 u konstatua se në disa leje ndërtimi nuk janë zbatuar të gjitha kriteret dhe kondicionet urbane. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

13. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të certifikatave të përdorimit u konstatuan **2 praktika**, tek të cilat pasqyrohen situatat në lidhje me mosparaqitjen në sistemin e-Leje e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e certifikatës së përdorimit dhe zbatimi i punimeve në terren nuk përputhet me lejet e ndërtimit të miratuara. Situatat e mësipërme janë evidentuar përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt:

1.“*Godinë Banimi dhe Shërbimi 2-4 dhe 6 Kate me 1 Kat Nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr. 3004, datë 10/03/2022, me zhvillues “K. 03”, në adresën lagjja 6, Rruga “Aleksander Goga”, Durrës;

2.“*Rikonstrukcion dhe ndryshim funksioni të godinës banimi dhe shërbimi 6 kat mbi tokë dhe një kat nëntokë*”, miratuar me vendimin Nr.2763, datë 26/01/2022, me zhvillues I.A, në adresën lagjja 14, Shkozë, Durrës.

Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, në nenin 27/1; në nenin 27/2, në pikën 1; me Ligjin 107/2014, datë 31.7.2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, Neni 42; me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 27/1, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit; (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Durrës të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm përpara miratimit të certifikatës së përdorimit dhe për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura gjatë realizimit të zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejet e ndërtimit të miratuara.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 13.1 nga auditimi i dokumentacionit përgjatë periudhës 2023-2024 u konstatuar se jo në të gjitha rastet është paraqitur i gjithë dokumentacioni i kërkuar për miratimin e certifikatës së përdorimit. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i **2 praktika** u konstatua se realizimi i punimeve në terren nuk ishte në përputhje me projektin e ndërtimit, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt:

1.“*Struktura akomoduese dhe shërbimi për promovimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore*”, miratuar me vendimin Nr.3009, datë 10/03/2022, me zhvillues R.S/ V.S, në adresën Lalëz, njësi administrative Ishëm, Durrës; 2.“*Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat*”, miratuar me vendimin Nr. 2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B.M, në Lalëz, Durrës.

Konstatimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin Nr.107/2014, për “*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, neni 51, Inspektimi; me Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007, “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, i ndryshuar, neni 5, detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës; neni 12, ushtrimi i kontrollit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Nga IVMT Durrës të merren masat për të realizuar kontrolle të vazhdueshme në terren, me qëllim realizimin e punimeve në terren në përputhje me projektin e ndërtimit të miratuar dhe për çdo rast që evidentohen ndryshime të realizimit të punimeve, mbajtjen e proces-verbalëve për konstatimin e kundërvajtjes.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 14.1 nga auditimi i dokumentacionit përgjatë periudhës 2023-2024 u konstatuar së jo në të gjitha rastet janë realizuar kontrolle të vazhdueshme në terren me qëllim verifikimin e realizimit të punimeve në përputhje me projektin e miratuar. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

15. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimeve dhe zhvillimit të territorit, u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me zhvillimin e ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklarata paraprake punimesh, përkatësisht në rrugën Vath Turja, Durrës, janë evidentuar ndërtimi i disa strukturave në funksion shërbimi. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 51, Inspektimi; me Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 5, detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës; neni 12, ushtrimi i kontrollit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Nga IVMT Durrës të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 15.1 nga auditimi i dokumentacionit përgjatë periudhës 2023-2024 u konstatuar se nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit gjatë vitit 2023 janë vendosur 127 (njëqind e njëzet e shtatë) masa administrative, vendim me gjobë, në shumën 38,350 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 janë vendosur 150 (njëqind e pesëdhjetë) masa administrative, vendim me gjobë, në shumën 41,141 mijë lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

16. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e pajisjes me certifikatës së përdorimit, pas miratimit të lejes së ndërtimit, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt “Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat”, miratuar me vendimin Nr. 2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B.M, në Lalz, Durrës. Anomalia e mësipërme nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 50; me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 52, pika g, përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit; me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Pas miratimit të lejes së ndërtimit, DPZHT Durrës dhe IVMT të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime të ndërtimit të objektit në terren dhe nëpërmjet proces-verbalëve të bëjë konstatimin e kundërvajtjes, duke mos lejuar përdorimin e objekti pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 16.1 nga auditimi i dokumentacionit përgjatë periudhës 2023-2024 nuk janë konstatuar objekte në përdorim të pa pajisur me çertifikatë përdorimi.

Statusi: Zbatuar plotësisht

17. Gjetje nga auditimi: Në 7 raste nga Bashkia Durrës, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT, është lejuar të ushtrohet aktivitet nga subjekte private në objekte pasuri shtetërore me Kontratë-Qiraje jashtë afatit, në kundërshtim me kreun VI pika 2/b të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT, të njoftohen me shkrim Qiramarrësit, për "Zgjidhje Kontrate", pasi është mbyllur afatit i kontratës së qirasë për sipërfaqen e objektit të pasurisë shtetërore si dhe të merren në dorëzim me procesverbal objektet që ka në administrim bashkia dhe janë pa kontratë qeraje.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 17.1 nga auditimi i dokumentacionit përgjatë periudhës i vendosur në dispozicion Ndërmarrja BGT ka lidhur 10 kontrata përgjatë vitit 2024, kontrata të viteve të mëparshme aktive nuk ka.

Statusi: Zbatuar plotësisht

18. Gjetje nga auditimi: Nga "Sektori i pronave dhe asetëve" në Bashkinë Durrës, janë të administruar vetëm 2 lista të pronave të miratuara me VKM dhe konkretisht ajo e Bashkisë Durrës e cila është e miratuar me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës" dhe e ish-Komunës Ishëm e miratuar me VKM, nr. 284, datë 12.3.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ishëm, të Qarkut të Durrësit", ndërsa Njësitë e tjera Administrative që varen nga Bashkia Durrës janë me listë paraprake, jo përfundimtare të pa miratuar me VKM, në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 i ndryshuar "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore" (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës të hartojë dhe paraqesë për miratim pranë Këshillit të Ministrave listën përfundimtare me dokumentacionin e nevojshëm shoqërues të pronave të paluajtshme publike të të gjitha Njërive Administrative, që të transferohen në pronësi apo përdorim të saj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për periudhën 2023-2024 nuk ka pasur ndryshime në lidhje me pronat e njësitë administrative.

Gjatë vitit 2020 nga Këshilli Bashkiak Durrës janë miratuar listat përfundimtarë të pjesshmë për 3 (njësitë) Rrashbull, Sukth, Manëz.

VKB nr.29, datë 09.04.2020 "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshmë të pronave të paluajtshme publike shtetërore brenda juridiksionit të Bashkisë Durrës, të Njërive Administrative Rrashbull".

VKB nr.30, datë 09.04.2020 "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshmë të pronave të paluajtshme publike shtetërore brenda juridiksionit të Bashkisë Durrës, të Njërive Administrative Sukth".

VKB nr.31, datë 09.04.2020 “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore brenda juridiksionit të Bashkisë Durrës, të Njësisë Administrative Manëz”.

Statusi: Pa zbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IVMT, në 34 raste, edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Dënim me Gjobë” dhe “Prishje Objekti të Kundërligjshëm”, në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 246-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës, të vijojë procedurën për nxjerrjen e Vendimit për “Dënim me Gjobë” dhe “Prishje Objekti të Kundërligjshëm”, për 34 subjekte që janë me procesverbal konstatimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, sipas tabelës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit u konstatua se gjatë periudhës 2023-2024 në 22 (njëzet e dy) raste nuk është respektuar afati 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Dënim me Gjobë” dhe “Prishje Objekti të Kundërligjshëm”. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IVMT, u konstatua se nga 119 vendime për “Prishje e Objektit të Kundërligjshëm”, janë ekzekutuar vetëm 25 vendime të shoqëruar me Urdhër Ekzekutimi nga Kryeinspektori i IVMT-së, ndërsa për 94 vendime nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Kalimi i afateve për ekzekutimin e Prishjeve të Objektit sjell si pasojë parashkrimin e tyre dhe pamundësi për ekzekutim, në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar dhe nenin 46 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet administrative” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 246-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Durrës, të nxjerrë Urdhër Ekzekutimi për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për 94 raste të konstatuara, për të cilat akti administrativ (vendimi për dënim për prishje) nuk është parashkruar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion sipas plan zbatimit të dërguar me shkresën nr765/22 prot, datë 02.05.2024 nga Drejtoria e IMT, Durrës nuk është paraqitur dokumentacion provues për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit për 94 rastet e konstatuara sipas rekomandimit nr .20.1. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV, u konstatua se nga Kryeinspektori i IMT-së i Bashkisë Durrës është nxjerrë “Urdhri i Ekzekutimit” për prishjen e objektit të kundërligjshëm, por nuk është vijuar prishja e objektit me justifikimin se “...mjeti tip ekskavator nuk mund të përshkojë distancën mbi 5 km, për shkak se çdo difekt që mund t'i ndodhë gjatë rrugëtimit të gjatë, mund të nxjerrë mjetin jashtë përdorimit”, që do të thotë se të gjitha objektet që janë për

prishje mbi 5 km nuk janë të ekzekutueshëm nga IMT-ja e Bashkisë Durrës, në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 246-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

21.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa, që në të gjitha rastet kur ka një Urdhër Ekzekutimi nga Kryeinspektori i IMT për prishjen e objektit të kundërligjshëm, që nuk mund të ekzekutohen me mjetet e veta, të kërkohet mbështetje me mjete nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, për prishjen e objektit të kundërligjshëm.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, u konstatua se gjatë periudhës 2023-2024, në 1 (një) rast IMT nuk ka ekzekutuar vendimin e prishjes, me arsyen e mungesës së mjeteve. Në situata të ngjashme është kërkuar bashkëpunim me Ndërmarrjen Komunale. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) Bashkia Durrës, u konstatua se për 71 vendime me “Dënimin me Gjobë” nuk janë likuiduar gjobat nga subjektet, në një vlerë prej 17,400,000 lekë. Nga zyra përmbaremore nuk është vijuar ekzekutimi i detyrueshëm për shlyerjen e detyrimit nga debitori, konformë nenit 519 të K. Pr. Civile, që do të thotë se IVMT-ja nuk ka informacion nga zyrat përmbaremore mbi ecurinë e ekzekutimit për shlyerjen e detyrimit nga debitorët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 246-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1 Rekomandimi: IVMT-së Bashkia Durrës, që ndjek zbatimin e ekzekutimit të vendimeve, të kërkojë informacion nga Zyra Përmbaremore për ecurinë e ekzekutimeve të detyrimit që kanë debitorët dhe vënien në “Ekzekutim të Detyrueshëm” të Titullit Ekzekutiv, për shlyerjen e detyrimeve nga subjektet (debitorët).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit u konstatua se gjatë vitit 2023 janë vendosur 127 (njëqind e njëzet e shtatë) masa administrative, vendim me gjobë, në shumën 38,350 mijë lekë dhe janë likuiduar 4,850 mijë lekë dhe mbeten për likuidim 33,500 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 janë vendosur 150 (njëqind e pesëdhjetë) masa administrative, vendim me gjobë, në shumën 41,141 mijë lekë dhe janë likuiduar 5,150 mijë lekë dhe mbeten për likuidim 35,991 mijë lekë. Nga IMT Bashkia Durrës janë depozituar 27 kërkesa për vënie në ekzekutim, për vitin 2023 dhe 5 kërkesa për vitin 2024, në zyrën e përmbaremit shtetëror Durrës, nga të cilat është arkëtuar shuma 150,000 lekë për 3 (tre) masa administrative, vendim me gjobë.

IMTV nuk disponon raporte periodike mbi fazat e ekzekutimit të vendimeve të dërguara pranë ZP Shtet Durrës. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IVMT, u konstatua se në 31 raste që kjo strukturë i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Durrës për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit”, për arkëtimin e shumave të detyrimeve, nuk është kërkuar kamatë vonese bazuar në masën e gjobës, në kundërshtim me nenin 30, pika 1/a të Ligjit Nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 246-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

23.1. Rekomandimi: IVMT Bashkia Durrës të marrë masa që në kërkesat drejtuar Gjykatës Administrative për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit” për arkëtimin e shumave të detyrimeve, të kërkojë edhe kamatë vonesat, bazuar në masën e gjobës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, u konstatua se gjatë periudhës 2023-2024 në 10 (dhjetë) raste nuk është kërkuar kamatëvonesë bazuar në masën e gjobës sipas parashikimeve ligjore. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.*

Statusi: Pa zbatuar

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave në Bashkinë Durrës, u konstatua se për kategorinë “Të ardhurat e trashëguara” ky institucion nuk ka një listë analitike për evidentimin e këtij lloji të ardhurash por është vetëm vlera totale në kontabilitet. Kjo e bën të pamundur verifikimin e burimit nga është krijuar kjo e ardhur (e ardhura e trashëguar) e si pasojë nuk jep mundësinë për të kontrolluar mënyrën e përdorimit të tyre. Për vitin 2022, nuk ka evidenca të sakta për llojin e të ardhurave (të trashëguara) të cilat do të shërbejnë si bazë për destinimin e tyre në shpenzime (procesin e buxhetimit). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin nr. 68/2017, datë 18.05.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pikat 2, 3, 10, 11, neni 5 germa “e”, neni 12 pika 4, neni 13 pikat 1, 8, nenet 14-20, nenet 33-36; Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, neni 63 pika ç, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 22/5, pika 3, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës, të marrë masa që të ardhurat e papërdorura gjatë vitit buxhetor dhe që trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës, të kontabilizohet sipas burimit të krijimit të tyre. Në çdo rast të bëhet kontabilizimi i plotë, i saktë dhe në kohë i llogarive, shoqëruar me një listë analitike për evidentimin e këtij lloji të ardhurash.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin 24.1 për të ardhurat e papërdorura të trashëgohen sipas burimit të krijimit, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Referuar informaciont të përcjellë në fund të vitit buxhetor kur trashëgohen të ardhurat nuk ndahen sipas burimit të krijimit(taksas dhe tarifës) por kalojnë në zërin të ardhura të veta të papërdorura. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.*

Statusi: Pa zbatuar

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore u konstatua se ndërthurja e veprimtarisë së DTTV Durrës me sistemin e menaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në 5 komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem. “Përdoruesit” organizohen dhe funksionojnë vetëm sipas kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara në pozicionin e miratuar në strukturën organizative dhe si kuadër rregullator përdorin detyrat dhe kompetencat e miratuara në rregulloren e brendshme të institucionit.

- Nuk ka informacion mbi veprimtarinë e kryer në sistem nga jashtë rrjetit të brendshëm të institucionit. Nga intervistat me stafin e Bashkisë Durrës konstatohet se persona jashtë strukturës

organizative të kësaj Bashkie, pa një urdhër apo kontratë kanë akses në këtë sistem pa një protokollim të veprimtarisë dhe procesojnë procese të rëndësishme si gjenerim i detyrimeve në sistem apo delegim dhe ndryshim kompetencash për përdoruesit etj. Rezultojnë veprime në sistem jashtë orarit zyrtar. Nuk ka informacion të saktë për identifikimin e 3 përdoruesve “1130”, “1210” dhe “-1”.

- Informacionit i Sistemit të manaxhimit të të dhënave nuk përputhet me evidencat zyrtare mbi të cilat DTTV planifikon dhe raporton.

- Struktura e kategorizimit të sistemit për bizneset dhe popullatën është e ndryshme nga paketa fiskale e miratuar.

- Numri i subjekteve të evidentuara në sistem sipas statusit (Aktiv, Mbyllur, Pasiv, Pezulluar) është i ndryshëm nga evidencat e DTTV .

- Raportet që prodhon ky system dhe që përpunohen më pas në formatin Excel nga sektorët për të ndërtuar evidenca nuk protokollohen.

- Nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis raporteve të gjeneruara nga sistemi me formatet e përpunuara në Excel nga operatorët.

- Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk rakordojnë me DTTV lidhur me:

- Realizimet e të ardhurave për të cilat kanë përgjegjësi që ti menaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 160, datë 23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”.

- Kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Durrës për informacion, sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5...., neni 11,...; Udhëzimi e MFE nr. 8, datë 9.3.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika ç ; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores për *Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*” i ndryshuar, Manuali për MFK i miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III. Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Durrës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të bashkisë, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e sistemit, përshkrimin e proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem (të hartohet manuali i proceseve të punës, harta e proceseve të punës, gjurmët e auditimit, regjistri i riskut), bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës.

Referuar rekomandimit të mësipërm dhe auditimit të pikës 2.6 të programit të auditimit konkludojme si mëposhtë.

Gjatë vitit 2024 sistemi i taksave dhe tarifave vendore është menaxhuar me shërbim të jashtëm dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka akses të kufizuar në sistem, ndërkohë kodi në burim duhet të jënë në posedim nga Bashkia Durrës dhe jo nga kompania e shërbimit.

Vazhdon të ketë moskuadrim të numrit të subjekteve në sistem me evidencat përkatëse të DTTV.

Gjatë vitit 2023-2024 nuk është hartuar rregullore për funksionimin e sistemit dhe manualët e punës në sistem. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore u konstatua se:

-Bashkia Durrës nuk ka krijuar strukturën vendore të apelimit tatimor (komisioni i apelimit tatimor dhe rregullorja për funksionimin e tij) e cila shërben për apelim të akteve vendore që lidhen me taksat dhe tarifave vendore.

-Nuk realizohet në kohë njoftimi i subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore pasi përlllogaritja dhe azhurnimi i detyrimeve vjetore në sistem bëhet manualisht. Mungon një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe Biznes (*nuk përdoren metoda alteranative “e-mail” për njoftimin e tatimpaguesve*). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 23, 27, 28, 30, 32, 36, 38,... neni 64 pika 3; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, në nenin 7, Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportele”, Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

26.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe DTTV të marrë masa për të krijuar strukturën vendore të apelimit si dhe optimizimin e arkitekturës së sistemit lidhur me përditësimin e detyrimeve vjetore në mënyrë që njoftimi i subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore të bëhet në kohë, me qëllim ndjekjen e të gjitha etapave administrative dhe procedurale për mënjanimin e pasojave që mund të sjellin efekte financiare.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës.*

Me urdhër nr.53, datë 28.02.2024 është ngritur Komisioni Vendor i Apelit Tatimor pranë Bashkisë Durrës.

Statusi: Zbatuar plotësisht

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë të “Sistemit Të Menaxhimit të të Dhënave për të Ardhurat” në Bashkinë Durrës u konstatua se Bashkia Durrës ka krijuar dhe administron “Bazë të dhënash shtetërore” e cila nuk është krijuar dhe nuk e kryen funksionin bazuar në kuadrin rregullator në fuqi. Ky institucion nuk ka paraqitur kërkesë për regjistrimin në “Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore” pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vijim (AKSHI), i cili është autoriteti rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore” nenin 3, Ligjin nr. 2/2017, datë 26.01.2017, “Për sigurinë kibernetike” neni 4; Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” Kreun II “Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar” nenet 2, 3, 5, 6...20...27,28...; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” i ndryshuar; Vendimin nr. 710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, (ndryshuar me VKM nr. 755, datë 26.10.2016); Kreun II, pikën k, të Vendimit nr. 673,

datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, (ndryshuar me VKM nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 88, datë 14.02.2018; nr. 448, datë 26.7.2018; nr. 872, datë 24.12.2019); pikën 4, “Kërkesat e sigurisë” shkronja b, të “Rregullores për Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; pikën 4, germa a, të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digitale në administratën publike”, miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT); *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për regjistrimin në “Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore” pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), të ndërtojë programin e sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të tij, konkretisht, mjedisin i sigurisë së informacionit, vlerësimin e riskut, politikat e sigurisë, organizimi i sigurisë së TIK, menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, menaxhimi i aseteve, siguria e burimeve njerëzore, siguria fizike dhe mjedisore, kontrolli i aksesit, menaxhimi i incidenteve të sigurisë së tik, menaxhimi i vazhdueshmërisë së aktivitetit të njësisë dhe përputhshmëria.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e Bashkisë Durrës nuk është marrë asnjë masë për rregjistrimin në “Regjistrin Kombëtar të Bazës së të dhënave Shtetërore”. Sa më sipër rekomandimi nuk është zbatuar.*

Statusi: Pa zbatuar

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura e teknologjisë së informacionit (TI) nuk organizohet në nivel drejtorie. Për administrimin e sistemeve që përdor kjo bashki, specifikisht për sistemin e përmendur më sipër *nuk ka një person përgjegjës të autorizuar (marrësi në dorëzim i kodit të burimit) për administrimin e bazës së të dhënave. Shërbime të ndryshme në këtë bazë të dhënash kryhen nga personel që nuk është pjesë e strukturës organizative të personelit të Bashkisë Durrës apo në marrëdhënie kontraktuale me Bashkinë.*

Nuk ka auditues me profil të teknologjisë së informacionit për të zhvilluar burimet njerëzore të auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit. Nuk janë planifikuar, kryer misionet auditimi mbi sistemet e TI-së duke mos përmbushur kriteret e Manualit të Auditit të Brendshëm të miratuara me urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 pika 2.4.4. Këto veprime janë në mospërputhje me Manualin e Auditit të Brendshëm të miratuara me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, pika 2.4.4 dhe Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore” neni 2 dhe 5 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Durrës, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme, të analizojnë mundësinë e ndryshimeve të strukturës ekzistuese IT, me qëllim rritjen e rolit të saj dhe të marrin masa për ngritjen në nivel të strukturës së IT nga nivel sektori në nivel Drejtorie. Të caktohet një person përgjegjës i autorizuar (marrësi në dorëzim i kodit të burimit) për administrimin e bazës së të dhënave. Të merren masa që sistemi të përfshijë në arkitekturën e tij procesin e auditimit dhe analizës së të dhënave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës.*

Referuar rekomandimit të mësipërm dhe auditimit të pikës 2.6 të programit të auditimit konkludojme si mëposhtë.

Gjatë vitit 2024 sistemi i taksave dhe tarifave vendore është menaxhuar me shërbim të jashtëm dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka akses të kufizuar në sistem, ndërkohë kodi në burim duhet të jetë në posedim nga Bashkia Durrës dhe jo nga kompania e shërbimit.

Në lidhje me ndryshimet e strukturës së IT referuar rekomandimit të mësipërm me vendimin nr.41, datë 15.04.2024 është ndryshuar struktura e Drejtorisë së Informatikës dhe Dixhitalizimit e cila përbëhet nga 2 sektorë.

-Sektori i Informatizimit

-Sektori i Dixhitalizimit të Shërbimeve

Statusi: Në proces zbatimi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i “Regjistrir Elektronik të Subjekteve” pranë DTTV , u konstatua se popullimi i sistemit me kërkesa për regjistrim të subjekteve të reja, ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese realizohet pa rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB, me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.

- Akt konstatimet e mbajtura nga sektori i terrenit nuk japin informacione për përputhjen midis llojit të të dhënave që kërkohet të ndryshohen dhe të dhënave që administrohen në sistem apo në dosjen e subjektit pranë DTTV.

- Në sistem janë konstatuar raste ku subjekti ka gjendje debitore në kodin seli apo në kodet që i përkasin adresave dytësore dhe nga DTTV nuk konstatohen evidenca të ndjekjes së procedurës ligjore për mbledhjen e debisë së tyre.

- DTTV Durrës për të gjitha rastet kur statusi ka ndryshuar (*çregjistrim, pasiv apo pezullim*) ka ndërprerë faturimin e mëtejshëm të subjektit edhe pse ky çregjistrim ka ardhur si pasojë e mos përgjigjes në kohë ndaj kërkesës për evidentimin e gjendjes debitore nga QKB.

-Nga evidencat e trajtuar në DTTV nuk u paraqit asnjë dokument mbi rakordimin me degët rajonale të tatimeve lidhur me klasifikimin e biznesit dhe llojin e aktivitetit që kryen.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, neni 5, neni 11,...; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “*Për sistemin e taksave vendore*” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “*Për regjistrimin e biznesit*” i ndryshuar, nenet 28-40, neni 42, neni 43 germa d, neni 59; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe kontrollit, VKB nr. 160, datë 23.12.2021, “*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit*”; Rregulloren e brendshme të bashkisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

29.1 Rekomandimi: Drejtoria e TTV të rakordojë informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT Durrës.

Akt konstatimet e mbajtura nga sektori i kontrollit në terren të realizohen konformë kuadrit rregullator ligjor, brenda afateve të përcaktuara në ligj dhe të përllogariten detyrimet tatimore bazuar në paketën fiskale të miratuar në vite

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës.

Referuar rekomandimit të mësipërm dhe auditimit të pikës 2.6 të programit të auditimit u audituan kërkesat e ardhura nga QKB për ndryshimet e statusit të biznesit. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka të angazhuar 1 (një) punonjës i cili kthen përgjigje elektronike dhe shkresore QKB për miratimin e kërkesave. Nga sektori i kontrollit në terren duke ju referuar numrit të lartë të biznesit në Bashkinë Durrës rreth 13,000 subjekte privatë dhe numrit të ulët të inspektorëve të terrenit jo për të gjithë kërkesat është zbatuar afati ligjor për verifikimin në terren nga inspektorët. Për vitin 2024 kërkesat për mbyllje për subjektet me detyrime nuk është proceduar me mbyllje nga QKB.

Statusi: Në proces zbatimi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për të gjithë periudhën e audituar taksa mbi tokën bujqësore nuk është administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kundërshtim me përcaktimet e bërë në paketën fiskale.

Për këtë taksë nuk ka regjistër të taksapaguesve. Për kategorinë “familjar” edhe pse është parashikuar në paketë fiskale që të arkëtohet nga UKD, kjo nuk është realizuar as nga UKD dhe as nga vetë bashkia, pasi vetë struktura e taksave të bashkisë për mungesë të dhënash si të familjarëve edhe të sipërfaqes për secilën familje, nuk ka bërë llogaritje të detyrimeve për këtë taksë dhe si rrjedhim, ngarkesa në faturën e ujit, nuk është kryer.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë. 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar ,neni 4 , neni 23; Paketa fiskale e miratuar nga Këshilli Bashkiak Durrës; VKB nr. 160, datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, pika A.1.1.2 “Taksa e tokës bujqësore”. kontrata nr. 641 prot., datë 03.02.2014. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

30.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e regjistrit të taksapaguesve privat dhe familjar për taksën e tokës bujqësore, duke evidentuar qytetarët të cilët kanë marrë tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saj, në hektar për secilin dhe mbi bazën e këtij regjistri të llogariten dhe të arkëtohen detyrimet për taksën e tokës bujqësore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk është marrë asnjë masë për hartimin e regjistrit privat dhe familjarë për taksën e tokës bujqësore. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.*

Statusi: Pa zbatuar

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i DTTV Durrës u konstatua se në këtë subjekt nuk ka një strategji afatshkurtër apo afatmesme, për të evidentuar familjet e paregjistruara te agjenti tatimor UKD, në mënyrë që të ndiqet arkëtimi i tyre jashtë agjentit tatimor, pra nga vetë administrata e taksave dhe tarifave vendore Durrës. DTTV nuk ka hartuar regjistër të taksapaguesve familjarë, duke mos evidentuar taksapaguesit familjarë, të cilët nuk kanë marrëdhënie me agjentin tatimorë.

Edhe pse numri i taksapaguesve familjar në vitin 2022 është rritur, nuk ka evidencime konkrete për pjesën që nuk përfshihet në UK Durrës.

Për vitin 2022 janë arkëtuar 90,840,468 lekë, ndërsa në sistem të ardhurat familjare janë 74,509,044 lekë.

Diferenca midis sistemit të DTTV dhe të ardhurave të arkëtuara nga UKD ka edhe për vitin 2021.

Sa më sipër nuk është zbatuar kontrata nr. 641 prot. datë 03.02.2014, neni 5 pika 4,5,6 dhe neni 7 pika 1, pika c.

Nga Bashkia Durrës nuk janë zbatuar penalitete bazuar në nenin 7, pika 2 të marrëveshjes, ku për shkeljet e mësipërme të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative nuk janë vendosur gjoba në mbështetje të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7; Kontrata nr. 641 prot. datë 03.02.2014, neni 5 pika 4,5,6, neni 7 pika 1 dhe 2; Rregullore brendshme e institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

31.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të hartojë një program pune për evidentimin e të gjitha taksapaguesve familjar, si dhe të evidentohen familjet e pa regjistruara të

agjenti tatimor UKD, të rakordohet periodikisht me agjentin tatimor në përputhje me kushtet e kontratës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk dokumentohet procesi i evidentimit të abonentëve familjarë të cilët nuk kanë 1 (një) kontratë me UKD. Gjatë vitit 2023-2024 edhe për abonentët të cilët kanë 1 (një) kontratë me UKD ka pasur problematika për rakordimin e abonentëve familjarë sepse nuk ka funksionuar sistemi. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i paketës fiskale për vitin 2022 rezultojnë mungesa sipas kategorizimeve për nënkategoritë e taksave/ tarifave dhe përjashtimet nga detyrimi për tu krahasuar me paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Durrës.

Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj në sistemin e DTTV nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacion shoqërues (sipas kërkesave në formularët për aplikim të miratuar nga bashkia Durrës). Procesi për përlllogaritjen e detyrimeve sipas Paketës Fiskale nuk është i saktë.

Planifikimi për Taksa dhe tarifa vendore të cilat janë burimi kryesor në realizimin e të ardhurave të veta nuk është kryer bazuar në numrin e subjekteve sipas sistemit, analizën e rezultatit historik, pritshmërive të vitit korrent dhe koordinimit midis drejtorive që mbulojnë realizimin e tyre.

Në paketën fiskale të Bashkisë Durrës nuk janë parashikuar taksa dhe tarifa vendore të përcaktuara për pajisjet automatike (Edhe pse janë të identifikueshme) të cilat kanë aktivitet dhe gjenerojnë të ardhura si: ATM, pajisje elektronike, lojëra për fëmijë, ekranet dixhitale të reklamimit, karikues për mjetet lëvizëse etj., (që janë të vendosura në hapësira publike apo biznes privat, pranë institucioneve të ndryshme etj).

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, Neni 2 pika 13, Neni 2 pika 16, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7; Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1 Rekomandimi: Drejtoria e TTV të marrë masa për rishikimin dhe saktësimin e regjistrimit të taksapaguesve kategoria biznes, duke përshtatur kategorinë/nënkategorinë me “Veprimtarinë” që ushtron, në mënyrë që përlllogaritja e detyrimeve të bëhet e saktë sipas parashikimeve në Paketën Fiskale. Të rishikohet paketa fiskale duke parashikuar taksa e tarifa për të gjitha kategoritë e biznesit që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u verifikua se regjistri i taksapaguesve kategoria biznes ka problematika si mëposhtë:

1-Ngarkesa fiskale e taksapaguesve biznes kryhet në mënyrë manuale dhe jo automatike në tabelën e mëposhtme jepet informacion për numrin e bizneseve të pa ngarkuara me taksa dhe tarifa vendore.

Lloji i Taksës	Viti	Faturimi		Nr i Biznesve aktiv në sistem	Diferenca regjistër me sistemin
		Nr	Vlerë		
Taskë ndërtesë	2024	9,385	286,680,731	13,748	4,363
Tarifë Pastrimi	2024	11,535	187,847,887	13,748	2,213
Tarifë ndriçimi	2024	11,470	36,151,421	13,748	2,278
Tarifë Gjelbërimi	2024	11,397	38,682,211	13,748	2,351

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i korrespondencave zyrtare ndërmjet institucioneve në shkresat me objekt: *“Kthim përgjigje”* institucionit të QKB, *“Informacion periodik për subjektet të cilët aplikojnë për pezullim ose mbyllje”* u konstatua se:

Në 211 (dyqind e njëmbëdhjetë) raste shkresat kanë kaluar afatin kohor ligjor të dërgimit të kthimit të përgjigjeve.

Në 29 (njëzet e nënte) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim në QKB rezultoi se nuk janë regjistruar në sistemin e DTTV, e për pasojë nuk janë llogaritur detyrime për taksa e tarifa vendore që nga data e regjistrimit të tyre në QKB si biznes.

-Në 16 (gjashtëmbëdhjetë) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim në QKB rezultoi se, nga QKB janë çregjistruar, ndërsa në sistemin e DTTV rezultojnë debitor, pasi Sektori i kontrollit në terren pranë DTTV nuk i ka kthyer përgjigje QKB;

-Në 4 (katër) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim në QKB rezultoi se janë mbyllur në sistemin e DTTV, ndërsa në QKB rezultojnë me statusin aktiv.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, neni 5, neni 11,...; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, *“Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë”* (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të koordinojë punën me institucionet e ndërlidhura, me qëllim marrjen dhe dhënien e informacioneve në kohë reale për shmangien e problematikave të konstatuara.

-Të kryejë inventarizimin e të gjithë subjekteve të cilët janë objekt i taksave vendore, plotësimin e një regjistri me të dhënat përkatëse dhe duke plotësuar dosjet e subjekteve me dokumente që informojnë në mënyrë kronologjike veprimtarinë e tatimpaguesit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u verifikua se nga shkresat e ardhura nga QKB jo në të gjitha rastet është respektuar afati kohor nga sektori i terrenit për të verifikuar subjektin në terren. Nga zyra e regjistrimit është kthyer në kohë përgjigja për bizneset me kërkesë *“mbyllje”* me detyrim në sistem”.

Statusi: Në proces zbatimi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të tregjeve bashkiake që operojnë në Bashkinë Durrës u konstatua se: Në adresën *“L.12 Rr.K.Kazanxhi te tregu fshatar”* në objektin *“Ndërtesë”* me kodi në sistem nr. 96468 me administrator F.Z, ushtrohet aktiviteti *“Treg Agrobujqësor”*. Sipas informacionit nga Administrata e Tregut Agrobujqësor rezultoi se ky aktivitet zhvillohet në një sipërfaqe afërsisht 350 m² dhe brenda kësaj sipërfaqe zhvillon aktivitet tregu fruta perime që administrohet nga OE *“A.A.”* Shpk, me 73 banakë të pa regjistruar në sistemin e taksave dhe nuk është ngarkuar detyrimet përkatëse. Sa më sipër veprimet nuk janë në përputhje me , ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar; ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar; VKB nr.160, datë 23.12.2021 *“Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”*, pika A.2.6.3 *“Tarifa për sipërfaqe të tregut në administrim të Bashkisë Durrës”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

34.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës, DTTV të marrë masa për identifikimin, verifikimin dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet brenda këtij tregu pa licencat përkatës dhe pa paguar detyrimet për taksa dhe tarifa vendore sipas paketës fiksale.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga DTTV është identifikuar lista e tregtarëve në tregun A...A sipas banakëve që kanë në përdorim dhe është vijuar me regjistrimin ngarkesën fiskale referuar paketës fiskale në fuqi.

Statusi: Në proces zbatimi

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 5 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit me objekt “Sistemim KUB në rrugën “Taulantia”, “Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House”, “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1 + Loti 2)” dhe “Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501”, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit, apo të paargumentuara teknikisht, në mospërputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

35.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i procedurave të zhvilluara gjatë periudhës objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2024, rezultoi se nga AK Bashkia Durrës nuk janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi, pasi vijon të mbetet problem përcaktimi i kriterëve jo në përputhje me tipologjinë e procedurës si dhe kriteret të paargumentuara, të cilat pengojnë ose bëjnë shkak për mos pjesëmarrje dhe skualifikimin e OE me cmim më të levdishëm. Për këtë rekomandim i cili rezulton i pazbatuar, nuk do kërkohet rizbatim pasi do evidentohet si gjetje dhe rekomandim në auditimin aktual që po kryhet për periudhën 2023 - 2024.

Statusi: Pa zbatuar

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në 5 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit me objekt “Sistemim KUB në rrugën “Taulantia”, “Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House”, Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), Njësitë Administrative Nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth dhe Manëz (Loti 1 + Loti 2) dhe “Riforcimi i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501”, në vlerën totale të fondit limit prej 524,304,287 lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

36.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e Titullarit të AK, nuk janë marrë masa për analizimin e situatës, për nxjerrjen e përgjegjësisë ndaj personave përgjegjës në vlerësimin e gabuar të procedurës. Për këtë rekomandim i cili rezulton i pazbatuar, nuk do kërkohej rizbatim pasi do evidentohet si gjetje dhe rekomandim në auditimin aktual që po kryhet për periudhën 2023 - 2024.

Statusi: Pa zbatuar

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së shërbimit nr. 9853/8 prot., datë 08.10.2021, me objekt “Depozitimi i mbetjeve urbane”, Bashkia Durrës, me vlerë të kontratës (pa tvsh) 281,508,800 lekë, realizuar nga OE “I.E.” (për 12 muaj), rezultoi se:

- Në kontratë nuk ekzistojnë specifikime teknike të detajuara, nuk ka një peshore dhe persona përgjegjës për peshimin e mbetjeve para transportit për në Landfill-in e Sharrës, veprime që krijojnë hapësira dhe mbartin riskun për shifra fiktive të ardhura nga Furnizuesi dhe për pagesa të pajustificuara.

- Për realizimin e procesit të plotë të pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane, në planifikimin e shpenzimeve për vitin 2022, shpenzimet e planifikuara për menaxhimin e mbetjeve urbane janë 683,591,000 lekë, pa depozitimin e mbetjeve në Landfillin e Sharrës ose 1,038,724,000 lekë duke përfshirë edhe depozitimin e cila përbën 14% të buxhetit të Bashkisë Durrës në vlerën 7,038,724,000 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

37.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa të menjëhershme për:

- Gjetjen e rrugëve ligjore për amendimi e kontratës në lidhje me specifikimet teknike të detajuara, si dhe për gjetjen e zgjidhjes për peshimin e mbetjeve para transportit për Landfillin e Sharrës me qëllim kryerjen e pagesave sipas shërbimit real të këtij procesi jetik për qytetarët.

- Ngritjen e një grupi pune për studimin e fizibilitetit të shërbimit të pastrimit të qytetit dhe depozitimit të mbetjeve urbane, i cili me mbarimin e kontratës aktuale të depozitimit të mbetjeve të shërbejë si bazë për të gjetur rrugët alternative për procesin e plotë të menaxhimit të mbetjeve (pastrim dhe depozitim), që ky shërbim të jetë cilësor dhe me kosto sa më të ulët me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 37.1 për zbatimin e kontratës së shërbimit nr. 9853/8 prot., datë 08.10.2021, me objekt “Depozitimi i mbetjeve urbane”, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Në lidhje me peshimin e mbetjeve para transportit në landfillin e Sharrës nuk është marrë ndonjë masë, mbetjet vazhdojnë të peshohen vetëm në peshoren elektronike të shoqërisë “I.E.”.

Sipas rekomandimit 37.1 shprehet se pasi të mbarojë kontrata për mos të shtuar kostot me prishjen e kontratës para kohe e cila mund të sjelli krijim detyrime sipas kushteve të kontratës është kërkuar të kryhet një studim fizibiliteti për të patur një shërbim sa më cilësor dhe me kosto më të ulta. Dokumentacioni i dorëzuar nga Bashkia Durrës për zbatimin e këtij rekomandimi i përket zbatimit të kontratës aktuale.

Nga Bashkia Durrës nuk janë marrë masat për të ngritur një grup pune me qëllim studimin dhe efektivitetin e shërbimit të pastrimit.

Statusi: Pa zbatuar

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës për dhënie me qira të sipërfaqeve funksionale të tregut Agrobujqësor, u konstatua se kontrata e qirasë lidhur midis Bashkisë Durrës dhe OE “A.A.” shpk, sipërfaqja e zënë nga ky subjekt e tejkalon sipërfaqen e marrë me qira duke mos respektuar

kontratën e lidhur me Bashkinë Durrës sa i përket përcaktimeve në nenin 2 pika 2.1 “Qëllimi i përdorimit të kontratës”. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies të qirave të Enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

38.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës (Sektori i pronave dhe i Kontrollit), të marrë masa për verifikimin e sipërfaqes së zënë më tepër nga subjekti “A.A.” shpk, të përllogarisë diferencën dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për vjeljen e detyrimit të krijuar, si dhe të kërkojë lirin e sipërfaqes së zënë më tepër.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës. Nga DTTV është vendosur në dispozicion planimetria e objektit të dhënë më qira me sipërfaqe ndërtimi 162.6 m². Janë kryer matjet në terrën dhe është hartuar planrilevimi nga specialisti gjeodet ku është konstatuar sipërfaqe ndërtimore 162.6 m².

Statusi: Zbatuar plotësisht

39. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i ankesës së shtetasit K.K, në lidhje me ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë protokolluar në KLSH, me nr.587/3 prot., datë 20.09.2023, u konstatua se Bashkia Durrës, përfaqësuar nga titullari institucionit, si personi i ngarkuar nga ligji, nuk ka kryer ekzekutimin e Vendimit të Shërbimit Civil nr. 169 datë 20.12.2010, lënë në fuqi me Vendimin gjyqësor nr. 14, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës. për të paguar në favor të palës kreditore deri në Gusht 2023 shumën 7,980,855 Lekë.

-Nga auditimi i ankesës së shtetasit Gentian Karruli në lidhje me ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor të Formës së Prerë, protokolluar në KLSH, me nr.884 prot., datë 09.10.2023, u konstatua se Bashkia Durrës, përfaqësuar nga titullari institucionit, si personi i ngarkuar nga ligji, nuk ka kryer ekzekutimin e Vendimit nr. 3289, datë 26.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë për të paguar në favor të palës kreditore deri në dhjetor 2022 shumën 7,457,014 Lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 142/3, neni 42/2; K.Pr.Civile, neni 451/a, neni 500, neni 609, neni 615; Kodin civil, neni 112; Udhëzimin nr. 1, Datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit’ pika 2; Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së presë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 306-319 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

39.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për shtetasit K.K dhe Gentian Karruli dhe të shmangin në të ardhmen ndjekjen e procedurave të gabuara për çështjet e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 39.1 për zbatimin e vendimeve gjyqësore për K.Kn dhe Gentian Karruli gjatë vitit 2024 janë likuiduar shumat si mëposhtë:

-Me urdhër shpenzimi nr.551, datë 14.06.2024 është likuiduar shuma 7,362,417 lekë për K.Kn.

-Me urdhër shpenzimi nr.1045, datë 02.10.2024 është likuiduar shuma 2,500,000 lekë për Gentian Karrullin.

Statusi: Zbatuar plotësisht

C. Masa për Shpërblim Dëmi

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “FV Ndriçimi rruga Neki Libohova dhe “Marta Durda”, Bashkia Durrës, me vlerë 10,306,880 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve OE “A.O.” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **552,966 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1801/6 prot., datë 09.09.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE “A.O.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **552,966 lekë pa TVSH** nga OE “A.O.” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1801/6 prot., datë 09.09.2022, me objekt “FV Ndriçimi rruga Neki Libohova dhe “Marta Durda”, Bashkia Durrës”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 1.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Kryetari i Bashkisë Durrës ka lëshuar urdhrin nr.258, datë 24.07.2024, prot 946/17, “Për marrjen e masave për shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike i ka dërguar shkresë subjektit nr.946/24 prot, datë 22.10.2024 për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të krijuar ndaj Bashkisë Durrës. Përveç njoftimit nuk janë marrë masa të tjera nuk është kryera pagesa.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “FV Ndriçimi rruga “Shoqëria Bashkimi”, “Aleks Komeni”, “Krisaq Boshnjaku”, “Paskal Prodani”, Bashkia Durrës, me vlerë 8,679,007 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve OE “S.N.” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **358,131 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1797/13 prot., datë 14.06.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE “S.N.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **358,131 lekë pa TVSH** nga OE “S.N.” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1797/13 prot., datë 14.06.2022, me objekt “FV Ndriçimi rruga “Shoqëria Bashkimi”, “A.K”, “K.B”, “P.P”, Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 2.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Kryetari i Bashkisë Durrës ka lëshuar urdhrin nr.258, datë 24.07.2024, prot 946/17, “Për marrjen e masave për shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike i ka dërguar shkresë subjektit nr.946/23 prot, datë 22.10.2024 për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të krijuar ndaj Bashkisë Durrës. Operatori Ekonomik “S.N” SHPK ka kryer pagesën në shumën 358,131 lekë datën 15.11.2024.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Riforcim godine banimi 12 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga Neki Libohova” nr.70, kod GIS 5061, 5063”, Bashkia Durrës, me vlerë 204,334,356 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i

punimeve BOE “E.B” SHPK & “LL.O” ShPK & “E.N” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **1,118,965 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3638/2 prot., datë 01.06.2021, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe BOE “E.B” SHPK & “LL.O” ShPK & “E.N” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,118,965 lekë pa TVSH** nga BOE “E.B” SHPK & “LL.O” ShPK & “E.N” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3638/2 prot., datë 01.06.2021, me objekt “Riforcim godine banimi 12 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga Neki Libohova” nr.70, kod GIS 5061, 5063”, Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 3.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Kryetari i Bashkisë Durrës ka lëshuar urdhrin nr.258, datë 24.07.2024, prot 946/22, “Për marrjen e masave për shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike i ka dërguar shkresë subjektit nr.946/23 prot, datë 22.10.2024 për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të krijuar ndaj Bashkisë Durrës. Përveç njoftimit nuk janë marrë masa të tjera nuk është kryera pagesa.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Përforcimi i terrenit nga rrëshqitja e dherave në zonën e ndodhur në lagjen nr. 10, në kodrën pranë Currilave, nga ana veriore dhe perëndimore të saj”, Bashkia Durrës, me vlerë 10,320,229 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve OE “N.A”, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **298,400 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1574 prot., datë 24.03.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE “N.A”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **298,400 lekë pa TVSH** nga OE “N.A”, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1574 prot., datë 24.03.2022, me objekt “Përforcimi i terrenit nga rrëshqitja e dherave në zonën e ndodhur në lagjen nr. 10, në kodrën pranë Currilave, nga ana veriore dhe perëndimore të saj”, Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 4.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Kryetari i Bashkisë Durrës ka lëshuar urdhrin nr.258, datë 24.07.2024, prot 946/22, “Për marrjen e masave për shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike i ka dërguar shkresë subjektit nr.946/23 prot, datë 22.10.2024 për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të krijuar ndaj Bashkisë Durrës. Operatori Ekonomik “N.A” ka kryer pagesën në datën 24.07.2024 shumën 298,400 lekë, Banka Raiffeisen numër mandati P240724ACKQOP14.

Statusi: Zbatuar plotësisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksioni rruga Ali Pashë Tepelena, At Gjergj Fishta dhe Migjeni”, Bashkia Durrës, me vlerë 9,853,620 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve OE “B.A” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **161,138 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 306 prot., datë

13.01.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE “B.A” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **161,138 lekë pa TVSH** nga OE “B.A” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 306 prot., datë 13.01.2022, me objekt “Rikonstruksioni rruga Ali Pashë Tepelena, At Gjergj Fishta dhe Migjeni”, Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 5.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Kryetari i Bashkisë Durrës ka lëshuar urdhrin nr.258, datë 24.07.2024, prot 946/22, “Për marrjen e masave për shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Operatori Ekonomik “B.A” SHPK ka kryer pagesën në datën 28.06.2024 shumën 161,138 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksioni rruga “Azem Hajdari - Migjeni” NjA Rrashbull, Bashkia Durrës, me vlerë 8,719,716 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve BOE “V.E” ShPK & “S.F” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **135,096 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7842/6 prot., datë 25.11.2021, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe BOE “V.E” ShPK & “S.F” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **135,096 lekë pa TVSH** nga BOE “V.E” ShPK & “S.F” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 7842/6 prot., datë 25.11.2021, me objekt “Rikonstruksioni rruga “Azem Hajdari - Migjeni” NjA Rrashbull, Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 6.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Kryetari i Bashkisë Durrës ka lëshuar urdhrin nr.258, datë 24.07.2024, prot 946/22, “Për marrjen e masave për shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Operatori Ekonomik “V.E” Shpk & S.F ka kryer pagesën në datën 22.02.2024 shumën 135,096 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion rruga Currila, segmenti hotel Ferrara-Guest House”, Bashkia Durrës, me vlerë 27,887,100 me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve OE “B.I”, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **170,200 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3473/7 prot., datë 29.08.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës dhe OE “B.I”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **170,200 lekë pa TVSH** nga OE “B.I”, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3473/7 prot., datë 29.08.2022, me objekt “Rikonstruksion rruga Currila, segmenti hotel Ferrara-Guest House”, Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 7.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Kryetari i Bashkisë Durrës ka lëshuar urdhrin nr.258, datë 24.07.2024, prot 946/22, “Për marrjen e masave për shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Operatori Ekonomik “B.I” ka kryer pagesën në datën 25.07.2024 shumën 170,200 lekë. **Statusi: Zbatuar plotësisht**

D. Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1. Gjetje nga auditimi: Në 9 raste, nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe nga Drejtoria Juridike nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë në lidhje me mospagesën e qirasë për sipërfaqen e objekteve pasuri shtetërore **duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumen totale prej 939,832 lekë**, në kundërshtim me kreun VI pika 1 të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6., faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të kërkojnë në rrugë gjyqësore për të gjitha rastet, shlyerjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë në shumen totale prej 939,832 lekë, të shoqëruar me penalitet kamatë ditore prej 0.1% të vlerës së qirasë mujore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 1.1, për shlyerjen e detyrimeve sipas kontratave të qirasë dhe kamatvonesat nga Kryetari i Bashkisë Durrës është lëshuar urdhri nr.260, datë 24.07.2024, prot. 946/19 “Për marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhurat e munguara), në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH”.

1) Subjekti A., kodi (7094) me administrator Altin Zerë referuar rekomandimit të mësipër është pasqyruar debitor për mospagesën e qirasë për një periudhë 6 (gjashtë) mujore me vlerë detyrimi 336,624 lekë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është paraqitur raporti nga sistemi oracle ku janë të detajuara pagesat e qirasë për periudhën janar-dhjetor 2022 ku vlera totale e paguar është 673,428 lekë dhe detyrimi i qirasë mujor është 56,104 lekë/muaj. Kamat vonesa është në vlerën 38,589 lekë e cila është paguar me mandatin nr. ref 514ATHD240360019, datë 05.02.2024.

2) Subjekti I.N, kodi (175734) me administrator Alban Dautaj referuar rekomandimit të mësipër është pasqyruar debitor vlerën 45,000 lekë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është paraqitur raporti nga sistemi oracle ku janë të detajuara pagesat e qirasë për periudhën janar-dhjetor 2022 ku vlera totale e paguar është 540,000 lekë dhe detyrimi i qirasë mujor është 45,000 lekë/muaj. Kamatvonesa është në vlerën 38,589 lekë e cila është paguar me mandatin nr. ref 514ATHD240360019, datë 05.02.2024. Kamatvonesa për vitin 2022 është në vlerën 22,995 lekë dhe është paguar nëpërmjet transfertës bankare nga Credins Bank.

3) Subjekti J.SH, kodi (169268) referuar rekomandimit të mësipër është pasqyruar debitor vlerën 263,700 lekë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është paraqitur raporti nga sistemi oracle ku janë të detajuara pagesat e qirasë për periudhën janar-dhjetor 2022 ku vlera totale e paguar është 279,600 lekë dhe detyrimi i qirasë mujor është 23,300

lekë/muaj.. Kamatvonesa për vitin 2022 është në vlerën 59,654 lekë dhe është paguar nëpërmjet transfertës bankare nga Raiffeisen Bank në datën 09.02.2024.

4) Subjekti L.H, kodi (169414) referuar rekomandimit të mësipër është pasqyruar debitor vlerën 46,000 lekë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është paraqitur raporti nga sistemi oracle ku janë të detajuara pagesat e qirasë për periudhën janar-dhjetor 2022 ku vlera totale e paguar është 279,600 lekë dhe detyrimi i qirasë mujor është 23,300 lekë/muaj. Kamatvonesa për vitin 2022 është në vlerën 59,654 lekë dhe është paguar nëpërmjet transfertës bankare nga Intesa Sanpaolo Bank në datën 14.02.2024.

5) Subjekti D.Z, kodi (1027) referuar rekomandimit të mësipër është pasqyruar debitor vlerën 43,000 lekë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është paraqitur raporti nga sistemi oracle ku janë të detajuara pagesat e qirasë për periudhën janar-dhjetor 2022 ku vlera totale e paguar është 516,000 lekë dhe detyrimi i qirasë mujor është 43,000 lekë/muaj. Kamatvonesa për vitin 2022 është në vlerën 18,533 lekë dhe është paguar sëbashku me faturën e qirasë së muajt shkurt për vitin 2023 nëpërmjet transfertës bankare nga Raiffeisen Bank në datën 15.02.2024 me nr. ref P230215AD6JOP14.

6) Subjekti V.R, kodi (175124) referuar rekomandimit të mësipër është pasqyruar debitor vlerën 28,888 lekë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është paraqitur raporti nga sistemi oracle ku janë të detajuara pagesat e qirasë për periudhën janar-dhjetor 2022 ku vlera totale e paguar është 173,328 lekë dhe detyrimi i qirasë mujor është 14,444 lekë/muaj. Kamatvonesa për vitin 2022 është në vlerën 361 lekë. Gjithashtu subjekti përdor sipërfaqje 77.1 m²

7) Subjekti E.GJ, kodi (157308) referuar rekomandimit të mësipër është pasqyruar debitor vlerën 90,240 lekë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është paraqitur raporti nga sistemi oracle ku janë të detajuara pagesat e qirasë për periudhën janar-dhjetor 2022 ku vlera totale e paguar është 180,480 lekë dhe detyrimi i qirasë mujor është 15,040 lekë/muaj. Kamatvonesa për vitin 2022 është në vlerën 57,061 lekë është paguar pranë Raiffeisen Bank në datën 19.03.2024 me nr. ref 20240319.

8) Subjekti S.M, kodi (101572) referuar rekomandimit të mësipër është pasqyruar debitor vlerën 7,400 lekë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është paraqitur raporti nga sistemi oracle ku janë të detajuara pagesat e qirasë për periudhën janar-dhjetor 2022 ku vlera totale e paguar është 88,800 lekë dhe detyrimi i qirasë mujor është 7,400 lekë/muaj. Kamatvonesa për vitin 2022 është në vlerën 3,123 lekë është paguar pranë Firts Investment Bank në datën 27.05.2024.

Statusi: Zbatuar plotësisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga qiradhënësi Bashkia Durrës është zgjidhur kontrata e qirasë me qiramarrësin Ilir Kapinova, pa bërë më parë pagesën e dy muajve në shumen prej 79,380 lekë të shoqëruar me penalitet kamatë ditore prej 0.1% të vlerës së qirasë mujore, **duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Durrës**, në kundërshtim me neni 6 “Pagesa e Qirasë” e Kontratës së Qirasë lidhur në datë 17.1.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6., faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë juridike, të kërkojë në rrugë gjyqësore pagesën e dy muajve nga qiramarrësi Ilir Kapinova në shumen prej **79,380 lekë**, të shoqëruar me penalitet kamatë ditore prej 0.1% të vlerës së qirasë mujore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 2.1, për shlyerjen e detyrimeve sipas kontratave të qirasë dhe kamatvonesat nga Kryetari i Bashkisë Durrës është lëshuar urdhri nr.260, datë 24.07.2024, prot. 946/19 “Për marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhurat e munguara), në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH”.

1) Subjekti I.K kodi (7774) referuar rekomandimit të mësipër është pasqyruar debitor me vlerë detyrimi 79,380 lekë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është paraqitur njoftimi me nr.1558 prot, datë 30.01.2024 “Njoftim për pagimin e vlerës së qirasë së papaguar prej 96,817 lekë”. Detyrimi është paguar sipas mandateve të bankës si mëposhtë:

-Pagesë në datën 11.06.2024 OTP Bank me vlerë 17,437 lekë me nr. ref 441THES241630006;

-Pagesë në datën 11.06.2024 OTP Bank me vlerë 39,690 lekë me nr. ref 441THES241630002;

-Pagesë në datën 11.06.2024 OTP Bank me vlerë 39,690 lekë me nr. ref 441THES241630004;

Statusi: Zbatuar plotësisht

3. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi u konstatua se Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për taksa dhe tarifa vendore më datën 01.01.2018, ka qenë në vlerën 733,273,353 lekë. Gjatë vitit 2018 për këtë llogari ka pasur pakësime në vlerën 630,083,524 lekë, ndërsa më datë 31.12.2018, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 103,189,829 lekë. Për pakësimin e kryer në vlerën **630,083,524 lekë** e cila i përket detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore, nga Bashkia Durrës nuk administrohet asnjë vendim, shkresë apo dokumentacion për vlerën e pakësuar.

- Nga auditimi i procesit rezultoi se nuk rakordon vlera e detyrimit vjetor të subjekteve në sistemin e DTTV me atë të paraqitur në evidencat për raportim në kontabilitet.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën në mënyrë rastësore 11 subjekte nga sistemi dhe u ndoq procesi i përgatitjes së regjistrit të borxhit prej të cilit përgatiten evidenca të ndryshme nga DTTV. Rezultatet e testimit të këtij procesi për 11 subjektet e përzgjedhura në trajtë narrative shprehen si më poshtë:

Për vitin 2021 Detyrimi i evidentuar në sistem krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2021 rezulton me diferencë negative.

Në sistem detyrimi është 1,084,371 lekë më pak se detyrimi i paraqitur në evidencën për kontabilitet.

Për vitin 2022 detyrimi i evidentuar në sistem krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2022 rezulton me diferencë pozitive.

Në sistem detyrimi është 888,520 lekë më shumë se detyrimi paraqitur në evidencën për kontabilitet. Detyrimi progresiv vetëm në vitet 2021 - 2022 i evidentuar në sistem për këto 11 subjekte rezulton me diferencë pozitive krahasuar me detyrimin paraqitur në evidencën për kontabilitet për vitin 2021.

Në sistem detyrimi është **7,315,195 lekë** më shumë se detyrimi paraqitur në evidencën për kontabilitet.

DTTV Durrës nuk paraqet në kontabilitet vlerën e saktë të detyrimit vjetor për subjektet.

Sipas rezultateve të përfituara nga testimi konstatohet një diferencë në vlerën 7,315,195 lekë midis Kontabilitetit dhe Sektorit të Menaxhimit të Borxhit. Në sistem detyrimi është 7,315,195 lekë më shumë se në evidencën e paraqitur për kontabilizim (për 11 subjektet e zgjedhura). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296,, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 6; neni 10 dhe 11, të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMF nr. 5 datë 21.02.2022,pika 32, ...Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në

sektorin publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të bëjë saktësimin e vlerës të kërkesave për arkëtim mbi debitorët për të gjitha subjektet tatimpagues, duke përlllogaritur detyrimet tatimore bazuar në paketën fiskale të miratuar në vite dhe nëse dalin diferenca të planifikohen për t’u arkëtuar dhe identifikuar debitorë aktualë, të paraqesin në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat financiare vlerën e saktë të tyre. Bashkia Durrës të ngrejë një grup pune për identifikimin e personave përgjegjës dhe nxjerrjen e përgjegjëseve përkatëse për ndryshimin e detyrimeve në kontabilitet (pasqyrat financiare vjetore) dhe për pasqyrimin jo të saktë të detyrimit vjetor për subjektet, në shumën prej **630,083,524 lekë** vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Durrës.

Bashkia Durrës, të bëjë saktësimin e vlerës prej 7,315,195 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Durrës si dhe rakordimin e të dhënave midis drejtorive me qëllim unifikimin e detyrimeve të taksapaguesve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 3.1, për kontabilizimin e saktë të subjekteve debitorë nga Drejtoria e Financës janë marrë masat si mëposhtë.

-Detyrimet për taksat dhe tarifave vendore për abonentë familjarë dhe biznes në datën 31.12.2022 janë kontabilizuar në vlerën 165,047,159 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në fund të vitit 2023 nuk ka paraqitur informacion në Drejtorinë e Financës për gjendjen e debitorëve progresivë në fund të vitit 2023. Detyrimet për abonentët familjarë dhe biznes janë shtuar gjatë vitit 2023 në vlerën 614,115,113 lekë, kjo shtesë e debitorëve nuk janë debitorë të krijuar gjatë vitit 2023 por nga konstatimi i Grupit të Auditimit është vlera e kontabilizuar e debitorëve në vitin 2022 në shumën 165,047,159 lekë nuk janë debitorët progresive por debitorët e krijuar vetëm në vitin 2022. Vlera progresive e debitorëve në fund të vitit 2022 duhet të ishte kontabilizuar për vlerën e detyrimit 799,162,272 lekë.

Vlera e kontabilizuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” është kontabilizuar pa u kryer një analizë me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për debitorët dhe vlerat përkatëse të tyre referuar dokumentacionit përkatës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 7, pika 1 dhe 2. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të çregjistrimit dhe ndjekjes së subjekteve debitorë nga DTTV u konstatua se evidencat e DTTV dhe raportet e sistemit të DTTV kanë mospërputhje midis tyre dhe detyrimet nuk pasqyrohen korrekt në pasqyrat financiare të bashkisë.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën 40 raste nga lista e bizneseve të cilëve ju është ndryshuar statusi në Sistem (nga Aktiv në mbyllur, pasiv, pezulluar).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Për të 40 rastet, të cilat kanë ndryshuar status nga “aktiv” në “mbyllur”, në sistemin e DTTV detyrimet nuk janë pasqyruar korrekt në të gjitha raportet e DTTV, ku 17 subjekte rezultojnë Aktiv në Regjistrin Elektronik të QKB dhe 20 subjekte rezultojnë me statusin çregjistruar ose pezulluar.

Vlera e detyrimit për subjektet e analizuara sipas evidencave të përgatitura nga DTTV për kontabilizimin e borxhit për vitin 2022 është 0 lekë, ndërsa vlera e detyrimit për subjektet e analizuara sipas Sistemit të DTTV, është 72,114,783 lekë;

- Procesi i ç’regjistrimit në Regjistrin Elektronik të QKB bëhet pa u shlyer ose bllokuar vlera debitorë e subjektit.

- Mbyllja në sistemin e DTTV për këto subjekte bëhet si rezultat i çregjistrimit në QKB për shkak të vonesave në kthim përgjigjet e DTTV (*Në rast të mungesës së një konfirmimi në kohë nga DTTV, QKB proceson me çregjistrimin automatik*).

- Statusi (mbyllur, pezulluar, pasiv) në sistemin e DTTV bën që ky subjekt mos të ngarkohet me detyrime për taksa dhe tarifa vendore dhe nuk pasqyrohet më në asnjë raport apo evidencë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 5, 6, 10, 11,...; Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë i ndryshuar” neni 1, neni 2 gjerat a, ç, neni 5 gjerat a, d, dh, f, g, gj, h, i, neni 6 pikat 1, 2, 3, neni 12 gjerat a, b, dh..., neni 13 gjerat b, neni 15, neni 23 pika 1, 4, neni 26, neni 27, neni 28 pika 1, neni 29, neni 31, neni 40, neni 41, neni 42, neni 43 pika 1, 2, 3, neni 44, neni 45, neni 47, neni 48 pika 1, neni 57 pikat 4, 5, neni 60, 61, 62, neni 65 pika 5, neni 68, 69, neni 70 pika 2, neni 71/1 pika 5; ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, neni 28 –40, neni 42, neni 43 gjerat d, neni 59; Manualin i Menaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108 datë 17.11.2016; Udhëzimin nr. 26, datë 16.12.2014; Udhëzimin nr. 655/1 datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore; VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “*Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*”, i ndryshuar; VKB - në nr.160, datë 23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”; të Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMF nr. 5 datë 21.02.2022, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”; Rregulloren e brendshme të Bashkisë Durrës. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të bëjë saktësimin e vlerës të kërkesave për arkëtim mbi debitorët për të gjitha subjektet tatimpagues, duke paraqitur në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat financiare vlerën e saktë të tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar programit të auditimit nr. 1347/1, datë 24.01.2025 i ndryshuar, është audituar Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u verifikua se nga shkresat e ardhura nga QKB jo në të gjitha rastet është respektuar afati kohor nga sektori i terrenit për të verifikuar subjektin në terren. Nga zyra e rregjistrimit është kthyer në kohë përgjigja për bizneset me kërkesë “mbyllje” me detyrim në sistem”.

Statusi: Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe arkëtimit të taksës së pasurisë biznes (ndërtesës), u konstatua se ka pasaktësi në identifikimin e pasurive, sipërfaqeve dhe kontratave përkatëse për planifikimin e saktë të taksës mbi pasurinë kategoria biznes.

-Pranë 2 qendrave tregtare të kontrolluara zhvillojnë aktivitet rreth 50 subjekte të cilat taksën e ndërtesës e kanë kaluar te personi që zotëron pronësinë e qendres. Këta persona janë debitorë në këtë zë qysh prej vitit 2010, konkretisht në vlerën 26,000,000 lekë dhe në vlerën 9,961,000 lekë.

Gjithashtu u konstatua se një nga pronarët në objektin F....R nga vitit 2015 e në vazhdim nuk është ngarkuar me detyrimin sipas paketave fiskale të miratuara, që nga përlllogaritja e DTTV, ky detyrim ka vlerën e 1,867,416 lekë.

Nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në këtë qendër tregtare konstatohet një debi e akumuluar në vlerën prej 17,677,555 lekë, ku taksa e ndërtesës kap vlerën 13,836,609 lekë.

-Në lidhje me ngarkesën fiskale 2022 sipas të dhënave të sistemit, është identifikuar se kjo qendër është taksuar për taksë ndërtesë për një sipërfaqe 11,234.36 m² dhe pjesa e mbetur prej 2984.66 m² nuk është arritur të identifikohet në sistem.

-Nga shqyrtimi i të dhënave që administrohen në sistemin e DTTV Bashkia Durrës dhe dokumentacionit të administruar në praktikën nr. 172175 për subjektin B.P u konstatua se të dhënat që administrohen në ekstraktin historik të QKB, nuk përputhen me të dhënat e paraqitura në akt konstatimin nr. 0015309, mbajtur më datë 12.11.2019, mbi të cilin bëhet regjistrimi në sistemin DTTV.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar vullnetarisht nga subjekti pranë QKB u konstatua se sipërfaqja totale është njësi 592 m², Apartament 239.5 m² dhe jo 100 m² sipas akt konstatimit me nr. 0015309 mbajtur më datë 12.11.2019.

Nga DTTV konkretisht sektori i terrenit dhe sektori i manaxhimit të borxhit nuk është marrë asnjë masë për qartësimin e sipërfaqeve në administrim të B....P apo situatës debitore të tij dhe subjekteve që administrohen prej tij.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 20, neni 22/5..; në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 5, 8, neni 23 pika 4, 60, 61, 62, neni 71/1 pika 5, neni 73, neni 89, pika 2, neni 116; VKM nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”; Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore”; VKB - në nr.160, datë 23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, pika A.1.1.1 “Taksa mbi ndërtesat”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të identifikojë çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë, si dhe të planifikojë detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë” sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve e rapambetura.

5.2 Rekomandimi: DTTV Bashkia Durrës, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët në shumën 55,505,971 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve që lindin për taksa dhe tarifa vendore, respektivisht:

- **vlera 35,961,000 lekë**, për 50 subjekte që ushtrojnë aktivitet në 2 qendra tregtare “F.R” dhe “ T.”.
- **vlera 1,867,416 lekë** për R.R në cilësinë e pronarit në objektin “F.R” nga viti 2015.
- **vlera 17,677,555 lekë** nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në qendrën tragtare “F.R”.

Qëndrimi i grupit të auditimit (5.1): Lidhur me rekomandimin 5.1, për identifikimin e çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë nga Kryetari i Bashkisë është nxjerrë urdhri nr.260, datë 24.07.2024, prot 946/19 “Për marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohej përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Proces Zbatimi

Qëndrimi i grupit të auditimit (5.2): Lidhur me rekomandimin 5.2, për identifikimin e çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë nga Kryetari i Bashkisë është nxjerrë urdhri nr.260, datë 24.07.2024, prot 946/19 “Për marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore.

Sektori i Kontrollit në datat 25-26.09.2024 në Qendrën Tregtare B. S. verifikoj bizneset të cilët ushtronjë aktivitet në këtë qendër tregtare.

Për të gjitha subjektet që operojnë në qendrën tregtare B. S. taksën e pasurisë e paguan qiradhënësi H. D.

Subjektet “H.D” dhe “R.R” gjatë vitit 2024 ka lidhur akt-marreveshjen me këto subjekte për detyrimet e prapambetura.

Subjekti	Marreveshje Nr/Prot	Detyrim Fillestar	Paguar 20 %	Data Fill/Mbarim Kest	Vlera Kestit	Paguar/Keste	
H.D	Nr Prot 11474/1 Date: 08.10.2024	34,433,100	6,888,446	04.11.2024- 04.12.2025	1,967,476	813,500	Ne afat
R.R Sha	Nr Prot 10215/1 Date: 10.09.2024	12,563,206	3,183,035	10.10.2024- 10.11.2025	670,013	4,291,704	Ne afat

Statusi: Proces Zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të tregjeve bashkiake që operojnë në Bashkinë Durrës u konstatua se ka një mosrakordim të dhënash midis DTTV-së dhe administratës së tregut Agrobujqësor Bashkia Durrës kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës me anë të Vendimit nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës të Qarkut të Durrësit”. Për këtë pronë Bashkia Durrës nuk disponon çertifikatë pronësie.

-Tregu Agrobujqësor ka funksionuar si treg qysh prej datës 15.03.2022 sipas proces verbalit datë 15.03.2022 dhe pyetësorëve me personelin që e administrojnë. Tregu Agrobujqësor ka një vlerë të pa arkëtuar për 265 tregtarë për zënie e hapësirës në tregje për periudhën (15/03/2022-01/08/2022) në shumën prej 4,650,750 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Durrës.

-Menaxhimi i tregut dhe zënia e hapësirave tregtuese nga tregtarët nuk llogaritet sipas Paketës Fiskale të miratuar me m² por me banak duke sjell mungesë të ardhurash për Bashkinë Durrës në vlerën rreth 10,308,545 lekë.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me , ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKB nr.160, datë 23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, pika A.2.6.3 “Tarifa për sipërfaqe të tregut në administrim të Bashkisë Durrës”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 48-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për verifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregjet të cilat administrohen nga bashkia duke llogaritur dhe arkëtuar detyrimet për të gjitha subjektet që nga data kur ka filluar shfrytëzimi i tregut Agrobujqësor.

6.2 Rekomandimi: DTTV Bashkia Durrës, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët në shumën 4,650,750 lekë për 265 tregtarët e tregut Agrobujqësor, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve që lindin për taksën dhe tarifa vendore me qëllim shmangien e mundësisë për çregjistrimin e tyre pa shlyer detyrimet tatimore.

Qëndrimi i grupit të auditimit (6.1): Lidhur me rekomandimin 6.1, për verifikimin e subjekteve që ushtronjë aktivitet në tregjet të cilat administrohen nga Bashkia kemi informacion si mëposhtë:

-Për tregtarët që tregtojnë fruta –perime në tregun Agrobujqësor janë 288 banak nga të cilët 275 banakë shfrytëzohen nga tregtarët dhe 13 janë bosh. Nga 275 banakë që shfrytëzohen 269 janë me kontratë me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, 6 të tjerë nuk janë me kontratë.

-Për tregtarët që tregtojnë produkte bulmeti janë 4 banakë nga të cilët 3 janë me kontratë me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, 1 nuk ka kontratë.

-Për tregtarët që tregtojnë produkte peshku janë 6 banakë me kontratë me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

-Për ambientet e marra me qira janë lidhur 4 kontrata ndërmjet subjekteve tregtare dhe Drejtorisë Ligjore.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Qëndrimi i grupit të auditimit (6.2): Lidhur me rekomandimin 6.2, për marrjen e masave për nxjerrjen e njoftim detyrimeve tatimore për subjektet debitorë.

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2024 janë arkëtuar detyrimet si mëposhtë:

-Nga subjektet për tregtimin e fruta-perimeve janë arkëtuar 9,122,100 lekë.

-Nga subjektet për tregtimin e bulmetit janë arkëtuar 74,100 lekë.

-Nga subjektet për tregtimin e produkteve të peshkut janë arkëtuar 128,700 lekë.

Subjekte debitorë janë subjekte fruta-perimeve dhe 3 subjekte për tregtimin e peshkut.

Subjektet të cilat kanë marrë ambiente me qira Brenda tregut kanë shlyer detyrimet sipas kontratave.

Statusi: Zbatuar plotësisht

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** në të cilën mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratuar për leje ndërtimi, me objekt:1.“Strukturë banimi 2 kat, shtesë anësore 2 kat dhe shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat”, miratuar me vendimin Nr.2736, datë 18/01/2022, me zhvillues B.M, në Lalz, Durrës, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **96,315 lekë**. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me bazën të Ligjit Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 46 dhe Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Neni 27. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 214-246 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Durrës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **96,315 lekë**, që përbëjnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 7.1, me arkëtimin e të ardhurave të munguara rezultoi se ky rekomandim është pranuar. Kryetari i Bashkisë Durrës ka lëshuar urdhrin nr.260, datë 24.07.2024, prot 946/19, “Për marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me shkresën nr. 8821/4, datë 25.10.2024 i ka dërguar kërkesë subjektit për likuidim e vlerës.

Fatura për arkëtim nga Bashkia Durrës më nr.H0090005P178937, datë.21.10.2024.

Statusi: Në proces zbatimi

E. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 2 raste u konstatua përlllogaritje e gabuar e fondit limit në vlerën 534,240 lekë më shumë për vendosje të zërit të punës në mënyrë të paargumentuar në objektin “Sistemim KUB në rrugën “Taulantia” dhe 5,982,745 lekë më shumë për vendosje të çmimit jo sipas manualin në fuqi të çmimeve të punimeve të ndërtimit në objektin “Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House”, veprime jo në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e përlllogaritjes së fondit limit në mospërputhje me legjislacionin e punimeve të ndërtimit dhe të marrë masat e nevojshme për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Durrës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga ana e Titullarit të AK, nuk janë marrë masa për analizimin e situatës, për nxjerrjen e përgjegjësisë ndaj personave përgjegjës në përlllogaritjen e fondit limit. Gjithashtu, nga auditimi i radhës që po kryhet, janë konstatuar përsëri fenomene të mos llogaritjes së fondit limit në përputhje me dispozitat e LPP, për të cilën do lihen rekomandime në përfundim të auditimit. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.*

Statusi: Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me objekt “Rikonstruksion Rruga Currila, segmenti Hotel Ferrara – Guest House” Bashkia Durrës, me fond limit 37,248,896 lekë pa TVSh, fituar nga OE “B.I” me vlerë 23,239,590 lekë pa TVSh, u konstatua se është skualifikuar padrejtësisht OE “K.” ShPK me ofertë ekonomike 20,871,590 lekë pa TVSh, ose 2,841,192 lekë pa TVSh më pak se OE i shpallur fitues, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e skualifikimit të padrejtë të këtij OE dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Durrës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga ana e Titullarit të AK, nuk janë marrë masa për analizimin e situatës, për nxjerrjen e përgjegjësisë ndaj personave përgjegjës në vlerësimin e gabuar të procedurës. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.*

Statusi: Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me objekt “Shtimi i funksionaliteteve të kontrollit dhe kalkulimeve të taksave, vjeljes së detyrimeve dhe menaxhimit më eficient të buxhetit fiskal në sistemin ekzistues të Bashkisë Durrës”, u konstatua se pas kërkesës së Bashkisë Durrës drejtuar AKSHI-t për miratimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike për përmirësimin e sistemit ekzistues, AKSHI nuk e ka bërë miratimin e specifikimeve teknike, duke njoftuar Bashkinë Durrës që po kryhet një procedurë prokurimi që përfshin procedurën e filluar nga kjo bashki. Edhe pas këtij njoftimi AK Bashkia Durrës, ka kryer prokurimin e këtij shërbimi me fond limit 32,989,483 lekë. Ky investim, me implementimin e projektit për të cilën ka filluar procedura e prokurimit në AKSHI, nuk do të funksionojë më, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës në vlerën 32,989,483 lekë. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 673,

datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 144-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës, të nxjerrë përgjegjësitë për kryerjen e këtij investimi, që mund të dublohet me përfundimin e investimit nga ana e AKSHI-t dhe të marrë masat e nevojshme për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e Titullarit të AK, nuk janë marrë masa për analizimin e situatës, për nxjerrjen e përgjegjësisë ndaj personave përgjegjës. Në periudhën në vijim (2023-2024), nuk janë planifikuar më procedura të këtij lloji. Rekomandimi i kësaj natyre do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

F. Masa Disiplinore

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

a. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në 2 vjet” deri në “Largim nga shërbimi civil”, sipas shkeljeve të konstatuara për punonjësit si më poshtë:

1. **Z. A.I.**, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
2. **Znj. K.B.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
3. **Z. L.F.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
4. **Z. B.M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
5. **Z. G.D.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
6. **I. F.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
7. **Z. L.B.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
8. **z. F.A.**
9. **z. K.D.**
10. **Z. E.K.**, me detyrë punonjës pranë Drejtorive të varësisë së Bashkisë Durrës.
11. **Znj. K.A.**, me detyrë specialiste në Sektorin e Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Departamentit Urbanistik.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për 11 (njëmbëdhjetë) masat disiplinore të propozuara për punonjësit e mësipërm me masën “pezullim nga ngritja në detyrë deri në një periudhë 2 vjeçare”, nga Kryetari i Bashkisë Durrës është ngritur urdhri nr .261, datë 24.07.2024, prot.946/20 “Për marrjen e masave disiplinore në zbatim të rekomandimeve të KLSH”. Përveç urdhrit nr. 261, datë 24.07.2024 nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit të mësipërm.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

b. “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, deri në “Largim nga shërbimi civil”, në proporcion me shkeljen, për tre punonjësit e mëposhtëm:

- 1- **Znj. I.B.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkisë Durrës.
2. **Znj. A.M.**, me detyrë specialist i Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.
3. **Znj. A.M.**, me detyrë specialist i Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në lidhje: -**Me 9 rastet**, ku nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe nga Drejtoria Juridike nuk është Monitoruar zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë në lidhje me mos pagesën e qirasë për

sipërfaqen e objekteve pasuri shtetërore **duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumen totale prej 939,832 lekë.**

-**Me 7 raste** ku nga Bashkia Durrës, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve Bashkia Durrës dhe Administrata e Ndërmarrjes BGT, është lejuar të ushtrohet aktivitet nga subjekte private në objekte pasuri shtetërore pa Kontratë-Qiraje.

-**Në 7 rastet** ku nga Qiradhënësi Bashkia Durrës, (Administrata e Ndërmarrjes BGT) nuk është njoftuar me shkrim Qiramarrësi, për dorëzimin e objektit për “Zgjidhje Kontrate” pasi është mbyllur afatit i kontratës së qirasë për sipërfaqen e objektit të pasurisë shtetërore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për 3 (tre) masat disiplinore të propozuara për punonjësit e mësipërm me masën “Mbajtja deri në 1/3 e pagës për një periudhë deri në 6 (gjashtë) muaj”, nga Kryetari i Bashkisë Durrës është ngritur urdhri nr .261, datë 24.07.2024, prot. 946/20 “Për marrjen e masave disiplinore në zbatim të rekomandimeve të KLSH”. Përvec urdhrit nr. 261, datë 24.07.2024 nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit të mësipërm.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

c. “Vërejtje”, për 23 punonjësit si më poshtë:

1. E. L, me detyrë Drejtori i Drejtorisë Ekonomike në Bashkinë Durrës, konstatuar me shkelje në 5 raste në lidhje me procesin kontabilizimit të të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

2. Z. L.D, me detyrë Drejtori i Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore konstatuar me shkelje në 12 raste në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

3. Zj. H.H, Përgjegjësi i Sektorit të Financës pranë Drejtorisë Ekonomike në Bashkinë Durrës, konstatuar me shkelje në 3 raste në lidhje me procesin kontabilizimit të të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

4. Zj. V.Q, me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit në Bashkinë Durrës konstatuar me shkelje në 5 raste në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

5. Zj. A.K, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit të të Ardhurave konstatuar me shkelje në 5 raste në lidhje me realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

6. Zj. M. P, me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm konstatuar me shkelje në 3 raste në lidhje me mos evidentimin mbi auditimin e realizimit të të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

7. Z. SH.H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Taksave dhe Tarifave Vendore konstatuar me shkelje në 6 raste në lidhje me realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

8. Z. F.K, me detyrë Administrator i Tregut AgroBujqësor konstatuar me shkelje në lidhje realizimin e të ardhurave nga kjo veprimtari, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

9. R.D.

10. J.K.

11. M.J.

12. Zj. N.S, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave konstatuar me shkelje në 3 raste në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

13. Z. A.L, me detyrë Specialist (Inspektor) i Sektorit të Kontrollit, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

14. Z. E.GJ, me detyrë Specialist (Inspektor) i Sektorit të Kontrollit, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

15. Z. J.H, me detyrë Specialist (Inspektor) i Sektorit të Kontrollit, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

16. Z. A.H me detyrë Specialist (Inspektor) i Sektorit të Kontrollit, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

17. Z. M.P, me detyrë Inspektore e Taksave pranë Tregut Agrobujqësor, konstatuar me shkelje në lidhje realizimin e të ardhurave nga kjo veprimtari, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

18. Znj.A.H, me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nga periudha 09/06/2021, për parregullsitë e konstatuara në **5 raste**, në lejet e ndërtimit dhe në certifikat e përdorimit të miratuara.

19. Znj. J.M, me detyrë specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , nga periudha 09/06/2021, për parregullsitë e konstatuara në **1 rast**, në lejen e ndërtimit të miratuar.

F.2. Për punonjësit me kontratë pune.

a- Zgjidhje të kontratës së punës për një punonjës:

1. Z. D.M, me detyrë Kryeinspektor i IMT-së Bashkia Durrës nga periudha 01.01.2022 e në vazhdim.

b- “Vërejtje” për 4 (katër) punonjës, si më poshtë:

1. Z. S.M, me detyrë inspektor nga periudha 17/06/2019.

2. Z. G.H, me detyrë inspektor i IMT-së, nga periudha 27/12/2017.

3. Z. A.H, me detyrë inspektor i IMT-së, nga periudha 10/5/2021.

4. Z. K.L, me detyrë inspektor i IMT-së, nga periudha 5/5/2014.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për 23 (njëzet e tre) masat disiplinore të propozuara për punonjësit e mësipërm me masën “Mbajtja deri në 1/3 e pagës për një periudhë deri në 6 (gjashtë) muaj”, nga Kryetari i Bashkisë Durrës është ngritur urdhri nr .261, datë 24.07.2024, prot. 946/20 “Për marrjen e masave disiplinore në zbatim të rekomandimeve të KLSH”. Përvec urdhrit nr. 261, datë 24.07.2024 nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit të mësipërm.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

Pasqyra e realizimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Nr	E m ë r t i m i	Rekomandimet ne numër :					Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Reko mand im gjith s ej	Nga rekomandimet janë:				Rekomandua r Gjithsej		Zbatuar arkëtuar		(në proces)		Pa zbatuar	
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Proces zbatimi	Pa zbatuar	Nr . pe rs	Në mijë/le k	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. per s	Në mijë/lek
1	Masa organizative	39	7	2	14	16								
2	Shpërblim demi	7	5	2	-	-	7	2,794	5	1,122	2	1,671	-	-
3	Të ardhura të munguara	9	4	1	4	-								
4	Masa efekte negative	3			3	3								
5	Eliminimin e borxhit tatimor													
6	Masa disiplinore	37	-	37	-	-								
7	Masa administrative'	-	-	-	-	-								
	Totali	95	16	42	21	19	7	2,794	5	1,122	2	1,671		

Nga rekomandimet gjithsej: Sa për eliminimin e efekteve negative			
Rekomanduar Gjithsej	Zbatuar	(në proces)	Pa zbatuar
Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek
68,586	5,669	62,917	-

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk është hartuar plani vjetor i punës, nuk ka raportime periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, mos dokumentimi i takimeve të GMS, nuk është hartuar strategjia e riskut dhe nuk janë vlerësuar mundësitë e riskut për mashtime. Aktivitetet e rëndësishme (*me vlera të konsiderueshme*) dhe aktivitetet afatgjata nuk ruhen nga përdorimi i paautorizuar me anë të një procedure të shkruar. Nuk është hartuar një dokument i mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20, neni 21, pika 2, neni 22, pika 1; Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.1 germa (a,b,c,d), pika 2.2.4, pika 2.3.1, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 pika 4 - “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës në bashkëpunim me Koordinatorin e Riskut dhe Koordinatorin e MFK-së, të marrin masa për:

- Hartimin e planeve operationale të konsoliduar të punës, me tregues të performancës, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
- Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin e konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.
- Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publik.
- Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin e veprimtarinë së Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Durrës për periudhën 2023 - 2024, rezultoi se bashkia nuk ka ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në MAB.

Programeve të miratuara i mungon komponenti “*Reagimet e subjektit të audituar*”, sipas kërkesave e MAB, Kapitulli VII, pika 7.1.1.

Në raportet e auditimit, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (*e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara*), dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar sipas kërkesave të MAB, kapitulli IV, pika 4 .1.12. Dosjet e auditimit nuk përmbajnë “*Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit*”, sipas kërkesave të MAB, kapitulli VI, pika 2. Nuk janë kryer auditime në fushat me risk të lart, si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, asetet, etj.

Planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, në kundërshtim me nenin 5 dhe 6, të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar.

Për periudhën objekt auditimi (2023-2024), njësia ka funksionuar me staf të reduktuar, në kundërshtim me Manualin e Auditit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.1.1, Standardi 2230 - *Shpërndarja e burimeve në angazhim. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2 dhe 1.3, faqe 16-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Auditit të Brendshëm dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për:

- Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si një organ i pavarur;
- Përditësimin e Kartës së Auditimit;
- Plotësimin e strukturës së AB me staf të kualifikuar, duke qenë se Bashkia Durrës është një nga njësitë vendore më të mëdha dhe më të rëndësishme, me një shtrirje të gjerë;
- Planifikimin e misionëve të auditimit në drejtori/ sektor me risk të lartë, siç janë procedurat e prokurimit, mbledhja dhe përdorimi i taksave, të shpenzimeve operative si dhe të njësive vartëse të sajë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programeve buxhetore, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitet 2023 – 2024, rezultoi se:

a. Realizimi i buxhetit për vitin 2023, është në vlerën 7,688,491 mijë lekë, nga vlera 10,072,929 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 76%. Niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varijon në masën

77% (për zërin investime) deri 96% (ndihma ekonomike), gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Durrës dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

Në mos realizim kanë ndikuar zërit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 77% (të bashkisë), kjo si rezultat i mos realizimit dhe finalizimit të 19 projekteve të planifikuara në vlerën 197,733,600 lekë. Mos financimi i plotë i 66 projekteve të planifikuara, për arsye të mos mbylljes së punimeve brenda vitit buxhetor, kjo si rezultat i zhvillimit të procedurave në periudhat e fundvitit dhe lidhja e kontratave me vonesë. Mos realizimi i projekteve të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019, të cilat janë realizuar në masën 61%, ku nga vlera e parashikuar prej 4,505,939 mijë lekë është realizuar vlera 2,692,199 mijë lekë, për shkak të mos përfundimit të punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratat e zbatimit.

Të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore (në total) janë planifikuar për vlerën 2,118,990 mijë lekë dhe janë realizuar për vlerën 1,851,570 mijë lekë ose 87%, me një diferencë në masën - 267,420 mijë lekë.

- **Për vitin 2024 realizimi i buxhetit** është në vlerën 6,870,439 mijë lekë nga 8,624,462 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 79.6%. Në mos realizimin e treguesve të buxhetit ashtu si dhe për vitin 2023 kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 60%, kjo si rezultat i mos realizimit dhe finalizimit të 13 projekteve të planifikuara në vlerën 95,752,000 lekë. Mos financimi i plotë i 28 projekteve të planifikuara, për arsye të mos mbylljes së punimeve brenda vitit buxhetor. Mos realizimi i projekteve të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019, të cilat janë realizuar në masën 64%, ku nga vlera e parashikuar prej 2,524,223 mijë lekë është realizuar vlera 1,607,293 mijë lekë, për shkak të mos përfundimit të punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratat e zbatimit.

b. Gjatë zbatimit të Buxhetit, është konstatuar se **për vitin 2023**, nuk është bërë planifikimi i plote i fondeve për financimin e detyrimeve të prapambetura të rezultuara në fund të vitit 2022 në vlerën 110,374,3892 lekë. Ndërsa **për vitin 2024**, ato paraqiten në vlerën 39,606,019 lekë, të cilat nuk janë paraqitur për arkëtim në vitin vijues për faktin se janë detyrime të ish- komunave të cilat nuk kanë dokumentacion të rregullt ligjorë për të mundësuar planifikimin në buxhetin pasardhës për likuidim.

c. Në lidhje me mos respektimin e afatit prej 60 ditë të likuidimit të faturave, rezultoi se **për vitin 2023**, janë gjithsej **22** fatura me vlerë **200,075** mijë lekë, dhe për **vitin 2024** janë gjithsej **7** fatura me vlerë **130 mijë lekë**. Nuk ka fatura të cilat të mos jenë likuiduar në vlerë të plotë në momentin e paraqitjes.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 43 paragrafi 4,47,48,52; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40/h,42; Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit” pika 106 dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 42-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës, nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe me miratim në Këshillin Bashkiak, të marrë masa si vijon:

- Të kryejë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara dhe me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë financimin i detyrimeve të prapambetura;
- Të sigurojë realizimin e projekteve të investimeve strategjike të planifikuara, duke shmangur vonesat në procedurat e prokurimit, në lidhjen e kontratave dhe eliminuar limitimin e likuidimeve për

angazhime të marra;

- Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, duke hartuar një grafik me radhën e pagesave, dhe për detyrime me dokumentacion jo të saktë ligjorë në bashkëpunim me Degën e Thesarit të marrin masa për risistemin e tyre;
- Të raportojnë me saktësitë dhe në kohë reale të gjitha faturat për situacionimet e mbyllura sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezultoi se Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 635,037,652 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,291,299,993 lekë, gjatë vitit 2023 ka pasur rritje me vlerë 656,262,341 lekë.

Gjatë vitit 2024 llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është kontabilizuar për vlerën e detyrimit 1,278,611,444 lekë. Kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 10,681,000 lekë dhe pakësime në vlerën 23,369,549 lekë, vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe familjarët. Në analizën e kësaj llogarie bie në sy fakti se, detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për abonentë familjarë dhe biznes në datën 31.12.2022 janë kontabilizuar në vlerën 165,047,159 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në fund të vitit 2023 nuk ka paraqitur informacion në Drejtorinë e Financës për gjendjen e debitorëve progresivë në fund të vitit 2023. Detyrimet për abonentët familjarë dhe biznes janë shtuar gjatë vitit 2023 në vlerën 614,115,113 lekë, kjo shtesë e debitorëve nuk janë debitorë të krijuar gjatë vitit 2023, por nga konstatimi i Grupit të Auditimit të KLSH, është konstatuar se vlera e kontabilizuar e debitorëve në vitin 2022 në shumën 165,047,159 lekë nuk janë debitorët progresive por debitorët e krijuar vetëm në vitin 2022. Vlera progresive e debitorëve në fund të vitit 2022 duhet të ishte kontabilizuar për vlerën e detyrimit 779,162,272 lekë.

Gjatë vitit 2024 gjendja e debitorëve familjarë dhe biznes nuk ka ndryshuar, duke u kontabilizuar për vlerën 779,162,272 lekë, pasi nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në fund të vitit 2024 nuk është paraqitur informacion për gjendjen e debitorëve progresivë në fund të vitit 2023

Vlera e kontabilizuar në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, është kontabilizuar pa u kryer një analizë me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për debitorët dhe vlerat përkatëse të tyre referuar dokumentacionit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, pika 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Durrës të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “*Debitorë të ndryshëm*” me kundërparti llogarinë nr. 470 “*Të ardhura për t’u marrë*”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara, rezultoi se Llogaria 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (debitor)*”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 129,815,530 lekë.

Sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë Durrës gjendja e llogarive të klasës 4 është në vlerën 498,378,655 lekë, pasqyruar si vijon: - Llogaria 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*”: 54,343,294 lekë; - Llogaria 421 “*Detyrime ndaj personelit*” : 84,856,876 lekë; - Llogaria 431

“Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” : 5,183,424 lekë; - Llogaria 435 “Sigurime Shoqërore” : 25,798,007 lekë; - Llogaria 436 “Sigurime Shëndetësore”: 6,284,919 lekë; - Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” : 321,912,135 lekë.

Sipas analizës së nxjerrë nga grupi i auditimit për llogaritë e klasës 4 (401-408,421,431,435,436,467), referuar pasqyrave individuale të Bashkisë Durrës dhe të Njërive Shpenzuese të dorëzuara në thesar totali i kësaj llogarie është në vlerën 471,150,473 lekë, si vijon: -Llogaria 401-408 *“Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”*: 19,567,499 lekë; -Llogaria 421 *“Detyrime ndaj personelit”* : 91,768,607 lekë; -Llogaria 431 *“Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”* : 5,602,084 lekë; -Llogaria 435 *“Sigurime Shoqërore”* : 28,174,821 lekë; -Llogaria 436 *“Sigurime Shëndetësore”* : 4,125,327 lekë; -Llogaria 467 *“Kreditorë të ndryshëm”* : 321,912,135 lekë.

Referuar analizës së mësipërme llogaria 4342 *“Të tjera operacione me shtetin (debitor)”* duhej të paraqitet në pasqyrat e konsoliduar për vlerën 471,150,473 lekë, por është mbivlerësuar për vlerën 27,228,182 lekë, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, pika llogaritë e marrëdhënieve me shtetin.

Sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë Durrës gjendja e llogarisë 7206 *“Financim i pritshëm nga buxheti”* më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerë 90,639,938 lekë.

Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese, nga grupi i auditimit u konstatua se, vlera e llogarisë është 126,782,226 lekë. Referuar analizës së mësipërme për llogarinë 4342 *“Të tjera operacione me shtetin (debitor)”*, e cila është llogari kuadruese për llogarinë 7206 *“Financim i pritshëm nga buxheti”*, kjo llogari duhet të paraqitet në vlerën 471,150,473 lekë, por që është nënvlerësuar për vlerën 380,510,535 lekë.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, i ndryshuar, pika llogaritë e marrëdhënieve me shtetin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Durrës të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë 4342 *“Të tjera operacione me shtetin (debitor)”* dhe 7206 *“Financim i pritshëm nga buxheti”*, për të mundësuar dhënien e saktë të informacionit kontabël dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezultoi se Llogaria 202 *“Studime dhe Kërkime”* përbehet nga 41 projekte me kosto historike 250,813,498 lekë dhe vlerë neto 135,706,885 lekë. Regjistri elektronik i vendosur në dispozicion grupit të auditimit për aktivet e llogarisë 202 përmban vitin e kontabilizimit, përshkrimin e aktivitetit dhe koston historike. Drejtoria e Financës Bashkia Durrës nuk disponon një regjistër për aktivet e llogarisë 202 sipas Kreut III të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të hartojë regjistrin e aktiveve afatgjata jo materiale sipas udhëzimeve përkatëse dhe të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 202 *“Studime dhe Kërkime”*, për të mundësuar dhënien e saktë të informacionit kontabël dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

7. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë Durrës llogaria 210 *“Toka, troje, terrene”* është paraqitur me kosto historike 183,102,409 lekë, ku gjatë vitit 2023 nuk ka pasur shtesa.

Aktivitet e kontabilizuar i përkasin njërive si mëposhtë:

-Bashkia Durrës, 12 aktive me kosto historike 180,594,841 lekë.

-Ndërmarrja e Rrugëve, 1 aktiv me kosto historike 2,507,568 lekë.

Aktivi “*Gurrë mermeri*” i regjistruar në llogarinë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” me kosto historike 2,507,568 lekë është regjistruar në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, *trajtimet kontabël për AAGJM, Nomenklaturën e llogarive kontabël. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Durrës të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm. Aktivi “*Gurrë mermeri*” janë materiale të cilat duhet të kontabizohen në llogarinë 31 “*Materiale*”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezultoi se gjendja e llogarisë 211 “*Pyje, Plantacione*” sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë Durrës është paraqitur me kosto historike 22,684,643 lekë. Gjatë vitit 2023 llogaria 211 nuk ka pasur shtesa. Aktivitet e kontabilizuar në llogarinë 211 “*Pyje, Plantacione*”, 12 aktive me kosto historike 22,684,643 lekë janë kontabilizuar në këtë llogari në kundërshtim me nomenklaturën e llogarive kontabël.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, *trajtimet kontabël për AAGJM, Nomenklaturën e llogarive kontabël i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Durrës të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë 211 “*Pyje, Plantacione*” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm. Aktivitet e kontabilizuar në llogarinë 211 “*Pyje, Plantacione*” të transferohen në llogarinë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduar, rezultoi se gjendja e llogarisë kontabël 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune*”, më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerë neto kontabël 129,581,074 lekë. Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit u konstatua se vlera kontabël neto e cila duhet të paraqitet llogaria 214 në pasqyrën e konsoliduar është 144,848,230 lekë.

Referuar analizës së mësipërme vlera neto e llogarisë 214 është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiarë për vlerën 15,267,156 lekë.

Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 39,565,379 lekë, e cila është përfituar nga blerje me pagesë në shumën 8,498,612 lekë, blerje pa pagesë në vlerën 31,066,767 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 103 të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Durrës të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune*” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezultoi se llogaria kontabël 217 “Kafshë pune dhe Prodhimi” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në datë 31.12.2022 në vlerën 266,131,632 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari është shtuar për vlerën 33,765,000 lekë. Në datën 31.12.2023 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 299,896,317 lekë, ku rezultoi se janë kontabilizuar pemë të llojeve të ndryshme, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, trajtimet kontabël për AAGJM, Nomenklaturën e llogarive kontabël. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Durrës të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë 217 “Kafshë pune dhe prodhimi”, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Pemët e kontabilizuar në këtë llogari janë asete të cilat fillimisht duhet të hynë në magazinë si materiale në llogarinë 31 “Materiale” dhe më pas ti bashkohen vlerës së aktivitetit përkatës në llogaritë e klasës 2.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduar, rezultoi se Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik” më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerë neto kontabël 200,938,270 lekë.

Sipas të dhënave të pasqyrave individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit u konstatua se vlera kontabël neto e cila duhet të paraqitet llogaria 218 në pasqyrën e konsoliduar është 241,386,955 lekë. Kjo llogari është e paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 40,448,685 lekë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, trajtimet kontabël për AAGJM, Nomenklaturën e llogarive kontabël, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Durrës të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë 218 “Inventar ekonomik”, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezultoi se llogaria kontabël 216 “Rezervë shtetërore” është pasqyruar në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar për vlerën 36,987,524 lekë. Nga informacioni i vendosur në dispozicion nuk disponohet analizë analitike për vlerën e kontabilizuar 36,987,524 lekë. Referuar pasqyrave individuale të pozicionit financiar të 11 njësisve kjo llogari është paraqitur me vlerë 0 lekë. Regjistrimi i llogarisë 216 “Rezervë shtetërore” është kryer në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, hyrjet e AAGJM, trajtimet kontabël për AAGJM, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Durrës të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë 216 “Rezervë shtetërore”, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024, rezultoi se Llogaria kontabël 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 309,915,144 lekë. Sipas Udhëzimit të MF nr.5 , datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15 përcakton se regjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ. Llogaria 486 është mbivlerësuar për vlerën 309,915,144 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të mos kryejë kontabilizimin e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të kontabilizohen në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” me kundëparti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezultoi se llogaria kontabël 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31.12.2023 për vlerën 54,343,294 lekë. Referuar pasqyrave individuale të njërive shpenzuese në Bashkinë Durrës rezultoi se llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 34,791,168 lekë. Kjo llogari duhet të paraqitet në vlerën 19,552,126 lekë. Njësitë shpenzuese të cilat kanë detyrime të palikuiduara deri në datën 31.12.2023 janë: -Ndërmarrja Durrës 18,804,722 lekë; -Komunale Plazh 262,972 lekë; -Qendra Ditore e të Moshuarave 27,504 lekë; -Qendra Ekonomike Arsimore 87,174 lekë; -Ndërmarrja Komunale 369,754 lekë; Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 103 të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Durrës të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezultoi se referuar pasqyrës individuale të pozicionit financiar për Bashkinë Durrës llogari 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është regjistruar për vlerën 332,587,885 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2024, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 86,728,364 lekë, veprim ky në kundërshtim me pikën 3.2 të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar

drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave individuale të Bashkisë Durrës për vitin 2024, llogaria 101 “*Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar*”, kjo llogari është paraqitur në datë 31.12.2024 për vlerën 1,431,805,993 lekë.

Referuar udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, llogaria 101 fondi bazë funksion duke u kredituar nga shuma e aktiveve të blera ose të krijuara në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe debitohet për nxjerrjet jashtë përdorimit/pakësimet të AAM.

Gjatë vitit 2024 kjo llogari është kredituar për shumën 31,686,581 lekë dhe është debituar për shumë 86,570,959 lekë. Shtesa neto është në vlerën (54,884,378) lekë.

Sipas analizës së mësipërme dhe çeljes së vitit llogaria 101 “*Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar*”, duhej të paraqitej në vlerën 1,447,899,335 lekë. Referuar pasqyrës së pozicionit financiar kjo llogari është paraqitur në vlerën 1,431,805,993 lekë dhe është nënvlerësuar për vlerën 16,093,342 lekë.

Veprimi i mësipërm në kundërshtim me pikën 1.1 të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “*Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar*”, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave të konsoliduar të Bashkisë Durrës për vitin 2023 llogaria 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*” është shtuar në vlerën 1,003,472,962 lekë për 14 projekte investimi. Nga auditimi i pasqyrave individuale të Bashkisë Durrës për vitin 2024 llogaria 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*” nuk ka pasur shtesa.

Referuar auditimit të projekteve të cilat janë kontabilizuar në këtë llogari konstatohet se nuk është kryer në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, hyrjet e AAGJM.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për investimet në AAGJ disponohej situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi, por nuk disponohej dokumentacioni i pronësisë së aktiveve.

Aktivitet e kontabilizuara në llogarinë 212 janë kontabilizuar pa certifikatë pronësie, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, hyrjet e AAGJM, ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 36-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Projekteve dhe Investime në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe atë Juridike, të marrin masa që për asetet të cilat do të kryhen investime kapitale, të disponojnë dokumentacionin e pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë” më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari nuk ka pasur shtesa dhe është pasqyruar në vlerën 0 lekë.

Bashkia Durrës në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 32.47 % të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës” Sh.A me NUIS M22031502M e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”. Numri i aksioneve është 32,468 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,246,800lekë.

Vlerat e “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës” Sh.A sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2024 , në kundërshtim me pikën 3.1, nënpika 31, të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 26 “Investime në pjesëmarrje” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën 765/22 Prot, datë 02.05.2024, rezultoi se:

- Nga subjekti është respektuar afati **20 ditor** dhe **6 mujor** për kthimin e përgjigjes për marrjen e masave në zbatimin e rekomandimeve, përcjellë me shkresën nr. 946/16 Prot, datë 22.05.2024, në zbatim të shkronjës “j” të nenit 15 dhe pikës 2 të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”.

- Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, rezultoi si vijon:

a- Nga **39 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa, janë në proces 14 masa, janë pjesërisht të zbatuara 2 masa dhe nuk janë zbatuar 16 masa organizative. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohen 15 masa organizative pasi situata mbetet e njëjtë dhe këto rekomandime do të reflektohen në auditimin aktual.

b- Nga **7 masa shpërbllim dëmi në vlerën 2,794,896 lekë**, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa në vlerën 1,122,000 lekë, ndërsa 2 masa në vlerën 1,671,000 lekë janë zbatuar pjesërisht.

c- Nga **3 masa për eliminim e efekteve negative**, janë pranuar 100% nga subjekti, nuk janë zbatuar. Masat e pa zbatuara nuk do të rikërkohen pasi situata mbetet e njëjtë dhe këto rekomandime do të reflektohen në auditimin aktual.

d- Nga **9 masa për uljen e borxhit tatimor**, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 4 masa, në proces janë 4 masa, dhe realizuar pjesërisht 1 masë. Masa e zbatuar pjesërisht nuk do të rikërkohen pasi situata mbetet e njëjtë dhe këto rekomandime do të reflektohen në auditimin aktual.

e- Për masat disiplinore, për dhënien masë disiplinore për:

- 11 (njëmbëdhjetë) masa “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në 2 vjet” deri në “Largim nga shërbimi civil”;

- 3(tre) masa “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, deri në “Largim nga shërbimi civil”;

- 23 (njëzet e tre) masa “Vërejtje” ;

- 1 (një) masë “zgjidhje të kontratës së punës”;

- 4 (katër) masa “Vërejtje”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, në faqet 120-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë vijon:

A. Masa Organizative:

18.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës të hartojë dhe paraqesë për miratim pranë Këshillit të Ministrave listën përfundimtare me dokumentacionin e nevojshëm shoqërues të pronave të paluajtshme publike të të gjitha Njësive Administrative, që të transferohen në pronësi apo përdorim të saj.

27.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për regjistrimin në “Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore” pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), të ndërtojë programin e sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të tij, konkretisht, mjedisin i sigurisë së informacionit, vlerësimin e riskut, politikat e sigurisë, organizimi i sigurisë së TIK, menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, menaxhimi i aseteve, siguria e burimeve njerëzore, siguria fizike dhe mjedisore, kontrolli i aksesit, menaxhimi i incidenteve të sigurisë së tik, menaxhimi i vazhdueshmërisë së aktivitetit të njësive dhe përputhshmëria.

37.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa të menjëhershme për:

- Gjetjen e rrugëve ligjore për amendimi e kontratës në lidhje me specifikimet teknike të detajuara, si dhe për gjetjen e zgjidhjes për peshimin e mbetjeve para transportit për Landfillin e Sharrës me qëllim kryerjen e pagesave sipas shërbimit real të këtij procesi jetik për qytetarët.

- Ngritjen e një grupi pune për studimin e fizibilitetit të shërbimit të pastrimit të qytetit dhe depozitimit të mbetjeve urbane, i cili me mbarimin e kontratës aktuale të depozitimit të mbetjeve të shërbejë si bazë për të gjetur rrugët alternative për procesin e plotë të menaxhimit të mbetjeve (pastrim dhe depozitim), që ky shërbim të jetë cilësor dhe me kosto sa më të ulët me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve të Bashkisë Durrës.

B. Masa për Shpërblim Dëmi.

1.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **552,966 lekë pa TVSH** nga OE “A.O” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1801/6 prot., datë 09.09.2022, me objekt “FV Ndriçimi rruga Neki Libohova dhe “Marta Durda”, Bashkia Durrës”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësive vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,118,965 lekë pa TVSH** nga BOE “E.B” SHPK & “LL.O” ShPK & “E.N” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3638/2 prot., datë 01.06.2021, me objekt “Riforcim godine banimi 12 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga Neki Libohova” nr.70, kod GIS 5061, 5063”, Bashkia Durrës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësive vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

C. Për masat disiplinore.

1.1 Rekomandimi: Vijimin e procedurave për dhënien masë disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në 2 vjet” deri në “Largim nga shërbimi civil”, 11 (njëmbëdhjetë) masa, “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, deri në “Largim nga shërbimi civil”, 3(tre) masa. “Vërejtje” për 23 (njëzet e tre) masa dhe për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës janë dhënë masa disiplinore, zgjidhje të kontratës së punës 1 (një) masë dhe “Vërejtje” për 4 (katër) punonjës.

Brenda datës 31.12.2025

B. MASA DISIPLINORE.

Për punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë jo të përsëritura dhe me mangësi më të ultë se rrisku i parashikuar nga grupi i të auditimit, *dhe lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Durrës*, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, nenit 11 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

